

# LIBRI I PSALMEVE

## LIBRI I PARË

### Lumturia e vërtetë

**1** Lum ai njeri që nuk ndjek këshillat e të pabesëve, që nuk ecën në rrugën e mëkatarëve dhe nuk përzihet me ata që e përbuzin Zotin. <sup>2</sup>Lum ai që kënaqësinë e gjen te mësimet e Zotit dhe ditë e natë mendon për Ligjin e tij. <sup>3</sup>Ai i ngjan pemës së mbjellë pranë vijës së ujit; gjethet e saj rrinë të gjelbra e të freskëta dhe për çdo vit jep fruta. Këtij njeriu i shkon mbarë çdo gjë që bën. <sup>4</sup>Por krejt ndryshe ndodh me ata që nuk duan t'ia dinë për Zotin; ata janë si fija e kashtës që era e merr me vete. <sup>5</sup>Ata nuk do t'i qëndrojnë dot Gjqyt dhe vendi i tyre nuk është në bashkësinë e Zotit. <sup>6</sup>Zoti tregon kujdes për ata që e dëgjojnë, kurse të pabindurve do t'u shuhen gjurmët.

### Mbreti i emëruar nga Zoti

**2** Ç'kanë kombet që pështhellohen? Përse popujt bëjnë plane të kota? <sup>2</sup>Sunduesit e botës ngrenë krye; sundimtarët bashkohen kundër Zotit dhe kundër mbretit që Ai vetë e ka zgjedhur. <sup>3</sup>«Ne nuk duam të jemi më skllevërit e tyre! Ngrihuni e prangat e tyre t'i këputim!» <sup>4</sup>Zoti në qiell qesh e tallet me ta. <sup>5</sup>Pastaj zemërohet; frikë e tmerr u kall atyre; me zërin e tij të ashpër i lemeris. <sup>6</sup>«Unë vetë e kam caktuar atë mbret! Ai mbretëron në Cion, në malin tim të shenjtë.» <sup>7</sup>Ju njoh me atë që dekretoi Zoti. Ai më tha: «Ti je Biri im, sot të kam emëruar (mbret). ♦» <sup>8</sup>Kërkoji prej meje të gjitha kombet. Unë t'i dhuroj. Po të jap ty për pronë mbarë botën. <sup>9</sup>Sundoji banorët me grusht të hekurt! Po të duash, thyeji si një enë balte!» <sup>10</sup>Prandaj ejani në vete, o mbretër; le të jetë ky një paralajmërim për ju, të fuqishmit e botës! <sup>11</sup>Nënshtrojeni Zotit, pranojeni pushtetin e tij dhe priteni me brohoritje. <sup>12</sup>Nderojeni Birin e tij, që ai të mos zemërohet dhe ju të mos shkatërroheni, sepse zemërimi i tij mund të shpërthejë menjëherë. Lum ata që kërkojnë strehim tek ai!

♦ fjj. Që sot unë jam ati yt.

### Besimi te mbrojtja e Zotit

**3** *Këtë këngë e hartoi Davidi kur duhej të largohej nga i biri, Avshalomi.* <sup>2</sup>O Zot, <sup>3</sup>janë kaq shumë ata që drejtohen kundër meje, saqë nuk mund t'i numëroj dot. <sup>3</sup>Shumë njerëz me zemërligësi thonë për mua. «Perëndia nuk e ndihmon më!» <sup>4</sup>Megjithatë, o Zot, ti më rrethon me mbrojtjen tënde; ti e vë në vend nderin tim, ti më jep të drejtë. <sup>5</sup>Sa herë që të thërras për ndihmë, ti më dëgjon në shenjtëroren tënde e më dërgon përgjigje nga Mali yt. <sup>6</sup>I sigurt bie të fle, sepse e di se jam nën mbrojtjen tënde derisa të zgjohem. <sup>7</sup>Nuk kam frikë nga ata që më rrethojnë, edhe sikur të jenë me mijëra. <sup>8</sup>Mos qëndro më spektator, o Zot, o Perëndia ime, por ndërhyr! Unë e di se ti i godet në nofull të pafytyrët. Dhëmbët ti ua thyen armiqve të mi. <sup>9</sup>Njeriu, kur e ndien veten ngushtë, tek ti kërkon ndihmë. O Zot, jepi popullit tënd sukses dhe lumturi!

### Gëzim dhe paqe pavarësisht nga shpifjet

**4** *Këngë e Davidit, që këndohet e shoqëruar me vegla muzikore me tela.* <sup>2</sup>O Perëndi, për mua ndërhyre! Kur u ndodha ngushtë, ti ndërhyre për mua; kur mezi merrja frymë, ti më nxore në liri. Prandaj tani, ki mëshirë për mua! Më dëgjo kur të thërras për ndihmë, përgjigju lutjes sime! <sup>3</sup>Ju të pasur, pushtet keni e megjithatë, e shpërdoroni atë për gënjeshtër e shpifje; nderin tim me baltë e keni përlyer. Kur do të pushoni? <sup>4</sup>Shikoni: për njeriun që ia mban besën atij, Zoti bën mrekulli. Ai më dëgjon kur e thërras për ndihmë. <sup>5</sup>Dridhuni para tij dhe jepini fund padrejtësisë! Natën, kur jeni vetëm, mendohuni thellë dhe qetësohuni. <sup>6</sup>Sillini Zotit flijimin tuaj, jepini të drejtë, dhe besojini atij përsëri! <sup>7</sup>Shumë veta ankohen: «Ç'e mirë na pret, kur Zoti nuk na shikon me shumë dashamirësi?» <sup>8</sup>E megjithatë, ti më dhe gëzim shumë të madh, më të madh sesa e kanë ose mund të kenë ata që i gëzohen grurit e verës së tyre. <sup>9</sup>Mua nuk më mundon asnjë shqetësim. Kur bie të fle, më merr gjumi plot qetësi e siguri. Të gjitha këto, vetëm ti m'i jep, o Perëndi!

### Lutja e një hallexhiu

**5** *Këngë e Davidit, që këndohet e shoqëruar me fyell.* <sup>2</sup>O Zot, dëgjo fjalët e mia; merre parasysh vuajtjen dhe rënkimin tim! <sup>3</sup>Mos i mbyll veshët, o mbreti dhe Perëndia ime! Ty ta drejtoj lutjen time. <sup>4</sup>Ti e dëgjon thirrjen time që herët në mëngjes. Pa aguar mirë,

paraqes para teje çështjen time dhe pres vendimin tënd.

<sup>5</sup>Ty, O Perëndi, nuk të pëlqen padrejtësia dhe larg të qëndron ligësia. <sup>6</sup>Ti nuk duron mendjemëdhenjtë dhe urrejtja jote godet kriminelët. <sup>7</sup>Në shkatërrim gënjeshtarët i hedh, vrasësit e mashtruesit ti i urren.

<sup>8</sup>Por mua më tregon mirësinë tënde: mund të vij në Tempullin tënd, të bie përmbys para shenjtërores sate dhe të lutem me nderim të thellë. <sup>9</sup>O Zot, bëj, pra, që armiqtë e mi të shohin se si më ndihmon ti! Ti e ke planin e jetës sime; tregoma rrugën nga do që të shkoj!

<sup>10</sup>Askush nuk mund t'u besojë fjalëve të tyre; ata mendojnë vetëm për ligësi.

Ëmbëlsia e fjalëve të tyre është kurth i ngrehur që të sjell vdekje dhe shkatërrim. <sup>11</sup>Le ta paguajnë ligësinë, o Zot, dhe ta pësojnë vetë nga intrigat e tyre. Dëboji nga prania jote, se të panumërta janë poshtërsitë e tyre dhe kryeneçë ndaj teje pa mbarim janë.

<sup>12</sup>Të gëzohen të gjithë ata që besojnë tek ti. Brohoritjet e tyre të mos pushojnë kurrë, sepse ti je mbrojtësi i tyre. Të këndojnë nga gëzimi të gjithë ata që të duan. <sup>13</sup>Ti u jep lulëzim të gjithë atyre që ta mbajnë besën, o Zot. Ata janë të rrethuar e të mbrojtur nga dashuria jote.

### Thirrje për ndihmë

**6** *Këngë e Davidit, që shoqërohet me vegël me tetë tela.*

<sup>2</sup>O Zot, ti zemërohesh me mua dhe më ndëshkon. Po mjaft me kaq; mos më dëno më! <sup>3</sup>Ki mëshirë, o Zot; jam shumë i mjerë. Më shëro, o Zot! Forcat po më lënë. <sup>4</sup>Nuk kam asnjë rrugëdalje. Edhe sa kohë, o Zot, do të më ndëshkosh? <sup>5</sup>Zbute zemërimin tënd! Më shpëto! Më ndihmo, siç i premtove popullit tënd! <sup>6</sup>Kur të vdes, nuk mund të të lavdëroj më. Atje poshtë, tek të vdekurit nuk të lavdëron askush.

<sup>7</sup>Jam lodhur nga rënkimet. Çdo natë e laj shtratin me lotët e mi. <sup>8</sup>Sytë i kam të enjtur nga vajtimet; nga ato që m'i shkaktojnë armiqtë e mi. <sup>9</sup>Më mirë zhdukuni, o ju keqbërës! Vajtimet e mia Zoti i ka dëgjuar.

<sup>10</sup>Ai ma dëgjon thirrjen dhe lutjen time e pranon. <sup>11</sup>Të gjithë armiqtë e mi do të mbulohen me turp kur ai të bëjë që t'i pushtojë paniku e të marrin arratinë.

### Zoti më jep të drejtë

**7** *Këngë vajtimi, me të cilën Davidi iu drejtua Zotit, kur e padiste Kushi, një njeri nga fisi i Benjamin.*

<sup>2</sup>O Zot, Perëndia ime, strehim tek ti kërkoj, më ndihmo! Nga njerëzit që më ndjekin, më shpëto!

<sup>3</sup>Përndryshe, në grykë si luanët do të më kafshojnë. Nga dhëmbët e tyre askush nuk mund të më shpëtojë.

<sup>4</sup>O Perëndi! O Zot! Padia e tyre në qoftë e vërtetë, në qoftë se duart e mia përlyer me gjak janë, <sup>5</sup>në qoftë se pabesisht me ta jam sjellë e grabitje atyre unë u kam bërë, <sup>6</sup>armiku le të më ndjekë e shpirtin tim të ma rrëmbejë, të më zvarrisë në pluhur e nderin të më përlyejë.

<sup>7</sup>Ngrihu, o Zot, dhe derdhe zemërimin tënd. Vepro ndaj atyre që më janë sulur me tërbim. Ndërhyr, më ndihmo, e të drejtën rivendos. <sup>8</sup>Rreth teje mbliidhi popujt për gjyq dhe ulu lart përmbi ta. <sup>9</sup>O Zot, gjyqtar i popujve, më jep të drejtë! Më shfajëso, o Zot; ti e di se unë jam i pafajshëm. <sup>10</sup>Jepu fund ligësive të keqbërësve; dhe besnikëve të tu jepu qëndrueshmëri, ti, Perëndi i drejtë, që mendimet dhe dëshirat më të fshehta i di!

<sup>11</sup>Te Perëndia gjej strehim. Të gjithë ata që e dëgjojnë, ai i shpëton. <sup>12</sup>Perëndia është gjykatës i drejtë. Ai çdo ditë fajtorët dënon. <sup>13</sup>Kur ata mend nuk zënë, Zoti shpatën e tij e mpreh, harkun tendos dhe i qëllon.

<sup>14</sup>Armët vdekjeprurëse i mban gati për fajtorët. Me shigjeta të zjarrta, ai i bombardon.

<sup>15</sup>Kush vetëm të këqija pa pushim mendon, mbi kokë fatkeqësia gjithnjë i qëndron dhe zhgënjime pa fund ai përjeton. <sup>16</sup>Kush gropën të tjerëve me zell ua gërmon, mirë le ta dijë, për vete po e thëllon! <sup>17</sup>Të gjitha ligësitë mbi kokë do t'i bien, dhe vdekjen vetes me punën e tij ia afron.

<sup>18</sup>Për besën e tij Zotin do ta lavdëroj; atij, Perëndisë më të lartë, me falënderim këngën time do t'ia këndoj.

### Madhështia e Perëndisë dhe dinjiteti i njeriut

**8** *Këngë e Davidit, që shoqërohet me një vegël muzikore nga Gati.*

<sup>2</sup>O Zot, o sundimtari ynë! Në mbarë botën shihet madhështia jote. Shkëlqimi i madhësisë sate ndriçon mbarë qiellin. <sup>3</sup>E pamasë është fuqia jote. Prej lavdisë së më të vegjëlve të popullit tënd, ti murin ndërton që kundërshtarët dhe armiqtë e tu i rrëzon. <sup>4</sup>Habitem me ato që ti krijove, me qiellin, me hënën, yjet që në orbitat e tyre i vendose. <sup>5</sup>Sa i vogël është njeriu! Megjithatë, ti kujdesesh për të.

<sup>6</sup>Atij i dhe pushtet e dinjitet. Dhe për pak, ai si ti do të ishte. <sup>7</sup>Sundues e bërë mbi krijesat në tokë.

Gjithçka që ti krijove, atij ia nënshtrove, <sup>8</sup>dele, dhi e bagëti të tjera, zogj, shpendë e kafshë të egra, <sup>9</sup>peshqit e gjithçka që rritet në det. <sup>10</sup>O Zot! O sunduesi ynë! Në mbarë botën që ti krijove, e pafund është madhështia jote!

### Perëndia kujdeset për drejtësinë

**9** *Këngë e Davidit për zërat e lartë djalosharë.*

<sup>2</sup>O Zot, me gjithë zemër do të të lavdëroj. Fuqinë e veprave të tua të gjithëve do t'ua tregoj. <sup>3</sup>Për ty do të ngazëllohem e do të gëzohem, O Perëndi i lartë, për ty do të këndoj.

<sup>4</sup>Armiqtë e mi përtokë u rrëzuan, vdekja i përfshiu sapo u shfaqe ti, të turpëruar, të njollosur u zmbropsën ata. <sup>5</sup>Në karrigen e gjykatësit ulur ti je dhe me ndihmën tënde të drejtën e fitova. Me vendimet e drejta që more ti, <sup>6</sup>armiqtë i shpartallove e të tjerët i kërcënovë. Qytetet e tyre ua zbraze, me shkatërrim i rrënovë dhe emrat e tyre përgjithmonë i shovë.

<sup>7</sup>Shtëpitë bëre gërmadha dhe qytetet shpopullove. Në harresë të përjetshme të gjitha i kalove. <sup>8</sup>Vetëm Zoti i gjallë përgjithmonë qëndron, nga fron i gjykatësit botën e gjykon. <sup>9</sup>Për të gjithë njerëzit vendime të drejta jep; të paanshme janë ato, siç është dhe ai vetë. <sup>10</sup>Të shtypurve mbrojtjen e tij u afron. Të sigurt ata ndihen atje ku ai i strehon. <sup>11</sup>Dhe të besoj ty, sepse e di kush je. Kush vjen tek ti, o Zot, në baltë nuk e lë. <sup>12</sup>Më këngën tuaj Zotin lavdëroni, që fronin e ka në malin e Cionit, dhe veprat e tij ndër popuj i njoftoni. <sup>13</sup>I dëgjon të varfrit kur ndihmë i kërkojnë, mundimet e të shtypurve nuk i harron dhe përndjekësve të tyre llogari u kërkon.

<sup>14</sup>O Zot, ki mëshirë për mua! Shiko si më shtrëngojnë me urrejtjen e tyre! Më largo nga portat e botës së të vdekurve. <sup>15</sup>Atëherë pranë portave të Jerusalemit do të qëndroj dhe të gjithëve do t'u them për se ty të lavdëroj.

<sup>16</sup>Popujt ranë në gropën që për të tjerët gërmuan. Ata rrjetat e tyre shtrinë, por vetë në to u kapën. <sup>17</sup>Dhe kështu, e drejta triumfoi. Me këtë, Zoti fuqinë e tij tregoi. Keqbërësit në kurthet e veta i lëshoi.

<sup>18</sup>Të mos harrojnë popujt që Perëndinë e mohojnë, se në botën e të vdekurve do të përfundojnë. <sup>19</sup>Sa për të varfrit, ata duken sikur janë harruar. Por shpresat e tyre nuk do të mbeten pa u plotësuar. <sup>20</sup>O Zot! Ndërhyr e kurrë mos lejo që njeriu të të dalë përballë! Përpara gjyqit tënd nxirri dhe vendimin tënd shpallu! <sup>21</sup>Mbushi zemrat e tyre me frikë e tmerr, O Zot! Tregoj atyre se janë veçse njerëz.

### **Përse nuk ndërhyr Perëndia?**

**10** Përse qëndron aq larg, o Zot? Nuk dimë nga t'ia mbajmë! Përse qëndron në heshtje? <sup>2</sup>Njerëzit e poshtër e të pacipë, të varfrit i ndjekin dhe me djallëzi në grackë ata i ndjellin. <sup>3</sup>Lakminë kanë për mburrje, mbi gjithçka vetëm fitimin vlerësojnë. O Zot, gjithmonë të shajnë e kurrë nuk të falënderojnë. <sup>4</sup>Mendjemadhësia dhe fodullëku i kanë pushtuar dhe guxojnë të thonë me mendjelehtësi: «Si do të na kërkojë llogari Zoti, kur ai nuk ekziston?» <sup>5</sup>Bëjnë si të duan dhe çdo gjë u shkon mbarë. Ti qëndron larg e shumë lart dhe ata nuk kujdesen aspak për dënimin tënd. Tallen e qeshin me çdo kundërshtar. <sup>6</sup>Kanë guxim dhe thonë: «Cila është ajo gjë që mund të na tronditë? Çdo fatkeqësi lehtas na kalon. Kështu ka qenë e kështu do të mbetet.» <sup>7</sup>Shajnë, gënjejnë e kërcënojnë dhe atij që ka guxim t'u kundërshtojë, i shkaktojnë humbje e fatkeqësi. <sup>8</sup>Në pritë, pranë fshatrave, ata qëndrojnë dhe presin njerëzit, kur andej të kalojnë. Fshatarëve përpara papritur u dalin dhe njerëzit e pafajshëm tinëz i vrasin. <sup>9</sup>Zënë pritë e ruajnë si luanë në shkurre, që viktimën ta zënë në rrjetat e tyre. <sup>10</sup>Si luanë përkulen kur hidhen në sulm e të varfrit i shtrijnë për tokë me dhunë. <sup>11</sup>Në këto raste thonë: «Perëndia larg qëndron. Ai nuk e di se ç'ndodh këtu.»

<sup>12</sup>Ndërhyr, o Perëndi! Ngrihu, o Zot! Merri në mbrojtje të dobët, mos i harro. <sup>13</sup>Përse i lejon të këqijtë të thonë: «Zoti ne nuk na ndëshkon»? Dhe të pabesët që të përbuzin, vallë si i duron? <sup>14</sup>I verbër ti nuk je! Fatkeqësitë e vuajtjet ti i sheh! Ndihmoji jetimët kur vijnë tek ti. Dhe mbështetje për të dobët bëhu ti.

<sup>15</sup>Shkatërroje pushtetin e keqbërësve; laji hesapet me ta; jepi fund krimin!

<sup>16</sup>Ti, o Zot, je mbret gjithmonë! Të huajt që për ty nuk duan t'ia dinë, duhet të zhduken nga toka jote.

<sup>17</sup>Lutjet e të varfërve ti i pranon; shpresë e guxim ti u jep, o Zot! Kujdesi yt ata i rrethon.

<sup>18</sup>Jetimëve e të shtypurve të drejtën ua jep. Terrorin të përhapë askujt më nuk ia lejon.

### **Siguria te Perëndia**

**11** *Këngë nga Davidi.*

Pranë 11Zotit jam i sigurt. Përse më thoni: «Shko në mal porsì zog!»? <sup>2</sup>Çeta e vrasësve tani harkun ka tendosur, shigjeta është në kordë gati për të qëlluar, njerëz të pafajshëm në terr për të vvarë.

<sup>3</sup>Kur prishet çdo rregull, ç'të bëjë atëherë njeriu që u përmbahet urdhërimeve të Perëndisë?

<sup>4</sup>Zoti është këtu, në Tempullin e tij të shenjtë; fronti i tij është në qiell. Sytë e tij u janë drejtuar njerëzve, asgjë nuk i shpëton shikimit të tij ngulmues. <sup>5</sup>Zoti i sheh besnikët e tij, edhe të tjerët që e përbuzin. Kush e do dhunën, atë Zoti e urren. <sup>6</sup>I dënon fajtorët me fatkeqësi të rënda; lëshon mbi ta zjarr dhe squfur, u dërgon atyre afshin përvëlues të diellit. <sup>7</sup>Zoti e plotëson atë që premtoi dhe i do të gjithë ata që mbajnë premtimin e tyre; kush i qëndron besnik, mund të jetojë në praninë e tij.

### **Perëndia e mban premtimin**

**12** *Këngë e Davidit e shoqëruar me vegël me tetë tela.*

<sup>2</sup>O Zot, na ndihmo, se besnikët e tu po pakësohen! Njerëz të besueshëm ka gjithnjë e më pak.

<sup>3</sup>Njerëzit gënjejnë njëri-tjetrin, me buzët gënjeshtarë lavdërojnë, kurse zemrat bëjnë lojë të dyfishtë.

<sup>4</sup>O Zot, pushoju këto buzë lajkatare! Mbylljau gojën këtyre llafazanëve arrogantë, <sup>5</sup>që thonë: «E kemi gjuhën brisk dhe gjithçka e nxjerrim në krye! E kemi gati përgjigjen; askush nuk mund të bëjë garë me ne!»

<sup>6</sup>«Po, – thotë Zoti, – tani po ndërhyj sepse i shtypin të varfrit dhe ata pa përkrahje po rënkojnë. Do t'u sjell

çlirim atyre që janë marrë nëpër këmbë.»

<sup>7</sup>Mund t'u besohet fjalëve të Zotit; ato janë të pastra dhe të kulluara si argjendi, që pastrohet shtatë herë në furrë.

<sup>8</sup>O Zot, ti e mban premtimin, tani dhe përgjithmonë; ti do të na ruash nga këta gënjeshtarë, <sup>9</sup>edhe në qoftë se gjithkund enden lirisht andej-këtej, edhe në qoftë se poshtërsia e tyre shtohet.

### **Frika dhe besimi**

**13** *Këngë e Davidit.*

<sup>2</sup>O Zot! Mos më ke harruar përgjithmonë? Edhe sa kohë do të fshihesh? <sup>3</sup>Edhe për sa kohë do të më mundojnë hallet; për sa kohë do të më brejnë shqetësimet? Edhe për sa kohë duhet të më mundojnë armiqtë e mi?

<sup>4</sup>Më shiko përsëri, o Zot! Jepmë përgjigje, o Perëndia ime! Bëj dritë përsëri para syve të mi, që të mos zhdukem në natën e vdekjes! <sup>5</sup>Ndryshe, armiqtë e mi do të thonë: «Atë e hoqëm qafe!», e do të ngazëllohen për rrënimin tim.

<sup>6</sup>Por unë mbështetem në besnikërinë tënde; ngazëllohem për ndihmën tënde. Me këngën time do të të falënderoj, o Zot, sepse ti u solle me kaq mirësi ndaj meje.

### **Nuk ka Perëndi?**

**14** *Këngë e Davidit.*

Janë të marrë ata që thonë: «Nuk ka Perëndi, që t'i japim llogari!» Këta njerëz janë të prishur dhe çdo gjë që bëjnë është e pështirë. Asnjëri prej tyre nuk bën mirë. <sup>2</sup>Që lart nga qielli Zoti vështron njerëzit, kërkon të shohë a ka ndonjë të arsyeshëm që atë kërkon. <sup>3</sup>Por, mjerisht, të gjithë dolën të pabesë, ata u prishën njëri pas tjetrit. Askush prej tyre nuk vepron drejt, as edhe një!

<sup>4</sup>«Ata janë të verbër – thotë Zoti. – Ku është logjika e këtyre keqbërësve? Ata e hanë popullin tim sikur të ishte bukë dhe askush prej tyre nuk më drejtohet mua.»

<sup>5</sup>Së shpejti do të tmerroheni, sepse Perëndia mbetet besnik ndaj atyre që e dëgjojnë. <sup>6</sup>Ju kishit për qëllim të shkatërronit shpresën e të varfërve, por Zoti atyre u jep mbrojtjen e sigurt.

<sup>7</sup>Me sa padurim po pres që të vijë Shpëtimtari i Izraelit nga mali i Cionit! Kur Zoti të ndryshojë fatin e popullit të tij, atëherë pasardhësit e Jakovit do të ngazëllohen; atëherë mbarë Izraeli do të gëzohet.

### **Kushtet e Perëndisë**

**15** *Këngë e Davidit.*

«O Zot, kush mund të hyjë në Tempullin tënd? Cilin e lejon të banojë në malin e shenjtë?»

<sup>2</sup>«Ja ç'kërkon Perëndia me ngulm: Ai duhet ta dëgjojë Zotin për gjithçka dhe të sillet me drejtësi në çdo rast. Ai duhet të mendojë e të thotë vetëm të vërtetën. <sup>3</sup>Në prani të të tjerëve, ai nuk duhet të flasë keq për asnjëri. Nuk duhet të bëjë asgjë që i sjell të keqe tjetrit dhe asgjë që diskrediton të afërmin. <sup>4</sup>Ai e përbuz njeriun që dënoi Perëndia, por nderon të gjithë ata që i përuken Perëndisë me respekt. Mban fjalën e dhënë, edhe atëherë kur kjo e vë në pozitë të vështirë. <sup>5</sup>Nuk kërkon asnjë kamatë për paratë që jep hua. Asnjëherë nuk merr ryshfet për t'u mohuar të pafajshmëve të drejtën e tyre.

Kush vepron kështu, mbetet përgjithmonë në themel të sigurt.»

### **Ti më tregon rrugën për në jetë**

**16** *Këngë e Davidit.*

Më mbro, o Zot! Kam besim tek ti. <sup>2</sup>Të them: «Ti je Zoti im. Lumturinë time e gjej vetëm tek ti!» <sup>3</sup>Sa të shkëlqyer janë besnikët e Zotit! Mua, mbi gjithçka, më pëlqen shoqëria me ta. <sup>4</sup>Kush vrapon pas perëndive të tjera, duhet të durojë tërë dënimin e tij. Unë nuk do të marr pjesë në flijimet e tyre; nuk do t'i adhuroj perënditë e tyre.

<sup>5</sup>O Zot, ti je fati i jetës sime, pjesa që më takon mua; të ardhmen time e mban në duart e tua. <sup>6</sup>Sa të mira e të mrekullueshme janë dhuratat që më dhuron!

<sup>7</sup>Zotin e adhuroj, sepse më drejton, edhe natën ndërgjegjia ime më paralajmëron. <sup>8</sup>Gjithnjë e ndiej praninë e Zotit; ai është afër dhe asgjë nuk më trondit. <sup>9</sup>Prandaj jam plot mirënjohje dhe gëzohem; e ndiej veten plotësisht të sigurt, <sup>10</sup>sepse ti më mbron nga pushteti i vdekjes. Të kam shërbyer me besnikëri e ti nuk do të më lësh në botën e të vdekurve. <sup>11</sup>Ti do të më tregosh udhën që më çon për në jetë; prania jote më mbush me gëzim dhe më sjell kënaqësi përgjithmonë.

### **Lutja e të pafajshmit të përndjekur**

**17** *Lutje e Davidit.*

O Zot, po kërkoj të drejtën! Dëgjoje ankesën time, pranoje lutjen time; sepse të lutem me gjithë zemër. <sup>2</sup>Vendimi yt do të më shfajësojë, sepse ti e sheh se jam i ndershëm dhe i drejtë.

<sup>3</sup>Ti i di mendimet e mia. Sonte do të vish, do të gjurmosh në zemrën time edhe hollësitë më të vogla dhe

nuk do të gjesh asgjë për të më qortuar. Mendimi im është në pajtim me fjalën time. <sup>4</sup>Në tërë jetën time jam drejtuar gjithnjë sipas fjalës sate e asnjëherë sipas shembullit të keqbërësve.

<sup>5</sup>Gjithnjë kam ndjekur udhën tënde; prej saj nuk jam shmangur asnjë hap.

<sup>6</sup>Po të drejtohem ty, o Perëndia ime, e di se do të më përgjigjesh. Tani drejtohu nga unë, dëgjoji fjalët e mia. <sup>7</sup>Tregomi mirësitë e tua të mrekullueshme, o Shpëtimtar i të gjithë atyre që kërkojnë tek ti strehim nga sulmet e të ligjve. <sup>8</sup>Më ruaj si ai që mbron dritën e syve të vet dhe më jep strehim nën flatrat e tua!

<sup>9</sup>Më shpëto nga keqbërësit që më mendojnë, nga armiqtë që më rrethojnë e duan të më zhdukin!

<sup>10</sup>Zemra e tyre është e pamëshirshme, goja e tyre flet fjalë të tmerrshme. <sup>11</sup>Tani po më rrethojnë dhe më vështrojnë, përgatiten që përdhe të më rrëzojnë. <sup>12</sup>Si luanë lakmitarë që rrinë gati për t'u hedhur, ata janë vërsulur pas viktimës për ta shqyer.

<sup>13</sup>Ngrihu, o Zot! Përballoji kundërshtarët e mi! Rrëzoji përdhe këta kriminelë, e më shpëto me shpatën tënde! <sup>14</sup>Më liro nga ata me dorën tënde të fortë! Shkurtoje shortin e tyre të jetës! Jepu atë që meritojnë; jepu të pijnë kupën e hidhërimit, le të ngopen me të edhe fëmijët e tyre, dhe për stërnipërit le të mjaftojë!

<sup>15</sup>O Zot, unë jam pa faj! Prandaj lejomë të të shoh. Kur të zgjohem, prania jote do të më mbushë me gëzim.

### Falënderim për ndihmën e Perëndisë

**18** *Nga Davidi, i besuari i Zotit. Ai e këndoi këtë këngë, sepse Zoti e kishte shpëtuar nga Shauli dhe të gjithë armiqtë e tjerë.*

<sup>2</sup>Atëherë ai këndoi: Të dua, o Zot, sepse falë teje jam i fortë! <sup>3</sup>Ti je shkëmbi im, kështjella ime, Shpëtimtari im, ti, Perëndia ime, strehimi im i sigurt, mbrojtësi im, ndihmësi im i fortë, fortesa ime në rrëpirë! <sup>4</sup>Kur të thërras për ndihmë, ti më shpëton nga armiqtë. Të lavdëroj, o Zot!

<sup>5</sup>Isha i lidhur me prangat e vdekjes, më sulmonin valë shkatërrimtare, <sup>6</sup>botë e të vdekurve më zinte në lak, kurthi i vdekjes më zuri përfund. <sup>7</sup>Në dëshpërimin tim thirra Zotin, Perëndinë tim, për ndihmë. Ai më dëgjoi në Tempullin e tij; thirrja ime për ndihmë shkoi gjer te veshi i tij. <sup>8</sup>Atëherë toka u tund dhe u shkund, themelet e maleve lëvizën; u drodhën para zemërimit të tij. <sup>9</sup>Një tym i errët i doli nga fejsat e hundës, flakë përpirëse lëshoi goja e tij, shkëndija të zjarra shoqëruan ato. <sup>10</sup>E uli qiellin përmbi tokë dhe fluturoi poshtë përmbi re të zeza. <sup>11</sup>Hipur mbi një engjell rojtar, ai u vërtit poshtë përmbi krahët e stuhisë. <sup>12</sup>U mbështoll me terr, me errësirën e shiut dhe me re të zeza. <sup>13-14</sup>Nga shkëlqimi i tij verbues u ndezën retë e breshëri dhe shkëndijat e zjarra flakërinë. Pastaj Zoti bëri qiellin të bubullojë, shungulloi zëri i madh i më të lartit Perëndi. <sup>15</sup>Qëlloi me shigjetat e tij dhe shpartalloi armiqtë e mi; rrufe u hodhi dhe i trembi.

<sup>16</sup>Atëherë u zbulua fundi i detit, u dukën themelet e tokës, kur ti, o Zot, kërcënove armiqtë e tu dhe i bërë të ndiejnë zemërimin tënd.

<sup>17</sup>Nga qielli shtriu duart, më kapi dhe më nxori nga valët, <sup>18</sup>më rrëmbeu nga armiku im i fuqishëm, nga kundërshtarët shumë të fortë që më urrenin. <sup>19</sup>Ata më sulmuan në ditën e fatkeqësisë, por Zoti më mbrojti prej tyre. <sup>20</sup>Më shpëtoi dhe ma ktheu lirinë. Më do, prandaj më ndihmoi.

<sup>21</sup>Zoti e shpërbleu bindjen time; e di se duart e mia janë të pastra. <sup>22</sup>Gjithnjë kam ndjekur udhën që ai më ka treguar; kurrë nuk u largova prej saj për shkak të ndonjë faji. <sup>23</sup>Urdhërimet e tij i mbaja gjithnjë para sysh, dhe urdhrat e tij kurrë nuk i kundërshtova. <sup>24</sup>Bëra pikërisht atë që kërkoi prej meje dhe gjithnjë iu shmanga padrejtësisë. <sup>25</sup>Zoti e ka shpërblyer dëgjuesën time; duart e mia janë të pastra, këtë ai e di.

<sup>26</sup>Kur një njeri të do, o Zot, ti i tregon dashuri; dëgjesa e plotë shpërblehet me mirësinë e plotë; <sup>27</sup>me të pastrit ti tregohesh me pastërti të kulluar, kurse me mashtruesit je shumë i ashpër. <sup>28</sup>Ti i vjen në ndihmë njeriut të vuajtur, por mendjemadhin e rrëzon nga kali i lartë. <sup>29</sup>Ti bën të shkëlqejë drita e jetës sime. Ti vetë, o Perëndi, ndriçon errësirën time. <sup>30</sup>Me ty shpartalloj hordhitë e armikut; me hirin tënd, o Perëndia ime, kapërcej bedenat e kalave.

<sup>31</sup>Gjithçka që bën Perëndia, është e përsosur dhe ajo që thotë Zoti, është pa dyshim e vërtetë. Kush është në rrezik dhe kërkon strehim tek ai, gjen gjithnjë atje mbrojtje të sigurt. <sup>32</sup>Zoti, dhe vetëm Zoti, është Perëndi. Vetëm Perëndia jonë është shkëmb mbrojtës, vetëm Ai. <sup>33</sup>Është Ai që më bën të fortë dhe rrugën time e bën të sigurt. <sup>34</sup>Këmbët m'i bën të shkathëta si të gazelës dhe të qëndrueshme në të gjitha majat e rrëpirat. <sup>35</sup>Është Ai që m'i stërvit duart për luftë dhe më mëson të ngreh harkun.

<sup>36</sup>O Zot, ti je mbrojtja dhe ndihma ime; ti më mban me dorën tënde të fuqishme; përgjigjja ndaj lutjes sime, më forcon. <sup>37</sup>Ti e ke hapur rrugën para meje; tani mund të përparoj pa pengesë. <sup>38</sup>I ndjek armiqtë e mi, i arrij dhe nuk prapsem derisa t'i shkatërroj. <sup>39</sup>I godita pa pushim, i shpartallova dhe ata nuk mund të ngrihen më, nën këmbët e mia janë shtrirë përdhe. <sup>40</sup>Ti ma dhe forcën për këtë luftë. Ti bërë që t'i mposht armiqtë e mi <sup>41</sup>dhe arratinë të marrin para meje; me ty unë arrita t'i shpartalloja të gjitha ata që më urrejnë. <sup>42</sup>Thirrën për ndihmë, por nuk kishte asnjë që t'i shpëtonte. Të thirrën ty, o Zot, për ndihmë, por ti nuk iu përgjigje aspak. <sup>43</sup>I bëra pluhur e hi, që t'i vërtitë era dhe i shkela si baltën e rrugës. <sup>44</sup>Ti më shpëton nga njerëz kryengritës dhe më bën sundimtar të mbarë botës. Fise të panjohura mua më nënshtrohen. <sup>45</sup>Të huaj vijnë dhe më puthin këmbët, dëgjojnë atë që u them dhe i binden menjëherë urdhrat tim. <sup>46</sup>Ata nuk kanë më forcë për të më kundërshtuar; dalin duke u dridhur nga strehimet e tyre.

<sup>47</sup>Zoti është gjallë! Dua ta lavdëroj shkëmbin tim mbrojtës! Do ta lavdëroj Perëndinë, shpëtimtarin tim.

<sup>48</sup>Më lejoi të marr hakun, m'i nënshtroi kombet <sup>49</sup>dhe më shpëtoi nga armiqtë e mi.

Po, o Zot, ti më vure përmbi ta dhe më rrëmbeve prej duarve të tyre mizore. <sup>50</sup>Prandaj do të të lavdëroj, dhe ndër popuj do të këndoj për lavdinë tënde. <sup>51</sup>Ti i jep mbretit fitore të mëdha; ti i tregon të zgjedhurit tënd të mira të mëdha. Kështu do ta trajtosh Davidin dhe bijtë e tij brez pas brezi.

### **Madhështia e Perëndisë në krijimin dhe në Ligjin e tij**

**19** *Këngë e Davidit.*  
<sup>2</sup>Qielli shpall: Perëndia është i madh! Për fuqinë e tij krijuese dëshmojnë yjet. <sup>3</sup>Njëra ditë ia përcjell këtë lajm tjetrës, secila natë ia transmeton tjetrës që vjen pas. <sup>4</sup>Asnjë fjalë nuk flitet, asnjë tingull nuk dëgjohet, <sup>5</sup>e, megjithatë, mesazhi i tyre përshkon mbarë tokën, ai depërton deri në skajet më të largëta të botës.

Qiellin Perëndia ia ndërtoi diellit për tendë. <sup>6</sup>Në mëngjes ai del si dhëndri nga dhoma e nuses; si fitimtar fillon udhëtimin e tij. <sup>7</sup>Lind në një skaj të qiellit dhe kalon deri në skajin tjetër. Asgjë nuk mund t'i fshihet syrit të tij të zjarrtë.

<sup>8</sup>Ligji i Zotit është i përsosur; ai jep forcë dhe jetë. Kërkesat e Zotit janë të nevojshme, ato i bëjnë naivët që të vijnë në vete. <sup>9</sup>Udhëzimet e Zotit janë të besuara, e mbushin zemrën me gëzim. Urdhërimet e tij janë të kthjellta; japin gjykim të mirë. <sup>10</sup>Fjala e tij është pa mashtrim, qëndron përgjithmonë. Vendimet e Zotit kanë fuqi të plotë dhe të gjitha pa përjashtim janë të përligjura. <sup>11</sup>Ato janë më tërheqëse se ari, se një sasi metalesh të çmueshme, më të shijshme se mjalti më i ëmbël.

<sup>12</sup>O Zot, edhe unë u bindem urdhërimeve të tua, sepse kush i zbaton ato, merr shpërblim të madh. <sup>13</sup>Çdo njeri bën gabime pa ditur; m'i fal fajet që më shpëtuan pa dashur. <sup>14</sup>Më ruaj nga njerëzit pa skrupuj, që ata të mos më mashtrojnë. Atëherë do të jem i pastër dhe i mbrojtur nga faji i rëndë. <sup>15</sup>Miratoftsh atë që kam thënë dhe menduar në praninë tënde, o Zot, o strehimi im, mbrojtësi im!

### **Urimi i bekimit për mbretin**

**20** *Këngë e Davidit.*  
<sup>2</sup>Zoti të dhëntë përgjigje, kur të biesh në rrezik dhe kur ta thërrasësh për ndihmë. Vetë Perëndia e Jakovit qoftë mbrojtësi yt. <sup>3</sup>Të dërgoftë ndihmë nga Tempulli i tij; të dërgoftë përkrahje nga mali i Cionit! <sup>4</sup>Mos harroftë asnjërën nga dhuratat e tua dhe pranoftë me mëshirë flijimin tënd të përkushtimit! <sup>5</sup>Plotësoftë dëshirën e zemrës sate, bëftë që të të shkojnë mbarë të gjitha planet e tua! <sup>6</sup>Atëherë ne do të ngazëllohem, sepse ai të ndihmoi të korrësh fitore. Do të lavdërojmë emrin e Perëndisë sonë dhe do të ngremë flamurin e ushtrisë sonë. Zoti të dhëntë gjithçka që ti kërkon tek ai!

<sup>7</sup>Tani e di: Zoti e përkrah mbretin e tij; nga shenjtërorja e tij në qiell i jep përgjigje, dora e tij e fuqishme ndërhyr dhe e liron. <sup>8</sup>Shumë kanë besim te karrocata e blinduara, të tjerët besojnë te kuajt; por ne besojmë në Zotin, Perëndinë tonë! <sup>9</sup>Ata të gjithë bien në gjunjë dhe rrëzohen përdhe, kurse ne qëndrojmë në këmbë dhe rezistojmë.

<sup>10</sup>O Zot, ndihmoje mbretin! Plotësoje lutjen tonë, kur të të thërrasim për ndihmë!

### **Gëzimi i mbretit**

**21** *Këngë e Davidit.*  
<sup>2</sup>O Zot, mbreti gëzohet dhe ngazëllohet, sepse ti je i fuqishëm dhe i dhe fitoren. <sup>3</sup>Ti e plotësove dëshirën e zemrës së tij dhe nuk ia kundërshtove lutjen. <sup>4</sup>Ti i dhuron lumturi dhe sukses, dhe i vë në kokë kurorën e artë. <sup>5</sup>T'u lut për jetë të gjatë – e pranove lutjen e tij; ti i jep shumë e shumë vite të pasura. <sup>6</sup>Fama e tij u bë e madhe në saje të ndihmës sate; ti e rrethon me madhësi dhe shkëlqim. <sup>7</sup>Ti bekon tërë jetën e tij, atë vetë dhe gjithçka që ndërmer ai. Ti e mbush me gëzim nëpërmjet pranisë sate. <sup>8</sup>O Zot, mbreti beson në ty. O Perëndi, ti i larti, me anë të mirësisë sate mbreti qëndron i sigurt dhe i patundur.

<sup>9</sup>O Zot, ti i zbulon të gjithë armiqtë e tu; dora jote e fuqishme do t'i gjejë të gjithë ata që të urrejnë. <sup>10</sup>Ti do t'i shkatërrosh me flakë të zjarrtë, në ditën kur do t'u shfaqesh. Zemërimi yt do t'i djegë si zjarri e do t'i përpijë me gjithçka. <sup>11</sup>Zhduke pjellën e tyre nga toka; shfarosua pasardhësit nga njerëzimi. <sup>12</sup>Ata u lidhën kundër teje dhe po hartojnë shumë plane të guximshme; por asgjë nuk do të arrijnë. <sup>13</sup>Sepse ti i qëllon me harkun tënd dhe i shpartallon. <sup>14</sup>O Zot, shfaqu me fuqinë tënde, dhe pastaj do të këndojmë për veprat e tua të mëdha.

### **Shpëtimi nga braktisja e madhe**

**22** *Këngë e Davidit, sipas melodisë 'Një drenushë në mëngjes'.*  
<sup>2</sup>O Perëndia ime, o Perëndia ime, përse më ke lënë në baltë? Përse nuk më dëgjon kur të thërras? Përse më rri kaq larg? <sup>3</sup>O Perëndia ime, ditë e natë të thërras për ndihmë, por ti nuk më jep përgjigje dhe nuk më jep asnjë shenjë. <sup>4</sup>Por ti je Perëndia e shenjtë, për nder të të cilit Izraeli këndon këngët e falënderimit. <sup>5</sup>Të parët tanë kishin besim tek ti, mbështeteshin në ty dhe ti i shpëtove. <sup>6</sup>Të thirrën për ndihmë dhe ti i çlirove; shpresat i varën tek ti dhe nuk u zhgënjyen.

<sup>7</sup>Prej meje nuk ka mbetur pothuajse asgjë! Jam krijesë e mjerë; të gjithë më përqeshin dhe më përbuzin.

<sup>8</sup>Kush më sheh, tallet me mua; shtrembërojnë buzët dhe tundin kokën. <sup>9</sup>Më thonë: «Besoji Zotit! Ai do të të ndihmojë. Nuk të lë në baltë! A nuk je ti i zgjedhuri i tij?» <sup>10</sup>Po, ti më nxore nga prehri i nënës, dhe në gjirin e saj më mësove të besoj. <sup>11</sup>Pa ty nuk mund të marr frymë; që prej lindjes, ti je Perëndia ime. <sup>12</sup>Tani mos më qëndro larg, sepse jam në rrezik! Askush tjetër nuk mund të më ndihmojë!  
<sup>13</sup>Shumë armiq më rrethojnë; si dema të egër më vijnë rrotull. <sup>14</sup>Si luanë të uritur ata ulërijnë. Me gojë të çapëlyer dhëmbët tregojnë. <sup>15</sup>Forcat më lanë si uji që derdhet; eshtrat e trupit zbërthehen të gjitha, zemra më bëhet si dylli nga nxehtësia. <sup>16</sup>Gryka më është tharë; gjuhë e qiellzë janë bërë bashkë. Të shtrirë përdhe ti më le, sikur i vdekur unë të isha. <sup>17</sup>Një bandë keqbërësish më rrethon, këta qen nuk më lënë të kaloj. Më çjerrin këmbë e duar. <sup>18</sup>Të gjitha brinjët e mia mund t'i numëroj; armiqtë pranë meje qëndrojnë, e gojëhapur më vështrojnë. <sup>19</sup>Short po hedhin për rrobat e mia; dhe ndërmjet tyre ato i ndajnë.  
<sup>20</sup>Mos qëndro larg meje, o Zot! Ti je shpëtimtari im, eja të më ndihmosh! <sup>21</sup>Më shpëto nga shpata e armiqve të mi, ma shpëto jetën nga kjo tufë qensh! <sup>22</sup>Më rrëmbe nga goja e luanit, më shpëto nga brirët e demave të egër! O Zot, ti e dëgjove lutjen time!  
<sup>23</sup>Do t'u tregoj vëllezërve të mi për ty; do të të lavdëroj në bashkësinë e besimtarëve. <sup>24</sup>Ju që i takoni Zotit: lavdërojeni Atë! Të gjithë ju, o pasardhësit e Jakovit, nderojeni! Mbarë Izraeli ta adhurojë! <sup>25</sup>Asnjë i mjerë nuk është tepër i vogël për Zotin; thirrja ime nuk ishte e bezdisshme për të. Nuk më ktheu shpinën, por e dëgjoi lutjen time për ndihmë. <sup>26</sup>Prandaj të falënderoj, o Zot, para mbarë kishës. Në prani të të gjithë atyre që të nderojnë, po të sjell fljimin që të premtova. <sup>27</sup>Le të ngopen të varfrit; ata që të kërkojnë, o Zot; le të këndojnë këngët e lavdisë; le të kenë jetë të gjatë!  
<sup>28</sup>Të gjitha kombet ta mendojnë mirë; të vijnë te Zoti nga të gjitha anët e botës për të rënë përmbys para tij. <sup>29</sup>Sepse Zoti është mbret; ai sundon mbi të gjithë popujt. <sup>30</sup>Para tij të gjithë të pushtetshmit duhet të përkulen; të gjithë të vdekshmit ta nderojnë, të gjithë ata që do të zbresin në botën e të vdekurve. <sup>31</sup>Edhe pasardhësit e tyre duhet t'i shërbejnë. Brezave të ardhshëm t'u tregohet për Zotin, <sup>32</sup>gjithmonë në të ardhmen do t'u tregohet fëmijëve çfarë bëri Zoti, dhe si e mban ai besën.

### Ti je bariu im

**23** *Këngë e Davidit.*

Ti, o Zot, je bariu im, prandaj kam gjithçka që më duhet. <sup>2</sup>Ti më çon në kullota të bollshme; ti më lejon të pushoj pranë ujit të freskët <sup>3</sup>e më jep forca të reja.

Ti më çon në rrugë të sigurta, sepse je bariu i Izraelit. <sup>4</sup>Edhe në qoftë se rruga më çon nëpër luginën e errët të vdekjes – nuk kam frikë! Ti, o Zot, je pranë meje; ti më mbron dhe më udhëheq; kjo më jep zemër.

<sup>5</sup>Para syve të armiqve të mi, ti më shtron tryezën; ti më pret si mysafir dhe ma mbush kupën deri në grykë.

<sup>6</sup>Mirësia dhe dashuria jote do të më rrethojnë për të gjitha ditët që do të vijnë; në shtëpinë tënde do të rri përgjithmonë.

### Hyrja në Tempull

**24** *Këngë e Davidit.*

Zotit i takon mbarë toka me gjithçka që jeton mbi të. <sup>2</sup>Ai e ndërtoi përmbi ujëra dhe ia hodhi themelet në fundin e detit.

<sup>3</sup>«Kush mund të ngjitet në malin e Zotit? Kush ka të drejtë të hyjë në vendin e shenjtë?» <sup>4</sup>«Duart e tij duhet të jenë krejt të pastra dhe ndërgjegjja e tij duhet të jetë e kulluar nga faji. Në mendjen e tij nuk duhet të ketë vend mashtrimi dhe në buzët e tij nuk duhet të vijë asnjë betim i rremë. <sup>5</sup>Zoti do ta pranojë një njeri të tillë; do t'ia plotësojë lutjet dhe do ta bekojë. <sup>6</sup>Të tillë janë njerëzit që kërkojnë Perëndinë dhe që mund t'i afrohen. Ata janë pasardhës të vërtetë të Jakovit.»

<sup>7</sup>«Hapuni krejt, ju porta të nderuara! Mbreti i fuqishëm do të hyjë!» <sup>8</sup>«Kush është ky mbret i fuqishëm?»

«Është Zoti, i Forti dhe i Fuqishmi! Zoti, Fitimtari i çdo beteje! <sup>9</sup>Hapuni krejt, ju porta të nderuara! Mbreti i fuqishëm do të hyjë!» <sup>10</sup>«Kush është ky mbret i fuqishëm?» «Është Zoti i qiellit dhe i tokës! Ai është mbreti i fuqishëm.»

### Ma fal fajin

**25** *Nga Davidi.*

Ty, o Zot, ta drejtoj zemrën dhe mendjen time. <sup>2</sup>Në ty, o Zot, besoj; mos më zhgënje! Këtë triumf nuk do ta kenë armiqtë e mi! <sup>3</sup>Askush nuk do të zhgënjehet në qoftë se i var shpresat tek ti; por njeriu pa besë që largohet prej teje, do të shkatërrohet.

<sup>4</sup>O Zot, ma trego rrugën, nëpër të cilën duhet të kaloj; lëjomë ta mësoj atë që ti kërkon prej meje. <sup>5</sup>Më mëso ta pranoh besnikërinë tënde dhe ta çoj jetën time duke të qëndruar besnik. Ti je ai tek i cili mund të gjej ndihmë; tek ti shpresoj në çdo kohë.

<sup>6</sup>Kujtohu, o Zot, se deri tani ti ke qenë gjithnjë plot me mirësi dhe me mëshirë. <sup>7</sup>O Zot, mos mendo më për gabimet e rinisë sime; as për fajet e mëvonshme; më mirë mendo për mua në dashurinë tënde – unë

mbështetem te mirësia jote!

<sup>8</sup>Zoti është i mirë dhe i besuar; mëkatarëve u tregon rrugën e drejtë. <sup>9</sup>Atyre që u janë hequr të drejtat, ua jep ato, dhe i mëson të njohin vullnetin e tij. <sup>10</sup>Gjithçka që bën Zoti, është mirësi dhe besnikëri për ata që respektojnë besëlidhjen e tij dhe dëgjojnë udhëzimet e tij.

<sup>11</sup>Për hir të nderit tënd, o Zot, ma fal fajin tim – aq i madh është ai!

<sup>12</sup>Çfarë bëhet me atë që e nderon Zotin me jetën e tij? Zoti i tregon atij rrugën që duhet të ndjekë. <sup>13</sup>Ai vetë jeton në lumturi, dhe fëmijëve të tij do t'u takojë toka (e premtuar). <sup>14</sup>Atij që e nderon Zotin me jetën e tij, Ai i hap mendjen dhe i tregon të fshehtat e besëlidhjes së tij. <sup>15</sup>Sytë e mi shikojnë gjithnjë drejt Zotit; ai do t'i nxjerrë këmbët e mia nga rrjeta.

<sup>16</sup>O Zot, kthehu nga unë dhe ki mëshirë për mua; jam krejt i vetmuar dhe i hutuar. <sup>17</sup>Zemra ime mundohet gjithnjë e më shumë nga ankthi; më liro nga çdo presion! <sup>18</sup>Hidhi sytë në mjerimin dhe në fatkeqësinë time! Ma fal tërë mëkatin tim! <sup>19</sup>Shikoj armiq të e mi, o Zot; kam kaq shumë dhe më urrejnë.

<sup>20</sup>Mbroje jetën time dhe më shpëto! Tek ti kërkoj strehim, mos më zhgënje! <sup>21</sup>Qysh tani jeta ime të udhëhiqet nga pastërtia dhe ndersshmëria; O Zot, kam besim tek ti.

<sup>22</sup>O Perëndi, çliroje Izraelin nga të gjitha hallet e tij!

### Lutja e të pandehurit të pafajshëm

**26** *Nga Davidi.*

<sup>1</sup>O Zot, më jep të drejtë! Nuk kam bërë asnjë faj; besnikëria ime ndaj teje është e patundur. <sup>2</sup>Më vër në provë, o Zot, provoji dëshirat dhe mendimet e mia!

<sup>3</sup>Mirësinë tënde kurrë nuk do ta harroj, dhe nga besnikëria jote jetoj. <sup>4</sup>Nuk kam punë me njerëz mashtrues as nuk merrem me të pabesët. <sup>5</sup>I shmangem shoqërisë me keqbërësit dhe rri larg njerëzve të pandërgjegjshëm.

<sup>6</sup>Si provë të pafajësisë sime laj duart, o Zot. Pastaj shkoj rreth altarit tënd për të të falënderuar me këngën time dhe për të shpallur veprat e tua të mrekullueshme. <sup>8</sup>E dua shtëpinë, ku banon ti, vendin ku je i pranishëm.

<sup>9</sup>Mos më vrit bashkë me mëkatarët; mos ma merr jetën, sikur të isha vrasës, <sup>10</sup>në duart e të cilit ka zënë vend padrejtësia dhe që jetën e bën me dhuratat e lajkatarëve. <sup>11</sup>Por unë bëj një jetë pa të meta. Prandaj ki mëshirë për mua dhe më shpëto!

<sup>12</sup>Tani mbështetem në themel të sigurt. Për këtë do ta lavdëroj Zotin, kur të mblidhet populli i tij.

### Nën mbrojtjen e Zotit

**27** *Nga Davidi.*

<sup>1</sup>Zoti është drita ime, më çliron dhe më ndihmon; prandaj nuk kam aspak frikë. Tek ai jam i sigurt si në kështjellë; prandaj nuk dridhem nga askush. <sup>2</sup>Kur armiq të e mi më shtypin, kur kërkojnë plot urrejtje të më vrasin; ata papritur rrëzohen dhe shkatërrohen. <sup>3</sup>Edhe në qoftë se mbarë ushtria më rrethon, nuk kam aspak frikë. Edhe kur vjen beteja, nuk shqetësohem.

<sup>4</sup>Kam vetëm një lutje për Zotin dhe kjo është dëshira e zemrës sime: gjatë tërë jetës sime dua të rri në Shtëpinë e tij, ta provoj çdo ditë mirësinë e tij ndaj meje, dhe të dëgjoj këshillën për rrugën që duhet të ndjek. <sup>5</sup>Kur të vij në ditë të këqija, Zoti do të më pranojë tek ai, do të më japë mbrojtje nën strehën e tij dhe do të më vendosë në themel të sigurt. <sup>6</sup>Atëherë do të triumfoj mbi armiq të e mi që më rrethojnë nga të gjitha anët. Në Tempull do të sjell fljimin tim, me ngazëllim të madh do ta falënderoj Zotin, do ta lavdëroj me këngë dhe me vegla muzikore.

<sup>7</sup>O Zot, më dëgjo kur të thërras; ki mëshirë për mua dhe më jep përgjigje! <sup>8</sup>Fjalët e tua i mbaj mend; ti the: 'Eja tek unë!' Prandaj e kërkoj praninë tënde, o Zot. <sup>9</sup>Mos u largo prej meje! Mos më hidh në zemërimin tënd! Gjithnjë më ke ndihmuar; mos më lër tani në baltë! Mos më braktis, o Perëndi, o shpëtimtari im!

<sup>10</sup>Edhe në qoftë se babai dhe nëna më mohojnë, ti, o Zot, më pranon.

<sup>11</sup>O Zot, më trego rrugën e drejtë, më ço në udhën e duhur, që të heshtin armiq të e mi. <sup>12</sup>Mos më dorëzo tek ata! Dëshmitarët që duan të më ngarkojnë me faj, janë gënjeshtarë që e shtrembërojnë drejtësinë!

<sup>13</sup>Por unë e di, nuk do të zbres poshtë ndër të vdekurit; mund të vazhdoj të jetoj për të parë mirësinë tënde. <sup>14</sup>Ki besim te Zoti, bëhu burrë dhe merr zemër, ki besim te Zoti!

### Ndihmë për rastet e jashtëzakonshme

**28** *Nga Davidi.*

<sup>1</sup>O Zot, të thërras për ndihmë! Ti, o mbrojtësi im, mos e bëj veshin të shurdhër! Në qoftë se me heshtje më refuzon, atëherë nuk ka më shpresë për jetën time. <sup>2</sup>Më dëgjo, kur të thërras, kur të thërras për ndihmë, kur me lutje i zgjas duart e mia drejt vendit më të shenjtë të Tempullit tënd.

<sup>3</sup>Mos më dëno bashkë me ata që përbuzin paturpësisht urdhërimet e tua, as bashkë me ata që veprojnë keq – që vërtet flasin butësisht me të gjithë, por në zemrat e tyre hartojnë plane të këqija. <sup>4</sup>Jepu shpërblimin e merituar; ndëshkoi për veprat e tyre; paguaja veprat e tyre të turpshme! <sup>5</sup>Ata nuk duan t'ia dinë për veprat e tua, nuk vënë re se si ndërhyti ti, o Zot! Ti do t'i rrëzosh përdhe, që të mos kenë mundësi të



ngrihen më.

<sup>6</sup>Lavdi Zotit, sepse e dëgjoi thirrjen time për ndihmë. <sup>7</sup>Më mbrojti dhe më ruajti; tek ai mund të mbështetem. Më ndihmoi, prandaj gëzohem nga zemra dhe e falënderoj me këngën time.

<sup>8</sup>Zoti është mbrojtësi i fuqishëm i popullit të vet; mbreti, që ai zgjodhi, është i sigurt pranë tij si në një kështjellë. <sup>9</sup>O Zot, shpëtoje popullin tënd! Bekoje, o Zot, popullin tënd, i cili të takon vetëm ty; na udhëhiq dhe na ndihmo!

### Madhështia e Perëndisë në stuhi

**29** *Këngë e Davidit.*

I gjithë nderimi i takon Zotit! Ju engjëj të fuqishëm, nderojeni Zotin, nënshtrojuni pushtetit të tij!

<sup>2</sup>Jepini nderin, ju që merrni anën e tij! Bini përmbys para tij për madhështinë dhe shenjtërinë e tij.

<sup>3</sup>Zëri i Zotit jehon përmbi ujë, Perëndia e fuqishme bën të bubullojë; Zoti është ulur në fron mbi oqeanë.

<sup>4</sup>Zëri i tij ushton i fuqishëm; gjëmon madhështor. <sup>5</sup>Cedrat e fortë ai i thyen, cedrat e Libanit i copëton.

<sup>6</sup>Shkrepata e Libanit kërcëjnë si viç, Hermoni hidhet përpjetë si buall i ri. <sup>7</sup>Zëri i tij lëshon flakë përvëluese.

<sup>8</sup>Shkretëtira dridhet nga zëri i tij; Zoti bën të tundet shkretëtira e Kadeshit. <sup>9</sup>Zëri i Zotit bën të dridhen lisat; ua heq gjethet pemëve të pyllit, dhe në sallën e fronit qiellor secili thërret: 'Nder Zotit!'

<sup>10</sup>Zoti ishte ulur në fron përmbi Përmbytje, e tani sundon si mbret përgjithmonë. <sup>11</sup>Zoti do t'i japë forcë popullit të vet, do t'i dhurojë atij lumturi dhe paqe.

### Ti ma ktheve jetën

**30** *Këngë e Davidit, për kushtimin e Tempullit.*

<sup>2</sup>Të lavdëroj, o Zot, sepse më nxore nga humnera dhe nuk u dhe armiqtë të mi asnjë arsye për t'u gëzuar për rrëzimin tim. <sup>3</sup>O Zot, o Perëndia ime, të thirra për ndihmë dhe ti më shërove. <sup>4</sup>Ti më nxore nga të vdekurit. Isha me një këmbë në varr e ti jetën më dhe rishtas.

<sup>5</sup>Ju të gjithë që i takoni Zotit, adhurojeni me këngët tuaja, falënderojeni atë dhe merreni parasysht shenjtërinë e tij! <sup>6</sup>Zemërimi i tij na prek vetëm për një çast, kurse mirësia e tij na rrethon përjetë. Në mbrëmje mund të derdhim lot, por në mëngjes brohorasim me gëzim. <sup>7</sup>Kur e ndjeva veten të sigurt, mendova: «E çfarë mund të më ndodhë mua?» <sup>8</sup>U tregove i mirë me mua, o Zot, dhe më mbrojte si kështjellë në shkëmb. Por pastaj ti u fshehe nga unë dhe më rrëzove në frikë dhe në tmerr. <sup>9</sup>Të thirra për ndihmë, o Zot, t'u luta: <sup>10</sup>«Ç'dobi ka në qoftë se vdes tani, në qoftë se duhet të zbres në varr? A mund të të falënderojë ndokush, kur të jetë bërë pluhur? A mund, atëherë, i vdekuri të lavdërojë besnikërinë tënde?»

<sup>11</sup>O Zot, ki mëshirë, më dëgjo, më ndihmo, o Zot!»

<sup>12</sup>Këngën time vajtuase ti e shndërrova në valle hareje, në vend të rrobave të zisë, më dhe petkat e festës.

<sup>13</sup>Nuk duhej të heshtja përgjithmonë; mund të të lavdëroj me këngët e mia. Ty, o Zot, të falënderoj përgjithmonë!

### Besoj në ty, o Zot

**31** *Këngë e Davidit.*

<sup>2</sup>O Zot, kërkoj strehim tek ti; mos lejo të zhgënjehem kurrë! Më shpëto siç më premtove! <sup>3</sup>Më dëgjo dhe eja, më ndihmo shpejt! Bëhu për mua shkëmbi shpëtues, mali mbrojtës; atëherë do të jem i sigurt. <sup>4</sup>Ti më jep mbështetje, ti më jep mbrojtje. Eja me mua e më udhëhiq, sepse ti je Perëndia ime. <sup>5</sup>Më ruaj nga gracka që më ngritën tinëz; sepse ti je mbrojtësi im! <sup>6</sup>Ty të dorëzohem plotësisht, ti do të më shpëtosh, o Perëndi, që e mban besën!

<sup>7</sup>I urrej të gjithë ata që jepen pas idhujve; unë vetë mbështetem në ty. <sup>8</sup>Gëzohem se ti je aq i mirë ndaj meje. Ngushticën time e pe dhe e kuptove se nuk kisha më shpresë. <sup>9</sup>Ti nuk më dorëzove tek armiqtë e mi, por më ngrite përsëri në këmbë dhe ma ktheve lirinë. <sup>10</sup>Ki mëshirë, o Zot; nuk di nga t'ia mbaj! Sytë e mi janë të lodhur nga të qarat, forcat më kanë lënë. <sup>11</sup>Jetën ma shkurtojnë shqetësimet. Hallet m'i pakësojnë vitet. Dëshpërimi m'i merr forcat, gjymtyrët nuk më punojnë më.

<sup>12</sup>Për armiqtë e mi jam bërë leckë, tallje jam për fqinjët e mi, fantazmë tmerri për miqtë e mi. Kur më shohin rrugës, ata largohen prej meje. <sup>13</sup>Më kanë harruar, si njeriu që ka vdekur prej kohësh, si enë e thyer dhe e hedhur mënjanë. <sup>14</sup>Dëgjo se si pëshpëritin vesh më vesh për mua; nga të gjitha anët më kërcënojnë. Këshillohen dhe mendohen se si të më vrasin. <sup>15</sup>Por unë mbështetem tek ti! Ti, o Zot, je dhe mbetesh Perëndia ime! <sup>16</sup>Ajo që do të ndodhë me mua, është në dorën tënde. Më shpëto nga armiqtë e mi dhe nga përndjekësit! <sup>17</sup>O Zot, ji mirëdashës me mua, sepse jam i yti. Më ndihmo, unë mbështetem në besnikërinë tënde! <sup>18-19</sup>Të thërras, o Zot, për ndihmë, mos më zhgënje! Por le të mashtrohen këta keqbërës. Dërgoji poshtë, në botën e të vdekurve, që të heshtin përgjithmonë, këta gënjeshtarë mendjemdhenj që shpifin paturpësisht për të pafajshmit.

<sup>20</sup>Sa e madhe është mirësia jote, o Zot! Ti u shfaqesh atyre që të dëgjojnë. Në sy të të gjithëve kjo mirësi u jepet atyre që kërkojnë strehim tek ti. <sup>21</sup>Pranë teje ata janë të sigurt, nën strehimin tënd janë të mbrojtur nga të gjitha intrigat. Ti i mbron nga shpifësit e tyre. <sup>22</sup>Të falënderoj, o Zot! Ti e tregove mirësinë tënde; ti bërë mrekulli kur armiqtë e mi më shtrëngonin nga të gjitha anët. <sup>23</sup>Isha i frikësuar kur mendoja se isha i

dëbuar nga prania jote. Por ti më dëgjove kur të thirra për ndihmë.

<sup>24</sup>Duajeni Zotin, ju, besnikët e tij, sepse ai e mbron atë që ia mban besën. Por të gjithë ata të cilëve u rritet mendja, i gjen zemërimi i tij. <sup>25</sup>Ju që besoni te Zoti, bëhuni të fortë dhe merrni zemër!

### Gëzimi i ndjesës

**32** *Poemë e Davidit.*

<sup>1</sup>Të gëzohen të gjithë ata, të cilëve Perëndia ua fali gabimin dhe ua mbuloi mëkatën. <sup>2</sup>Të gëzohen të gjithë ata, të cilëve Zoti nuk ua llogarit fajin dhe jeta e të cilëve është pa mashtrim.

<sup>3</sup>O Zot, në fillim desha ta fshihja fajin tim, por u sëmura, kështu që rënkova gjithë ditën. <sup>4</sup>E ndjeva dorën tënde që më shtypte ditë e natë, që forcat jetësore m'i shteroi, si burimi në thatësinë e verës. <sup>5</sup>Prandaj vendosa t'i pranoja gabimet e mia. Atë që bëra, e pranova; nuk ta fsheha më fajin tim. E ti më fale gjithçka! <sup>6</sup>Prandaj kushdo që ta mban besën, të të lutet ty, kur mund të të gjejë. Kur fatkeqësia të më përmbytë si baticë, me siguri nuk do të më përpijë. <sup>7</sup>Tek ti gjej mbrojtje. Ti e mban larg meje rrezikun, që unë të ngazëllohem për shpëtimin tim.

<sup>8</sup>Zoti m'u përgjigj kështu: «Unë do të them se ç'duhet të bësh dhe do të të tregoj rrugën e drejtë. Nuk të heq nga sytë. <sup>9</sup>Mos u bëj i pa mend si mushka ose kali që duhet të tërhiqet për freri. Atëherë ty nuk do të ndodhë asgjë e keqe.»

<sup>10</sup>Kush nuk i përfill urdhërimet e Perëndisë, i shkakton vetes shumë mundime; por kush i beson Perëndisë, do të provojë mirësinë e tij. <sup>11</sup>Ju që e dëgjoni Zotin, gëzohuni dhe ngazëllohuni për të. Kush merr anën e tij, të këndojë nga gëzimi.

### Krijuesi i botës mbron popullin e tij

**33** Brohoritni Zotin, sepse jeni populli i tij. Ju që e dëgjoni, ju keni nderin ta lavdëroni. <sup>2</sup>Falënderojeni Zotin me lirë. Luani për nder të tij në harpë me dhjetë tela. <sup>3</sup>Këndoni për të një këngë të re, këndonin e luani, këndonin më gjithë zemër.

<sup>4</sup>Ajo që thotë Zoti, duhet të besohet; këtë e provon me veprat e tij. <sup>5</sup>Ai do që të mbretërojnë e drejta dhe drejtësia; mbarë bota jeton nga mirësia e tij. <sup>6</sup>Qielli u krijua me fjalën e Perëndisë, dhe yjet në qiell me urdhrin e tij. <sup>7</sup>Ujërat e qiellit i ka ruajtur në re, oqeanin e ka mbyllur në depot e tij. <sup>8</sup>Prej tij duhet të frikësohet mbarë bota dhe para tij duhet të dridhet çdo njeri. <sup>9</sup>Sepse kur ai flet, bëhet çdo gjë; kur jep urdhër, zbatohet.

<sup>10</sup>Zoti i prish planet e popujve; synimet e tyre ai i përmbys. <sup>11</sup>Por vendimin që merr vetë, e zbaton dhe plani i tij i sigurt qëndron përgjithmonë. <sup>12</sup>Lum ai popull që Zotin ka për Perëndi, të cilin Ai e zgjodhi si pronën e tij!

<sup>13</sup>Zoti hedh vështrimin nga qielli mbi njerëzit; <sup>14</sup>që lart nga fronti i tij, banorët e tokës shikon. <sup>15</sup>Mendje e vullnet ai u ka dhënë, çfarë bëjnë, me se merren, ai mirë e di. <sup>16</sup>Kur mbreti fitoren korr në betejë, për nder nuk ia di ushtrisë së tij të madhe, dhe kur ushtari i paprekur shpëton, këtë nuk ia detyron forcës së tij. <sup>17</sup>Kush beson në ushtri kalorësish, mbetet në baltë, sepse nuk janë kuajt ata që e sjellin fitoren. <sup>18</sup>Por Zoti i mbron të gjithë ata që e dëgjojnë, të gjithë ata që mbështeten në besën e tij. <sup>19</sup>Ai do t'i ruajë nga vdekja dhe ata do të mbeten gjallë kur uria të mbjellë të zezën.

<sup>20</sup>Shpresojmë te Zoti, na ndihmon dhe na mbron. <sup>21</sup>I besojmë atij dhe qëndrojmë në të. <sup>22</sup>O Zot, na lejo ta shohim mirësinë tënde, ashtu siç e presim.

### I liruar nga shqetësimi

**34** *Nga Davidi. Këtë këngë ai e hartoi, kur e kishte dëbuar Avimelehu, sepse në praninë e tij Davidi ishte shtirur si i çmendur.*

<sup>2</sup>Zotin do ta lavdëroj në çdo kohë, kurrë nuk do të pushoj së falënderuari. <sup>3</sup>Për atë që bëri, do ta mburr. Dëgjojeni këtë, ju që keni besim tek ai dhe gëzohuni. <sup>4</sup>Lavdërojeni bashkë me mua veprat e Zotit; ta nderojmë së bashku emrin e tij!

<sup>5</sup>Unë iu drejtova Zotit dhe ai m'u përgjigj; më liroi nga të gjitha shqetësimet e mia. <sup>6</sup>Kur njeriu shikon drejt Zotit, lumturia i shkëlqen në fytyrë dhe nuk do të zhgënjehet për besimin e tij. <sup>7</sup>Këtu qëndron një njeri që thërret për ndihmë. Zoti e dëgjoji dhe e shpëtoi nga çdo ngushticë. <sup>8</sup>Të gjithë ata që e dëgjojnë Zotin, engjëlli i tij i rrethon me mbrojtjen e fuqishme dhe i çon larg rrezikut. <sup>9</sup>Provoje këtë vetë dhe do ta shohësh që Zoti është i mirë! Sa të lumtur janë ata që kërkojnë strehim tek ai. <sup>10</sup>Ju që i përkisni Zotit, nënshtrojeni atij! Kush e dëgjon, gjen një asnjë hall. <sup>11</sup>Madje edhe luanët e fortë vuajnë shpeshherë nga uria, por ai që vjen te Zoti, gjen gjithçka që i duhet për jetën.

<sup>12</sup>Ejani, ju të rinj, më dëgjoni! Unë do t'ju them se ç'do të thotë ta nderoni Zotin me jetën tuaj. <sup>13</sup>A dëshironi ju të arrini diçka në jetën tuaj dhe mundësisht të kaloni ditë të lumtura? <sup>14</sup>Atëherë shikoni që gjuha juaj të mos thotë gënjeshtër e shpifje për askënd. <sup>15</sup>Kthejini shpinën së keqes dhe bëni mirësi! Bëni çmos për të ruajtur paqen me të gjithë!

<sup>16</sup>Zoti kujdeset për ata që i qëndrojnë besnikë, dhe thirrjet e tyre i dëgjon. <sup>17</sup>I kundërshton ata që veprojnë keq, dhe bën që, bashkë me ta, të vdesë edhe kujtimi i tyre.

<sup>18</sup>Por kur të thërrasin besnikët e tij, i dëgjon dhe i shpëton nga çdo ngushticë. <sup>19</sup>Kur ata janë të dëshpëruar dhe nuk kanë më zemër, u shkon pranë dhe i ndihmon.

<sup>20</sup>Kush besnik Zotit i qëndron, nëpër shumë rreziqe kalon, por nga të gjitha ato Zoti e shpëton. <sup>21</sup>Ai bën që të mos dëmtohet trupi i tij dhe thyerje kockash të mos pësojë.

<sup>22</sup>Kush bën keq, atë e keqja do ta vrasë. Kush i urren besnikët e Zotit, nuk do t'i shpëtojë dënimit të tij.

<sup>23</sup>Zoti e shpëton jetën e shërbëtorëve të tij; nuk ka asnjë dënim për ata që i drejtohen atij për ndihmë.

### Zoti merr në mbrojtje të dobët

**35** *Nga Davidi.*

<sup>1</sup>O Zot, fajësoji ata që më paditin; sulmoji kundërshtarët e mi. <sup>2</sup>Merre mburojën dhe armët, eja të më ndihmosh. <sup>3</sup>Vringëlloje heshtën, pritjau rrugën, që të mos më arrijnë ata që më ndjekin. Jepma premtimin se do të më ndihmosh!

<sup>4</sup>Turp e faqe të zezë paçin ata që duan të më vrasin! Detyrohen të zbrapsen të turpëruar të gjithë ata që hartojnë plane të këqija kundër meje. <sup>5</sup>U shpërndafshin si kashta nga era, kur t'i dëbojë engjëlli i Zotit.

<sup>6</sup>Rruga e tyre u bëftë e errët dhe e rrëshqitshme, kur engjëlli i Zotit t'i ndjekë nga pas. <sup>7</sup>Pa arsye më kanë ngrehur një grackë; më kanë hapur një gropë, të cilën e kanë mbuluar me rrjetë. <sup>8</sup>Krejt papritur i zëntë fatkeqësia. U zënshin në grackën e tyre dhe rënshin në gropën, që kanë hapur vetë.

<sup>9</sup>Por unë do të ngazëllohem e do të gëzohem, sepse Zoti më ndihmoi. <sup>10</sup>Me gjithë zemër Zotit do t'i them: «O Zot, askush nuk është si ti! Ti e ndihmon të dobët kundër të fortit, ti e mbron të pambrojturin dhe të varfrin nga ai që dëshiron t'i grabitë.»

<sup>11</sup>Dëshmitarë të rremë dëshmojnë kundër meje. Më marrin në pyetje për një krim, për të cilin nuk di asgjë.

<sup>12</sup>Të mirën e shpërblejnë me të keqe; asgjë nuk më mbetet veç vetmisë. <sup>13</sup>Më parë, kur njëri prej tyre ishte i sëmurë, u veshëm me të zeza. Për t'ia larguar sëmundjen, hoqa dorë nga ushqimi; kokën e përkula thellë mbi gjoks dhe për të iu luta Perëndisë, <sup>14</sup>sikur ta kisha vëllanë ose mikun tim. U enda si ai që vajton nënën e vet, i pikëlluar dhe plot vuajtje. <sup>15</sup>Kurse tani, ata gëzohen për fatkeqësinë time dhe bashkohen kundër meje. Edhe harbutët e pafytyrë, njerëz të panjohur, vijnë dhe nuk pushojnë së shari. <sup>16</sup>Tallen me pamjen time të shëmtuar, m'i skërmitin dhëmbët me kërcënim. <sup>17</sup>O Zot, edhe sa kohë do t'i shikosh në heshtje? Më shpëto nga sulmet e tyre. Ruaje jetën time nga ata luanë. <sup>18</sup>Atëherë do të të falënderoj para mbarë kishës, para popullit të mbledhur do të të lavdëroj. <sup>19</sup>Mos lejo që armiqtë e mi, kjo bandë gënjeshtarësh, të ngazëllohen për fatkeqësinë time! Më urrejnë pa asnjë arsye dhe me vetëdije i shkelin syrin njëri-tjetrit. <sup>20</sup>Kurrë nuk dëgjohet prej tyre një fjalë e mirë. Kundër njerëzve të qetë dhe paqedashës të vendit, hartojnë gjithnjë shpifje të reja. <sup>21</sup>Hapin gojën kundër meje dhe tallen: «Ja, e shihni këtë? Ja ku e kemi provën!»

<sup>22</sup>Ti, o Zot, ke parë gjithçka! Mos hesht më, mos qëndro larg meje! <sup>23</sup>Ngrihu, ndërhyr, ndaj drejtësinë! O Zoti dhe Perëndia ime, merre në dorë çështjen time! <sup>24</sup>Ti je i drejtë, o Zot, më shpall të pafajshëm; mos i lejo të kënaqen fshehtas për fatkeqësinë time! <sup>25</sup>Mos i lejo kurrë të thonë: «Më në fund arritëm ta heqim qafel!» <sup>26</sup>Të mbeten të zhgënjyer të gjithë ata që gëzohen për fatkeqësinë time! Të tërhiqen me turp e me faqe të zezë, ata që më shikojnë me përbuzje. <sup>27</sup>Por të gjithë ata që kërkojnë pafajësinë time, të ngazëllohen e gjithnjë të thonë: «Zoti është i madh! Ai kujdeset që njeriu i besuar i tij të jetojë në lumturi dhe në paqe.»

<sup>28</sup>Unë vetë do ta shpall besnikërinë tënde; përherë do të të lavdëroj.

### Ligësia e njerëzve dhe mirësia e Perëndisë

**36** *Nga Davidi, i besuari i Zotit.*

<sup>1</sup>Rebelimin kundër Perëndisë njerëzit e ligj e kanë në gjak, për ta nuk është asgjë e shenjtë. <sup>2</sup>Ata janë shumë mendjemdhenj për ta zbuluar padrejtësinë e vet dhe për ta urreyer atë. <sup>3</sup>Gjithçka që thonë është gënjeshtër e mashtrim; ajo që bëjnë, nuk është as e arsyeshme, as e mirë. <sup>4</sup>Madje edhe në shtrat hartojnë plane të liga. Ngulin këmbë me veprat e tyre të këqija; asgjë nuk i mban nga ligësia e tyre.

<sup>5</sup>O Zot, mirësia jote arrin deri në qiell dhe besnikëria jote deri në re! <sup>6</sup>Drejtësia jote ngrihet lart si malet e përjetshme, vendimet e tua kanë themele të thella si thellësia e oqeanëve. Ti, o Zot, ndihmon njerëzit dhe kafshët. <sup>7</sup>Dashuria jote është e pashoqe. Ti je Perëndia jonë, tek i cili gjejmë mbrojtje. <sup>8</sup>Ti na ngop me pasurinë e shtëpisë sate; mirësia jote na i përtërin forcat si uji i freskët. <sup>9</sup>Ti vetë je burimi që na jep jetën. Dashuria jote është dielli nga i cili jetojmë.

<sup>10</sup>Qëndro tek ata që të njohin për Zot, tregohu i mirë ndaj atyre që të dëgjojnë. <sup>11</sup>Mos i lejo mendjemdhenjtë të më shtypin, as njerëzit e ashpër të më dëbojnë nga shtëpia ime dhe nga vendi im.

<sup>12</sup>Unë i shoh se si rrëzohen ata keqbërës; ata janë të shtrirë përdhe dhe nuk ngrihen më.

### Përvoja nga jeta me Zotin

**37** *Nga Davidi.*

Mos u shqetëso për njerëzit që përbuzin urdhërimet e Zotit! Edhe në qoftë se u shkon mbarë

keqbërësve, mos i ki zili! <sup>2</sup>Sepse së shpejti do të thahen si bari, si bimët e vjeshtës do të fishken. <sup>3</sup>Mbaji besën Zotit dhe bëj atë që është e drejtë; atëherë do të qëndrosh në tokën (e premtuar) e do të jetosh i sigurt. <sup>4</sup>Lejoje Zotin të jetë burimi i gëzimit tënd; ai do të plotësojë çdo dëshirë tëndën. <sup>5</sup>Vëre fatin tënd në dorën e Zotit, mbështetu në të dhe ai do të bëjë që të të dalë mirë! <sup>6</sup>Besnikërinë tënde ndaj tij ai do ta bëjë të dukshme si drita dhe të drejtën tënde do ta bëjë të ndritë si dielli në mesditë. <sup>7</sup>Rri i qetë para Zotit, prite me qetësi veprimin e tij! Kur ndonjërit i shkojnë mirë punët e tij të këqija, mos u shqetëso! <sup>8</sup>Mos lejo që të të përfshijë inati dhe zemërimi; mos u inatos kur të tjerët vepronë keq, që të mos i bësh keq vetes! <sup>9</sup>Kush e kundërshton Perëndinë, do të shfaroset; por kush i var shpresat tek ai, Zoti do t'i japë tokën (e premtuar). <sup>10</sup>Edhe pak e do të zhduken të këqijtë, atyre nuk do t'u gjesh më asnjë gjurmë. <sup>11</sup>Por atyre që kanë besim te Zoti, do t'u takojë toka (e premtuar) dhe nuk do t'u mungojë asgjë për lumturinë e tyre. <sup>12</sup>Ai që e përbuz Zotin kërcëllin dhembët kundër atij që i qëndron besnik Perëndisë dhe me urrejtje bën plane që ta shkatërrojë. <sup>13</sup>Por Zoti nuk shqetësohet për të, sepse e di që dita e gjyqit po afrohet. <sup>14</sup>Të këqijtë e kanë nxjerrë shpatën, e kanë tendosur tashmë harkun. Ata duan të vrasin të varfërit dhe të pambrojturit, të gjithë ata që bëjnë jetë të drejtë. <sup>15</sup>Por shpatat do të ngulen në zemrat e tyre, dhe harqet do t'u thyhen. <sup>16</sup>Të jesh i varfër, por të jetosh me Zotin, është më mirë se të kesh gjithë pasurinë e atyre që jetojnë në kundërshtim me parimet e tij; <sup>17</sup>sepse Zoti ua heq pushtetin kundërshtarëve të tij, por ata që besojnë në të, ai i bën të fortë. <sup>18</sup>Zoti kujdeset çdo ditë për ata që për gjithçka jetojnë sipas parimeve të tij. Toka që do t'u japë ai, do të mbetet përgjithmonë pronë e tyre. <sup>19</sup>Në ditë të keqe nuk i zhgënjën; në kohë urie i ushqen. <sup>20</sup>Por armiqtë e Zotit do të vdesin; të këqijtë do të zhduken si lulet e fushave, do të digjen në zjarr dhe era do ta shpërndajë hirin e tyre. <sup>21</sup>Kush nuk e përfill Zotin, mbetet gjithmonë borxhli. Kush e dëgjon Zotin, ka gjithmonë për të tjerët dhe për vete përsëri i mbeten. <sup>22</sup>Njerëzit që i bekon Zoti, për pronë kanë tokën (e premtuar); por kush mbetet nën mallkimin e tij, vdes. <sup>23</sup>Zoti kënaqet me njeriun e ndershëm, dhe e drejton atë në çdo veprim. <sup>24</sup>Edhe kur pengohet, nuk rrëzohet përdhe, sepse Zoti e mban për dore. <sup>25</sup>Kam jetuar shumë gjatë; kurrë nuk kam parë një besnik të Perëndisë të braktiset prej tij; fëmijët e tij kurrë nuk kanë mbetur pa bukë. <sup>26</sup>Çdo ditë ai mund të japë hua bujarisht dhe fëmijët e tij të kenë bekim. <sup>27</sup>Ktheji shpinën së keqes dhe bëje të mirën; atëherë banesa jote do të jetë përgjithmonë e sigurt. <sup>28</sup>Sepse Zoti e do të drejtën dhe nuk e braktis atë që i qëndron besnik; atë e mbron gjithmonë. Por pasardhësit e armiqve të Zotit do të asgjësohen. <sup>29</sup>Të bindurve do t'u takojë toka (e premtuar); ata do të banojnë përgjithmonë atje. <sup>30</sup>Kush i takon Zotit, flet me mend, thotë atë që i përgjigjet vullnetit të Tij. <sup>31</sup>Ligjin e Zotit e mban në zemër, prandaj nuk largohet nga rruga e drejtë. <sup>32</sup>Kush e përbuz Zotin, pret ta vrasë njeriun që i bindet Atij. <sup>33</sup>Por Zoti nuk lejon që ai të bjerë në duart e vrasësve ose që të dënohet në mënyrë të paligjshme. <sup>34</sup>Vari shpresat te Perëndia dhe dëgjoji urdhërimet e tij; atëherë ai do të të nderojë dhe tokën (e premtuar) do të ta dhurojë, e ti do ta shohësh se si shkatërrohen armiqtë e tij. <sup>35</sup>Kam parë një njeri të keq se si e shpërdoronte pushtetin e tij; rritej gjithnjë e më shumë, si një pemë në tokë pjellore. <sup>36</sup>Por, kur kalova përsëri, ishte zhdukur plotësisht. E kërkova, por nuk i gjeta asnjë gjurmë. <sup>37</sup>Përfilli njerëzit e ndershëm dhe të panjollë, e do të shohësh: kush e do paqen, atij do t'i mbeten pasardhësit. <sup>38</sup>Por keqbërësit do të shkatërrohen të gjithë, dhe pasardhësit e tyre do të shfarosen. <sup>39</sup>Zoti i ndihmon ata që marrin anën e tij. Kur afrohet rreziku, ata gjejnë strehim tek ai. <sup>40</sup>Ai i shpëton dhe i ndihmon. Nga e keqja do t'i shpëtojë dhe do t'i ndihmojë, sepse tek ai kërkohen mbrojtje.

## Nën barrën e sëmundjes dhe të fajësisë

**38** *Këngë e Davidit, që Perëndia ta kujtojë.*

<sup>2</sup>O Zot, ti je zemëruar me mua dhe po më dënon. Mjaft më, jepu fund mundimeve të mia! <sup>3</sup>Shigjetat e tua më shpojnë dhe dora jote më qëllon me goditje të fuqishme.

<sup>4</sup>Në trupin tim nuk duket asgjë e shëndoshë dhe asnjëra nga gjymtyrët e mia nuk është e saktë. Kjo është përgjigjja jote për fajin që kam bërë; kjo është arsyeja e zemërimit tënd. <sup>5</sup>Mëkatet e mia më kanë mbuluar kokë e këmbë; vuaj aq shumë, sa që nuk mund të duroj më. <sup>6</sup>Qeshë shumë budalla se nuk të nderova me jetën time. Prandaj plagët e mia qelbëzohen dhe mbajnë erë të pështirë. <sup>7</sup>I përkulur nga dhembjet, i shpartalluar dhe i dërrmuar nga vuajtja hiqem zvarrë ditaditës. <sup>8</sup>Thellë në trup i ndiej ethet që më djegin. Në mbarë trupin tim nuk ka një vend të shëndoshë.

<sup>9</sup>Po më mbarojnë forcat, tortura është tepër e madhe, kam fuqi vetëm të bërtas. <sup>10</sup>Ti e di se ç'dëshiroj me gjithë zemër, o Zot! Ti e dëgjove gjithë rënkimin tim. <sup>11</sup>Të rrahurat e zemrës sime janë të dobëta; forcat e mia po shterojnë, edhe sytë nuk më shohin më. <sup>12</sup>Miqtë dhe fqinjët e mi më shmangen, frikësohen nga fatkeqësia ime. Edhe të afërmit më qëndrojnë larg. <sup>13</sup>Kërkohen të më vrasin, më ngrenë gracka, më duan të keqen, flasin që të më dëmtojnë dhe shpifin gjithë ditën.

<sup>14</sup>Por, unë shtirem si i shurdhër, sikur nuk dëgjoj asgjë; goja ime mbetet e mbyllur, sikur të isha memec.

<sup>15</sup>Shtirem si njeriu që nuk dëgjon, prandaj edhe nuk përgjigjem. <sup>16</sup>Sepse besoj në ty, Perëndia ime dhe Zoti

im; ti do t'u japësh përgjigje në vendin tim. <sup>17</sup>Nuk dëshiroj që ata ta festojnë fatkeqësinë time, që t'u rritet mendja, kur pengohem. <sup>18</sup>Sepse edhe pak e do të rrëzohem; dhembjet e vazhdueshme këtë më sjellin në mendje.

<sup>19</sup>E pranoj: mëkatova dhe nuk gjej qetësi për shkak të fajësisë sime. <sup>20</sup>Por armiqtë e mi të betuar janë të pushtetshëm dhe të fuqishëm; shumë prej tyre më urrejnë pa arsye. <sup>21</sup>Të mirën ma shpërblejnë me të keqe; më përndjekin sepse kërkoj mirësi.

<sup>22</sup>O Zot, mos më lër në baltë, mos qëndro larg meje, Perëndia ime! <sup>23</sup>Eja shpejt e më ndihmo, o Zot, ti shpëtimtari im!

### **O Zot, më trego sa e shkurtër është jeta ime!**

**39** *Këngë e Davidit për Jedutin.* <sup>2</sup>Kisha vendosur të tregohesha i kujdesëshëm, dhe të mos thoja asgjë, për të cilën mund të më bënin fajtor; të heshtja në prani të njerëzve të poshtër, sikur ta kisha gjuhën të lidhur. <sup>3</sup>Gojën nuk e hapa, por përsëri asgjë nuk ndryshoi, sepse torturat e mia u bënë gjithnjë e më të forta: <sup>4</sup>Zemra më digjej si zjarr dhe për pak do të më pëlciste; atëherë nuk mund të duroja më, vendosa të flisja!

<sup>5</sup>O Zot, më trego edhe sa ditë më kanë mbetur deri në fund të jetës sime, si po vjen mbarimi im në mënyrë të pashmangshme; më trego kur do të më vijë fundi. <sup>6</sup>Për ty e gjithë jeta ime është e gjatë vetëm një pëllëmbë dhe, në sytë e tu, ajo zgjat vetëm një çast. Njeriu që mendon se është diçka, për ty nuk është tjetër veçse një hije. <sup>7</sup>Vjen dhe shkon, por gjithçka i ngjan ëndrrës; është i zënë me punë dhe bën zhurmë – por më kot; mbledh dhe grumbullon të mira, por nuk e di se ç'do të bëjë me to.

<sup>8</sup>O Zot, a më ka mbetur ndonjë shpresë? Unë i var të gjitha shpresat tek ti! <sup>9</sup>Më çliro nga mëkatet e mia dhe mos më përbuz para njerëzve që përçmojnë urdhërimet e tua. <sup>10</sup>Tani do të pushoj, nuk do të them më asgjë; gjithçka që më ka ndodhur, më ka ardhur prej teje. <sup>11</sup>Le të mjaftojë kjo; shumë më mundove; nuk mund t'i duroj më goditjet e tua! <sup>12</sup>Ti e dënon njeriun për fajin e tij; gjënë më të vlefshme që ai ka, jetën e tij, ti e shkatërron si mola që ha rrobën. Për ty çdo njeri është vetëm një hije dhe asgjë tjetër.

<sup>13</sup>Dëgjoje lutjen time, o Zot, merre parasysh thirrjen time; mos e bëj veshin të shurdhër ndaj ankimeve dhe të qarave të mia! Jam vetëm mysafir tek ti, si të gjithë të parët e mi, një i huaj pa të drejta, që mbështetet në mirësinë tënde. <sup>14</sup>Largoje prej meje shikimin dënues, që të marr frymë përsëri, para se të më marrë vdekja.

### **Falënderimi dhe premtimi solemn**

**40** *Këngë e Davidit.*

<sup>2</sup>Me besim të plotë i kam varur shpresat te Zoti dhe ndihmën e tij e kam pritur. Thirrjen time ai e dëgjoi dhe më ndihmoi. <sup>3</sup>Më nxori nga pusi i errët i vdekjes, më tërhoqi nga moçali që po më përpinte, në një vend të sigurt e të fortë më vendosi, hapat m'i drejtoi drejt një vendi pa rreziqe. <sup>4</sup>Më mësoi se si ta këndoja këngën e re, me të cilën mund ta lavdëroj Perëndinë tonë. Këtë le ta shohin shumë njerëz; atëherë do ta nderojnë përsëri Zotin me jetën e tyre dhe do të besojnë në të. <sup>5</sup>Lum ai njeri që i beson plotësisht Zotit dhe nuk lidhet me asnjë fuqi tjetër që e çon vetëm në rrugë të gabuar.

<sup>6</sup>O Zot, Perëndia ime! Ti ke bërë për ne kaq shumë; askush nuk është si ti! Sa plane dhe vepra të mrekullueshme ke bërë për ne! – po të doja t'i numëroja të gjitha, kurrë nuk do të mbaroja. <sup>7</sup>Për ty flijimet dhe dhuratat nuk janë kryesore, ti nuk kërkon prej meje flijime përkushtimi. Por ti më hape veshët për të të dëgjuar! <sup>8-9</sup>Prandaj them: O Zot, jam i gatshëm të bëj atë që kërkon ti prej meje, ashtu siç është shkruar për mua në librin e Ligjit. Gëzohem për Ligjin tënd dhe e mbaj atë thellë në zemrën time. <sup>10</sup>Para mbarë kishës do të tregoj se si ti i mban premtimet. Nuk do të pushoj së foluri për këtë; ti e di, o Zot. <sup>11</sup>Atë që ke bërë për mua, nuk e mbaj për vete, por dëshmoj para të gjithëve se ti je besnik dhe më ndihmon. Nuk do t'ia fsheh kishës se sa i mirë dhe i besueshëm je. <sup>12</sup>O Zot, ti nuk do të ma largosh mëshirën tënde. Mirësia dhe besnikëria jote do të më ruajnë gjithnjë.

<sup>13</sup>Fatkeqësitë bien mbi mua nga të gjitha anët, nuk mund t'i numëroj sa herë më kanë goditur. Po vuaj pasojat e mëkateve të mia, nuk duroj më t'i shoh. Janë bërë më shumë se qimet e kokës. Prandaj më pushton frika. <sup>14</sup>Ki mëshirë, o Zot, më shpëto, eja shpejt më ndihmo! <sup>15</sup>Turp dhe faqe e zezë për të gjithë ata që kërkojnë të më vrasin! Le të zbrapsen e të shkatërrohen të gjithë ata që gëzohen për fatkeqësinë time! <sup>16</sup>Le të tmerrohen për turpin e tyre, ata që thërrasin me ligësi: «Ja, a e shihni?» <sup>17</sup>Por të gjithë ata që kërkojnë praninë tënde, le të gëzohen e të ngazëllohen! Të gjithë ata që kërkojnë ndihmën tënde, le të thërrasin gjithnjë e më shumë: 'Zoti është i madh!'

<sup>18</sup>Unë jam i varfër dhe i pambrojtur; o Zot, mos më harro! Prej teje pres ndihmë që të më çlirosh, o Perëndia ime, mos u vono!

## LIBRI I DYTË

### Lutja e një të sëmuri

#### 41 *Këngë e Davidit*

<sup>2</sup>Sa i lumtur është ai që kujdeset për të dobëtit. Kur është në rrezik, Zoti e nxjerr <sup>3</sup>dhe e mban gjallë; të gjithë në tokë do ta quajnë të lumtur. Zoti nuk e lë në mëshirën e armiqve të tij. <sup>4</sup>Kur sëmundja e vë poshtë, Zoti e ndihmon dhe e ngre përsëri.

<sup>5</sup>Meqë e di këtë, them: para teje, o Zot, jam fajtor! Por ki mëshirë për mua dhe më shëro. <sup>6</sup>Armiqtë e mi janë mizorë. Ata pyesin: «Kur do të vdesë ai më në fund, që ta harrojmë sa më shpejt?» <sup>7</sup>Edhe në qoftë se njëri prej tyre më bën vizitë, e bën këtë me prapamendim; kërkon të mësojë për se jam fajtor; sapo del jashtë, shpif për mua. <sup>8</sup>Janë mbledhur të gjithë ata që më urrejnë, këshillohen; pëshpëritin njëzëri për mua, dhe flasin për fundin tim. <sup>9</sup>«Atë nuk do ta lëshojë bota e të vdekurve; shtratin e tij do ta lërë vetëm si i vdekur!» <sup>10</sup>Edhe shoku im më i mirë, të cilit i besoja si askujt tjetër, ai që hante bukë bashkë me mua, tani është kthyer kundër meje! <sup>11</sup>Por ti, ki mëshirë për mua, o Zot, më ngri përsëri në këmbë që t'u kërkoj llogari!

<sup>12</sup>Kur të pushojë thirrja e fitores së armiqve të mi, atëherë do ta di se ti më do të mirën. <sup>13</sup>Meqë jam i pafajshëm, ti merr anën time dhe më lejon të jetoj përgjithmonë në praninë tënde.

<sup>14</sup>Lavdi i qoftë Zotit, Perëndisë së Izraelit, në jetë të jetëve! Amen, ashtu qoftë!

### Lutja e njeriut në mërgim

#### 42 *Poemë e korahasve.*

<sup>2</sup>Ashtu si dreri që ka etje për ujë të freskët, ashtu edhe mua më merr malli për ty, o Perëndia e gjallë! <sup>3</sup>Jam i etur për Perëndinë, për Perëndinë e vërtetë dhe të gjallë. Kur do të mund të shkoj tek ai, kur do të mund ta shoh? <sup>4</sup>Lotët janë ushqimi im, ditë e natë, sepse më pyesin vazhdimisht: «Ku është futur ai, Perëndia jote?» <sup>5</sup>Kur mendoj për kohët e mëparshme, zemra më lëndohet. Atëherë shkoja bashkë me turmën e madhe drejt Tempullit, atëherë mund të gëzohesha e të të falënderoja midis turmës festuese. <sup>6</sup>Përse jam kaq i hutuar? A duhet ta humbas shpresën? Në Perëndinë do të shpresoj! E di se do ta lavdëroj përsëri, atë, Perëndinë tim, që më ndihmon.

<sup>7</sup>Jam i tronditur! Prandaj mendimet e mia i drejtohen atij – nga larg, nga toka pranë burimeve të Jordanit, nga mali i Hermonit me majat e tij. <sup>8</sup>Rreth meje shungullon e gjëmon; valët e dërguara prej tij përplasen vullshëm mbi mua dallgë pas dallgë. <sup>9</sup>Ditën ai do të më tregojë mirësinë e tij dhe natën unë do t'i këndoj me falënderim; do t'i lutem Perëndisë, i cili më jep jetën. <sup>10</sup>I them mbrojtësit tim; përse më ke harruar? Përse duhet të vuaj vazhdimisht, përse i lejon armiqtë e mi të më mendojnë? <sup>11</sup>Për mua përbuzja e tyre është si plagë vdekjeprurëse, sepse më pyesin çdo ditë: «Ku është futur ai, Perëndia jote?»

<sup>12</sup>Përse jam kaq i hutuar? A duhet ta humbas shpresën? Në Perëndinë do të shpresoj! E di se do ta lavdëroj përsëri, atë, Perëndinë tim, që më ndihmon.

### Lutja e njeriut në mërgim (vazhdim)

<sup>2</sup>Më jep të drejtë, o Perëndi, mbroje çështjen time kundër një populli të pabesë! Më çliro nga gënjeshtarët dhe keqbërësit! <sup>3</sup>Ti, o Perëndi, ke qënë gjithnjë mbrojtja ime! Përse tani më ke harruar? Përse duhet të vuaj vazhdimisht, përse i lejon armiqtë e mi të më mendojnë? <sup>4</sup>Lërmë të shoh dritën tënde dhe besnikërinë tënde! Le të më drejtojnë ato e të më çojnë te Mali yt i shenjtë, te vendi ku banon ti. <sup>5</sup>Atje do t'i afrohem altarit tënd, para teje, o burimi i gëzimeve të mia. Me tingujt e harpës do të të lavdëroj, o Perëndia ime!

<sup>6</sup>Përse jam kaq i hutuar? A duhet të mbetem pa shpresë? Në Perëndinë do të shpresoj! E di se do ta lavdëroj përsëri, atë, Perëndinë tim, që më ndihmon.

### Lutja për mbrojtje

#### 44 *Poemë e korahasve.*

<sup>2</sup>O Perëndi, me veshët tanë e dëgjuam, etërit dhe stërgjyshërit na e treguan atë që bëre ti në kohën e tyre – atëherë, shumë kohë më parë. <sup>3</sup>Ti dëbove nga toka (e premtuar) popujt e huaj, që të banonin të parët tanë atje. Të huajt i godite rëndë, që të parët tanë të jetonin në liri. <sup>4</sup>Ata e pushtuan, vërtet, tokën (e premtuar) dhe korrën fitore mbi popujt, por jo me shpatat e tyre dhe as me forcat e tyre, por me dorën tënde, me forcën tënde dhe me praninë tënde, sepse ti (i zgjodhe dhe) i doje.

<sup>5</sup>Ti, o Zot, je mbreti ynë. Ti u jep fitore pasardhësve të Izraelit. <sup>6</sup>Me ndihmën tënde i mposhtim kundërshtarët, me fuqinë tënde armiqtë tanë i shkelim me këmbë. <sup>7</sup>Nuk mbështetemi në harqet tona, nuk presim që të na shpëtojë shpata jonë. <sup>8</sup>Vetëm ti na çliron nga armiqtë tanë dhe i turpëron ata që na urrejnë. <sup>9</sup>Çdo ditë do të të lavdërojmë e do të të falënderojmë pa mbarim, o Perëndia jonë!

<sup>10</sup>Tani na braktise e nuk na e kurseve turpin e disfatës; ti nuk shkon më në luftë bashkë me ushtritë tona. <sup>11</sup>Ti lejon që të ikim prej armiqve tanë; ata mund të na plaçkitin pa asnjë vështirësi. <sup>12</sup>Si bagëtinë e caktuar për therje, ti na dorëzon tek ata dhe na shpërndan ndër popujt të huaj. <sup>13</sup>Ti e shet popullin tënd me çmim

qesharak, pa nxjerrë prej tij as fitimin më të vogël! <sup>14</sup>Ti i lejon armiqtë tanë të tallen me ne; ata kanë leje të na përqeshin e të na shajnë. <sup>15</sup>Ti na bën qesharakë para popujve; të gjithë tundin kokën dhe tallen me ne. <sup>16</sup>Çdo ditë ndihemi të turpëruar dhe fytyra na skuqet nga turpi, <sup>17</sup>kur dëgjojmë përqeshjet e armiqve dhe fyerjet e poshtërimet e atyre që kërkojnë hakmarrje. <sup>18</sup>Të gjitha këto ranë mbi kokat tona, megjithatë, ne nuk të harruam ty, dhe nuk e prishëm besëlidhjen me ty! <sup>19</sup>Ne nuk të kthym shpinën dhe nuk u larguam aspak nga rruga jote. <sup>20</sup>Por ti na përplase përtokë; ne duhet të banojmë në gërmadha si çakej; ti neve nuk na jep as edhe shpresën më të vogël. <sup>21</sup>Po ta kishim harruar Perëndinë tonë, po t'u faleshim perëndive të tjera, <sup>22</sup>ti menjëherë do ta merrje vesh, ti që i njeh thellësitë e zemrës sonë! <sup>23</sup>Meqë të takojmë ty, përditë jemi të rrezikuar nga vdekja. Na quajnë si delet që janë për t'u therur. <sup>24</sup>Zgjohu, o Zot! Përse fle? Zgjohu, mos na braktis përgjithmonë! <sup>25</sup>Përse nuk pranon të na shikosh? Përse nuk do t'ia dish për mundimet e për vuajtjet tona? <sup>26</sup>Jemi të poshtëruar, të rrëzuar përdhe, me fytyrë në pluhur e pa ndihmë. <sup>27</sup>Ndërhyr dhe na ndihmo, na liro! Mbështetemi në besën tënde!

### Kënga për dasmën e mbretit

**45** *Poemë e korahasve, që këndohet sipas melodisë 'Zambakët', këngë dashurie.*

<sup>1</sup>Fjalë të ëmbla burojnë nga zemra ime, një këngë për mbretin Perëndia më frymëzon. Gjuha ime fjalët do t'i gdhendë, si dora e artistit që gdhend një gravurë.

<sup>2</sup>Ti je më madhështori nga të gjithë burrat, nga buzët e tua rrjedhin fjalë plot mirëdashje; duket qartë që Perëndia të ka dhënë bekimin. <sup>3</sup>Ngjeshe shpatën në brez, o kreshnik, me madhësi mbulohu dhe me shkëlqim! <sup>4</sup>I mbuluar me madhësinë e fitores hip në karrocë dhe lufto për të vërtetën, për të mbrojtur të dobët, që të fitojnë të drejtën e tyre! Kryej vepra që u kallin njerëzve frikë! <sup>5</sup>Shigjetat e mprehta lëshoji mbi ta, në zemrat e armiqve të tu të ngulen dhe popujt të bien nën këmbët e tua! <sup>6</sup>Froni yt, o Perëndi, qëndron i patundur përgjithmonë. Ti e sundon perandorinë tënde me drejtësi. <sup>7</sup>Ti e do të drejtën, kurse të keqen e urren; prandaj Perëndia të emëroi sundimtar, Perëndia jote të dha nder dhe gëzim më shumë se të gjithë mbretërve të tjerë. <sup>8</sup>Të gjitha rrobat e tua mbajnë erë mirre, kanelle dhe aloe. Nga pallatet e tua të stolisura me fildish për ty kumbon muzika. <sup>9</sup>Bijat e mbretërve rrinë në oborrin tënd; në të djathtën tënde qëndron mbretëresha e veshur me stoli ari të kulluar.

<sup>10</sup>Ti, o bijë mbreti, më shiko mua e dëgjoje me vëmendje atë që kam për të të thënë: «Harroje popullin tënd dhe familjen e atit tënd! <sup>11</sup>Mbreti të do për shkak të bukurisë sate. Ai është zoti yt, përkulu para tij!»

<sup>12</sup>Njerëzit e Tirit të sjellin dhuratat e tyre; popujt më të pasur kërkojnë favorin tënd.

<sup>13</sup>Sa madhështore duket bija e mbretit! Me rrobën e punuar në filigran, ajo hyn në pallat. <sup>14</sup>Nëpër qilima shumëgjyrësh ajo shoqërohet te mbreti, e përcjellë nga vasha të reja, që hyjnë bashkë me të. <sup>15</sup>Me gëzim dhe me hare hyjnë në sallën e madhe.

<sup>16</sup>O mbreti im, bijtë e tu do të mbretërojnë në fronin e etërve të tu; ti do t'i emërosh ata princa në mbarë botën. <sup>17</sup>Kënga ime e mbajtë të gjallë kujtimin tënd, që popujt të të lavdërojnë përgjithmonë.

### Zoti është bashkë me ne

**46** *Këngë e korahasve, për zëra të hollë.*

<sup>1</sup>Perëndia është strehimi ynë i sigurt, ndihmësi i sprovuar në çdo rrezik. <sup>2</sup>Prandaj nuk kemi aspak frikë, edhe në qoftë se tundet toka dhe malet fundosen në det, <sup>3</sup>edhe nëse ujërat tërbohen e uturijnë dhe malet fillojnë të dridhen. Zoti i mbarë botës është me ne, Perëndia e Jakovit është mbrojtja jonë!

<sup>4</sup>Ujë i freskët rrjedh përmes qytetit të Perëndisë, atje ku është banesa e shenjtë e më të Lartit. <sup>5</sup>Vetë Perëndia është brenda mureve të tij, asgjë nuk mund ta tundë. Ai do të sjellë ndihmë para se të zbardhë drita. <sup>6</sup>Ai bën të dëgjohet zëri i tij – e popujt dridhen. Fronet e mbretërve lëkundën, mbarë bota tmerrohet nga frika. <sup>7</sup>Zoti i mbarë botës është bashkë me ne, Perëndia e Jakovit është mbrojtësi ynë!

<sup>8</sup>Ejani e shihni sa i madh është Zoti, sa frikë dhe tmerr përhap gjithkund në botë! <sup>9</sup>Në mbarë botën i jep fund luftës; këput harqet, thyen heshtat, djeg mburojat. <sup>10</sup>«Ndaloni luftën! – thërret. – Pranoni që unë jam Perëndia! Unë kam pushtet të plotë mbi popujt e botës.» <sup>11</sup>Zoti i mbarë botës është bashkë me ne, Perëndia e Jakovit është mbrojtësi ynë!

### Sundimtari suprem

**47** *Këngë e korahasve.*

<sup>1</sup>O popujt të gjithë, brohoritni, përshëndeteni Perëndinë tonë me thirrje gëzimi! <sup>2</sup>Zoti është më i Larti, para tij tmerrohen të gjithë. Ai, Mbreti i madh, sundon mbarë botën. <sup>3</sup>Popujt e tjerë i vuri nën këmbët tona, kombet i shtiu në dorën tonë.

<sup>4</sup>Ai vetë na e zgjodhi tokën (e premtuar), me dashurinë e tij krenarinë na dha, neve, pasardhësve të Jakovit, që na do. <sup>5</sup>Me brohoritje u ngjit Perëndia në fronin e tij dhe nën tingujt e brirëve atje zuri vend.

<sup>6</sup>Këndoni e luani për nder të Perëndisë! Këndoni e luani për nder të mbretit! <sup>7</sup>Meqë Perëndia është mbreti i mbarë botës, lavdërojeni atë me këngën më të bukur! <sup>8</sup>Perëndia mbretëron mbi të gjitha kombet; ai qëndron në fronin e tij të shenjtë. <sup>9</sup>Prijësit e kombeve afrohen, bashkohen me popullin që i takon Perëndisë së Avrahamit. Zotit i nënshtrohen të fuqishmit e tokës, sepse ai qëndron lart, përmbi të gjithë.

## Qyteti i mbretit të madh

### 48 *Këngë e korahasve.*

<sup>2</sup>Zoti është i fuqishëm! Lavdërojeni në qytetin e tij, lavdërojeni në malin e tij të shenjtë!

<sup>3</sup>Madhështor ngrihet Cioni, gëzim për mbarë botën! Ai është Mali i vërtetë i Perëndisë; atje qëndron qyteti i Mbretit të madh. <sup>4</sup>Zoti është mbrojtja e tij, më i fortë se muret dhe kullat e tij.

<sup>5</sup>Mbretërit mblidhen dhe e sulmojnë qytetin së bashku. <sup>6</sup>Por kur e panë atë, zemra u ngriu nga tmerri, morën arratinë të hutuar nga frika. <sup>7</sup>Një tronditje e thellë zuri vend në ta, si ankthi i gruas në çastin e lindjes, <sup>8</sup>ose si era e fortë që fryn nga lindja, me të cilën Perëndia thyen anijet më të mëdha.

<sup>9</sup>Këtë prej kohësh na e kanë treguar, por tani e pamë vetë në qytetin që i takon Perëndisë, Zotit të mbarë botës. Ai e themeloi atë të sigurt përgjithmonë.

<sup>10</sup>Brenda në Tempullin tënd, o Perëndi, e festojmë rishtas mirësinë tënde. <sup>11</sup>Në mbarë botën të lavdërojnë, fama jote arrin në të gjitha qoshet e skutat më të largëta. Ti mban paqen në dorën tënde; <sup>12</sup>prandaj mbretëron paqja në Cion! Ti fitove të drejtën tonë; prandaj gëzohen të gjitha qytetet në Judë.

<sup>13</sup>Shkoni rreth Cionit, rreth qytetit; numërojini kullat e tij të fuqishme. <sup>14</sup>Admirojeni ledhin e tij të gjerë, vështrojeni kështjellën e tij të fortë! Atëherë mund t'ju thoni fëmijëve tuaj: <sup>15</sup>«Shikoni sa i fuqishëm është Perëndia! Ai është Perëndia jonë i përvetshëm: do të na udhëheqë përgjithmonë.»

## Jeta nuk mund të shitet

### 49 *Këngë e korahasve.*

<sup>2</sup>Më dëgjoni, ju o popuj, hapini sytë, ju o banorët e tokës! <sup>3</sup>Pari dhe vegjëli, të pasur dhe të varfër, njërin pas tjetrit, të gjithëve ju thërras! <sup>4</sup>Nga goja ime do të dalë veç dituri, nga zemra ime do të rrjedhë vetëm urtësi.

<sup>5</sup>Dëgjoj me kujdes fjalët e frymëzuara nga Perëndia që t'i shpall duke i rënë harpës: <sup>6</sup>Përse të më pushtojë ankthi në ditët e fatkeqësisë, kur të jem i rrethuar nga të këqijet e atyre që u qepen këmbëve të mia? <sup>7</sup>Ata besojnë në paratë e shumta të tyre, dhe mburren për pasurinë e tyre të madhe. <sup>8</sup>Por askush s'ka mundësi t'ia shlyejë Zotit me para jetën e dikujt tjetër; askush nuk mund ta paguajë çmimin e jetës së vet. <sup>9</sup>Çmimi i jetës njerëzore është tepër i lartë; ajo që paguhet, është gjithnjë tepër e vogël. <sup>10</sup>Njeriu nuk mund të mbetet gjallë për një kohë të pacaktuar, vdekja është e pashmangshme.

<sup>11</sup>Mund të thuhet: edhe më të mençurit duhet të vdesin, njësoj si budallenjtë e pandreqshëm dhe të mirat e veta ata ua lënë të tjerëve. <sup>12</sup>Varrri i ngushtë mbetet banesa e tyre e përhershme, edhe në qoftë se kanë zotëruar toka të tëra. <sup>13</sup>Askush nuk mbetet gjallë me anë të madhështisë e të pasurisë; ashtu si kafshët, edhe njeriu një ditë mbaron. <sup>14</sup>Ja, shikoje ç'i pret këta njerëz, që duken tani plot siguri e guxim, që kaq besim kanë në vetvete dhe të bindur janë në fjalët e tyre. <sup>15</sup>Si dhen, ata vrapojnë trokthi drejt botës së të vdekurve; vdekja vetë është bariu që i kullot. Të larguar nga banesat e tyre madhështore, drejt e në varr ata përfundojnë dhe kalbja atje trupin ua bren. <sup>16</sup>Por jetën time – vetë Perëndia e liron me pagimin e çmimit; nga kthetrat e vdekjes ai më rrëmben!

<sup>17</sup>Mos u shqetëso, kur një njeri pasurohet dhe rritet mirëqenia e shtëpisë së tij! <sup>18</sup>Sepse kur të vdesë, asgjë nuk merr me vete; pasuria nuk e ndjek deri në varr. <sup>19</sup>Tërë jetën e tij lavdërohej e të tjerët i bënin lajka, sepse punët i shkonin mbarë. <sup>20</sup>E, megjithatë, duhet të shkojë atje ku janë të parët, të cilët nuk do ta shohin më dritën kurrë.

<sup>21</sup>Njeriu mund të fitojë madhështi dhe pasuri; por nëse nuk ka mendje e gjykim, si kafshët, shpejt, fundi do t'i vijë.

## Çfarë kërkon Perëndia nga populli i tij

### 50 *Këngë e Asafit.*

Perëndia, Zoti, i Madhi dhe i Pushtetshmi, po flet: fama e tij kumbon nëpër mbarë botën deri në skajet më të largëta. <sup>2</sup>Në Cion, në malin më të bukur prej të gjitha maleve, Perëndia shfaqet me shkëlqim madhështor. <sup>3</sup>Perëndia jonë po vjen, nuk hesht më. Një zjarr shkatërrues e prin atë, rreth tij gjëmon dhe tërbohet moti. <sup>4</sup>Qiellin e tokën i thërret për dëshmitarë, sepse popullit të tij do t'i kërkojë llogari. <sup>5</sup>«Mblidhni besnikët e mi, – thotë ai, – ata që besën lidhën me mua dhe u zotuan të më dëgjonin; besëlidhjen e vulosën me flijim.» <sup>6</sup>Për këtë mund të dëshmojë qielli; Perëndia e mbajti premtimin; ai ka të drejtë t'ju kërkojë llogari.

<sup>7</sup>«Dëgjo, o populli im, tani po flas! Izrael, po të padit, unë vetë, Perëndia jote! <sup>8</sup>Ti më kushton shumë flijime, për këtë nuk kam asnjë kundërshtim. Flijime përkushtimi më bën në çdo kohë; <sup>9</sup>por nuk i pranoj flijimet e tua – nuk kam nevojë për demin nga stalla jote, as për cjapin nga vatha jote! <sup>10</sup>Të gjitha kafshët e pyllit më takojnë mua. Gjahu i madh në mal është prona ime. <sup>11</sup>Edhe zogitë atje më takojnë mua, si dhe të gjitha kafshët e vogla në fushë. <sup>12</sup>Edhe në qoftë se do të kisha uri, nuk do të kërkoja asgjë prej teje; sepse mua më takon mbarë toka e gjithçka që banon në të. <sup>13</sup>A mendon me të vërtetë se unë ha mish kau ose pi gjak cjapi? <sup>14</sup>Jo ushqim, por mirënjohje kërkoj prej teje. Mbajti premtimet, që më dhe në kohën e vështirësisë, mua, më të Lartit, Perëndisë sate! <sup>15</sup>Kur je në rrezik, më thirr për ndihmë! Unë do të të



ndihmoj, e ti do të më lavdërosh.»

<sup>16</sup>Të pabindurit Perëndia i thotë: «Ti vazhdimisht i referohesh besëlidhjes sime, dhe gjithnjë numëron urdhërimet e mia. Ç'dobi ka kjo, në të vërtetë? <sup>17</sup>Ti nuk i dëgjon fjalët e mia; asnjë paralajmërim ti nuk përfill! <sup>18</sup>Ti u bën shoqëri vjedhësve dhe hajdutëve dhe miqësi lidh me tradhtarë bashkëshortorë. <sup>19</sup>Nga goja jote dalin vetëm mallkime, gjuha jote thur rrjetë gënjeshtresh. <sup>20</sup>Flet keq për të afërmit, edhe shpif për vëllanë tënd. <sup>21</sup>E unë duhet të hesht për gjithë këtë padrejtësi? Mos mendon ti se unë jam ndonjë nga shokët e tu? Ty të kërkoj llogari, dhe po të nxjerr para syve çdo vepër të turpshme!

<sup>22</sup>Ju të gjithë që më harruat, merreni seriozisht këtë që po ju them! Përndryshe, do t'ju dërrmoj e askush nuk do t'ju shpëtojë. <sup>23</sup>Mirënjohja që më shpreh dikush, është flijimi që më nderon; e kush më dëgjon, atë e ndihmoj.»

### Lutja për faljen e mëkatit

**51** *Këngë e Davidit. <sup>2</sup>E hartoi kur feti Natan e vuri para përgjegjësisë për shkak të tradhtisë bashkëshortore me Batshevën.*

<sup>3</sup>O Perëndi, ti je plot me dashuri dhe me mirësi; ki mëshirë për mua, ma fal mëkatin tim! <sup>4</sup>Hiqma tërë fajin tim; më pastro nga mëkati im! <sup>5</sup>E di se bëra keq, mëkatet e mia janë para syve të mi. <sup>6</sup>Kundër teje mëkatova; bëra atë që urren ti. Prandaj kishe të drejtë kur më dhe vendimin e fajësisë. Do të dalë fjala jote e saktë. <sup>7</sup>Jetën time e përcaktojnë faji dhe mëkati, që nga koha kur më lindi nëna. <sup>8</sup>Kjo më ishte e fshehur; ti ma zbulove. Ty të pëlqen, kur njeriu pranon të vërtetën.

<sup>9</sup>Hiqma fajin tim, atëherë do të jem i pastër! Më laj, atëherë do të jem më i bardhë se bora! <sup>10</sup>Më lejo të gëzohem përsëri e të ngazëllohem bashkë me bashkësinë tënde. Ti më dërrmove; më ngri përsëri më këmbë! <sup>11</sup>Mos i shiko mëkatet e mia, laje tërë fajin tim! <sup>12</sup>Më bëj njeri të ri, o Zot, që të të qëndroj besnik. <sup>13</sup>Mos më dëbo nga prania jote, mos ma merr shpirtin tënd të shenjtë. ♦ <sup>14</sup>Më gëzo përsëri me ndihmën tënde, e më jep zemrën e bindur! <sup>15</sup>Të gjithë atyre që nuk të dëgjojnë, do t'u kujtoj urdhërimet e tua, që të kthehen tek ti e të bëjnë atë që të pëlqen ty.

<sup>16</sup>O Perëndi, ti je Shpëtimtari im! Kam merituar vdekjen, por ti më kurseve! Atëherë do ta lavdëroj besën tënde. <sup>17</sup>O Zot, ma fal fajin që më mbyll gojën! Atëherë mund ta lavdëroj mirësinë tënde para të gjithëve.

<sup>18</sup>Ti nuk do që unë të të bëj fljime kafshësh; ♦♦ fljimet e përkushtimit nuk të pëlqejnë. <sup>19</sup>Kur njeriu heq dorë nga mendjemadhësia e tij, kur nuk të kundërshton më, o Perëndi, këtë fljim nuk e refuzon.

<sup>20</sup>Tregoji Cionit dashurinë tënde; rindërtoj muret e Jerusalemit! <sup>21</sup>Atëherë do të gëzohesh për fljimet që na caktove, për fljimet e përkushtimit që do t'i bëjmë! Atëherë në altar tënd do të digjen përsëri dema!

♦ aludim për dhuntinë shpirtërore si mbret ♦♦ d.m.th. pa pendim.

### Tirani i pasur dhe mbarimi i tij

**52** *Poemë e Davidit <sup>2</sup>e shkruar në kohën kur edomasi Doeg shkoi te Shauli dhe i tha se Davidi kishte qenë tek Ahimelehu.*

<sup>3</sup>Përse mburrësh për ligësinë tënde, o tiran? Dashuria e Perëndisë më rrethon gjithë ditën!

<sup>4</sup>Vazhdimisht hartove kundër meje plane të kobshme; gjuha jote është e mprehtë si thikë, o mashtrues! <sup>5</sup>E keqja të pëlqen më shumë se e mira, gënjeshtër më fortë se e vërteta. <sup>6</sup>Me fjalët e tua ke dëshirë të shkatërrosh çdo gjë, tinzare është gjithçka që thua. <sup>7</sup>Prandaj Perëndia do të të shkatërrojë përgjithmonë; do të të rrëmbejë e do të të heqë nga shtëpia jote; do të të largojë nga bota e të gjallëve, ashtu siç shkulet nga toka bari i keq. <sup>8</sup>Njerëzit që i qëndrojnë besnikë Perëndisë, këtë do ta shohin e do të tmerrohen.

<sup>9</sup>«Shikojeni këtë njeri! Ai nuk kërkoj të strehohej te Perëndia, por mendonte se ishte i sigurt me të hollat që kishte fituar duke bërë krime.» <sup>10</sup>Por unë jam si ulliri që gjelbëron, që rritet pranë Tempullit të Perëndisë;

mbështetem përgjithmonë në mirësinë e tij. <sup>11</sup>O Perëndi, gjithnjë do të të falënderoj për atë që ke bërë. Do të të lavdëroj para gjithë besnikëve të tu, sepse ti tregohesh kaq i mirë ndaj meje.

### Nuk ka Perëndi?

**53** *Poemë e Davidit, kënduar në mënyrë melankolike.*

<sup>1</sup>Janë të pafytyrë e pa logjikë ata që pohojnë: «Nuk ka Perëndi, të cilit duhet t'i jepet llogari!» Ata janë plotësisht të prishur, veprat e tyre janë nga më të këqijat, asnjëri prej tyre nuk sillet me drejtësi. <sup>3</sup>Që lart nga qielli Perëndia vështron njerëzit, për të parë nëse ka njeri të logjikshëm që e kërkon. <sup>4</sup>Por të gjithë u larguan nga Ai, njëri pas tjetrit morën rrugë të keqe, asnjëri prej tyre nuk vepron drejt, askush! <sup>5</sup>«Ata janë të verbër – thotë Perëndia. – Ku është logjika e këtyre keqbërësve? Ata e hanë popullin tim sikur të ishte bukë dhe askush prej tyre nuk më nderon me jetën e tij.» <sup>6</sup>Papritur ata do të tremben, edhe në qoftë se tani nuk duken ashtu, sepse Perëndia do t'i shpërndajë kockat e atyre që rrethojnë qytetin e popullit të tij. Ata do të mbulohen me turp sepse Ai do t'i shpartallojë. <sup>7</sup>Sa me padurim presim që të vijë Shpëtimtari i Izraelit prej malit të Cionit! Perëndia do ta ndryshojë fatin e popullit të tij. Atëherë pasardhësit e Jakovit do të gëzohen, atëherë mbarë Izraeli do të ngazëllohet.

### Thirrja për ndihmë e një të përndjekuri

**54** *Poemë e Davidit, shoqëruar me vegla me tela.* <sup>2</sup>E shkroi kur burrat nga Zifi shkuan te Shauli dhe i thanë se Davidi ishte fshehur në krahinë e tyre.

<sup>3</sup>O Perëndi, shfaqu, më shpëto! Më jep të drejtë; ti ke pushtet! <sup>4</sup>Po të lutem, o Perëndi, më dëgjo! Mos i mbyll veshët ndaj lutjes sime! <sup>5</sup>Njerëzit që nuk i njoh fare, njerëz mizorë që nuk duan t'ia dinë për ty, më sulmojnë, kërkojnë të më vrasin. <sup>6</sup>Por ti, o Perëndi, do të më ndihmosh; ti je Zoti im, ti përgjigjesh për mua. <sup>7</sup>E keqja që më bëjnë armiqtë, u ktheftë kundër tyre! Bëj që ata të heshtin përgjithmonë – unë mbështetem në besën tënde! <sup>8</sup>Me gjithë zemër ta sjell flijimin; do të të falënderoj, o Zot, sepse ti je i mirë ndaj meje. <sup>9</sup>Ti më shpëtove nga shtypja, dhe tani po shoh vetëm armiqtë e mundur!

### I tradhtuar nga shoku

**55** *Këngë e Davidit, e shoqëruar me vegla me tela.*

<sup>2</sup>O Perëndi, dëgjoje lutjen time, mos iu largo ankesës sime. <sup>3</sup>Më dëgjo e më jep përgjigje. Hidhërimi po më rrëzon përdhe; nuk gjej më qetësi, <sup>4</sup>sepse armiqtë më kërcënojnë, keqbërësit më shtypin. Ata më çojnë në fatkeqësi e më ndjekin me urrejtje të tërbuar. <sup>5</sup>Nga frika më ngrin zemra; tmerri i vdekjes më pushton. <sup>6</sup>Më mbërthen frika e tmerri dhe paniku më mbulon. <sup>7</sup>Sa do të doja t'i kisha krahët si pëllumbi! Atëherë mund të ikja e të kërkoja një strehim; <sup>8</sup>mund të fluturoja larg në shkretëtirë për të gjetur atje pak qetësi. <sup>9</sup>Do të shpejtoja për në strehim, ku do të isha i sigurt nga stuhia që po tërbohet. <sup>10</sup>Ngatërroje gjuhën e tyre, o Zot! Gjithçka që pashë në këtë qytet, është vetëm grindje dhe dhunë e hapur, <sup>11</sup>që qarkullojnë ditë e natë mbi mure, kurse brenda në qytet ka fatkeqësi e mjerim. <sup>12</sup>Nëpër qytet përhapet krimi, tregu i tij është vendi ku ka mashtrim dhe shtypje. <sup>13</sup>Po të ishte armiku im, i cili tani shpif ndaj meje, mund ta duroja! Ai që më sulmon tani po të më urrente prej kohësh, do të ndërroja rrugë për të mos e takuar. <sup>14</sup>Por ti je njeri i rrethit tim, shoku im më i ngushtë, më i besuari! <sup>15</sup>Së bashku diskutonim bukur; me një zemër shkonim në shtëpinë e Perëndisë! <sup>16</sup>Armiqtë e mi le t'i rrëmbejë vdekja, le të vijë papritur për t'i marrë. Të zbresin të gjallë në botën e të vdekurve, sepse e keqja u ka pushtuar zemrat! <sup>17</sup>Por unë e thërras Perëndinë për ndihmë dhe ai, Zoti, do të më ndihmojë. <sup>18</sup>Në mbrëmje, në mëngjes e në mesditë unë qaj dhe rënkoj para tij, dhe ai më dëgjon. <sup>19</sup>Më shpëtoi dhe më mbajti gjallë, kur armiqtë e mi më sulmonin, kur të shumtët më kundërshtonin. <sup>20</sup>O Perëndi, që mbretëron gjithmonë, dëgjoje lutjen time e hakmerru, sepse ata nuk do të ndryshojnë dhe nuk do të pranojnë ta nderojnë Perëndinë siç duhet. <sup>21</sup>Tradhtari drejtohet kundër shokëve të tij; e thyen besëlidhjen solemne. <sup>22</sup>Fjalët e tij janë të ëmbla si mjalti, por ka ndër mend të sulmojë. Fjalët e tij janë të lëmuara si vaji, por çdo fjalë është si thikë e mprehtë. <sup>23</sup>«Hiqe barrën tënde, dorëzoja Zotit; ai vetë do të kujdeset për ty! Kurrë nuk do ta lërë në baltë njeriun që i qëndron besnik.» <sup>24</sup>Ti, o Perëndi, do t'i hedhësh këta njerëz në greminën e shkatërrimit. Kush njolloset me vrasje e me mashtrim, le të vdesë në lulen e jetës! Por unë mbështetem në ty!

### Besimi dhe guximi

**56** *Këngë e Davidit, sipas melodisë 'Pëllumbi i heshtur në dheun e largët'. E hartoi kur ishte arrestuar nga filistenjtë në Gat.*

<sup>2</sup>O Perëndi, ki mëshirë për mua, sepse më ndjekin, më shtypin pa pushim e më trajtojnë shumë keq! <sup>3</sup>Armiqtë e mi vërsulen drejt meje turma-turma; më sulmojnë për të më kapur. <sup>4</sup>Por kur kam frikë, besoj në ty. <sup>5</sup>E lavdëroj Zotin për fjalën e tij që më ndihmon. I besoj atij dhe nuk kam fare frikë. Çfarë mund të më bëjë njeriu? <sup>6</sup>Vazhdimisht i shtrembërojnë fjalët që them; çdo plan që hartojnë e bëjnë për të më dëmtuar. <sup>7</sup>Më zënë pritë kudo, më ndjekin në çdo hap, kërkojnë të më vrasin. <sup>8</sup>O Perëndi! Dënoji ata për të gjitha padrejtësitë! Rrëzoji përdhe me zemërimin tënd! <sup>9</sup>Ti e di se po endem andej-këtej; mbildhi lotët e mi në shtambën tënde; jam i bindur se ti i llogarit të gjitha! <sup>10</sup>Në ditën kur duhet të të thërras për ndihmë, armiqtë e mi duhet të zbrapsen. Unë e di: ti, o Perëndi, je në anën time! <sup>11</sup>E lavdëroj Zotin për fjalën që më ndihmon; po e lavdëroj Zotin për këtë fjalë. <sup>12</sup>I besoj atij dhe nuk kam fare frikë. Çfarë mund të më bëjë njeriu? <sup>13</sup>O Perëndi, jam borxhli ndaj teje për atë që të premtova. Për ta plotësuar, do të të kushtoj flijime mirënjohjeje. <sup>14</sup>Sepse ti më shpëtove nga rreziku i vdekjes, m'i largove këmbët nga udha e greminës. Mund të vazhdoj të jetoj në praninë tënde, sepse ti më lejon të shoh jetën.

### Siguria e re

**57** *Këngë e Davidit, sipas melodisë 'Mos shkatërro'. E hartoi kur iku nga Shauli dhe gjeti strehim në shpellë.*

<sup>2</sup>O Perëndi, më përkrah! Mos vono! Kërkoj strehim tek ti; do të fshihem nën mbrojtjen e flatrave të tua, derisa të kalojë fatkeqësia. <sup>3</sup>Perëndisë, të Lartit, i thërras, atij që merr anën time. <sup>4</sup>Nga qielli do të më dërgojë ndihmë, edhe kur ndjekësi do të tallet me mua! Perëndia më ndihmon, sepse e mban besën dhe është i mirë! <sup>5</sup>Më duket sikur jam i rrethuar nga luanët që lakmojnë mishin njerëzor. Dhëmbët e tyre janë të mprehtë si heshta dhe shigjeta, gjuhët i kanë brisk, si shpata të mprehta. <sup>6</sup>O Perëndi, ndriçoje qiellin me madhësinë tënde dhe mbushe tokën me fuqinë tënde! <sup>7</sup>Më ngritën kurth në rrugën time, në dorë

donin të më shtinin; një gropë hapën për mua, por ranë vetë në të. <sup>8</sup>Zemra ime u qetësua, o Perëndi, e ndiej veten përsëri të sigurt; me këngë do të të lavdëroj. <sup>9</sup>Zgjuhu, o zemra ime! Ngrihu, o harpa dhe lira ime, sepse sot do të zgjoj diellin! <sup>10</sup>Ty, o Zot, të sjell falënderimin tim, për ty do të këndoj para gjithë popujve, <sup>11</sup>sepse mirësia jote arrin deri në qiell dhe besnikëria jote deri në re! <sup>12</sup>O Perëndi, ndriçojë qiellin me madhësinë tënde dhe mbushe tokën me fuqinë tënde!

### Perëndia kujdeset për të drejtën në tokë

**58** *Këngë e Davidit, sipas melodisë 'Mos shkatërro'.*  
<sup>2</sup>Ju të pushtetshmit, a është i drejtë vendimi juaj, kur bëni gjyq me njerëzit? Apo dëshironi që të heshtë drejtësia? <sup>3</sup>Me mend e me vullnet bëni padrejtësi dhe ia hapni derën dhunës. <sup>4</sup>Keqbërësit janë rebelë që nga lindja; sapo lindin, ndjekin rrugën e gabuar, mësohen me gënjeshtër. <sup>5</sup>E kanë helmim si kobra; e bëjnë veshin e shurdhër si gjarpi <sup>6</sup>që nuk do ta dëgjojë muzikën e zbutësve, sepse nuk e njohin mjeshtrinë e tyre. <sup>7</sup>O Perëndi, thyejua dhëmbët në gojë, dërrmojua, o Zot, nofullat prej luani! <sup>8</sup>Le të zhiduken si uji që derdhet, mos lejo që shigjetat e tyre të qëllojnë në shenjë. <sup>9</sup>Le të zhiduken si kërmill që shpërbëhet në lëng, kur përparohet si dështaku që nuk e sheh diellin kurrë! <sup>10</sup>Le t'u ndodhë si ferrave që i shkul shakullina, para se të rriten e të bëhen shkurre, kur ende janë të gjelbra ose në lulëzim! <sup>11</sup>Të gjithë ata që e dëgjojnë Perëndinë, le të gëzohen kur të shohin se si hakmerret Perëndia; ata do të ecin mbi gjakun e keqbërësve. <sup>12</sup>E të gjithë do të pranojnë: «Kush i qëndron besnik Perëndisë, do të shpërblehet. Ka Perëndi që kujdeset për të drejtën në tokë.»

### Lutja për mbrojtje

**59** *Këngë e Davidit, sipas melodisë 'Mos shkatërro'. E hartoi kur Shauli rrethoi shtëpinë e tij për ta vrasë.*  
<sup>2-3</sup>Më shpëto, Perëndia ime, më mbro! Armiqtë e mi më sulmojnë; kërkojnë fatkeqësinë time, janë të etur për gjakun tim, këta vrasës! Më mbro prej tyre, më shpëto! <sup>4</sup>Shiko si kërkojnë të më vrasin, si më presin, armiqtë e fuqishëm! Por nuk kam bërë asnjë të keqe, nuk mund të më paditin për asgjë! <sup>5</sup>Megjithëse nuk kam asnjë faj, afrohen për të më sulmuar. Zgjuhu, eja dhe shiko! <sup>6</sup>O Perëndi, Zoti i tokës, Perëndia e Izraelit, çohu, bëju gjyqin të gjithë të pabesëve! Mos ki mëshirë për këta keqbërës! <sup>7</sup>Çdo mbrëmje ata kthehen dhe sillen tinëz rreth qytetit, si një tufë qensh që angullin. <sup>8</sup>U rrjedh shkuma nga gryka, çdo fjalë e dalë nga buzët e tyre është thikë, por mendojnë se askush nuk i dëgjon. <sup>9</sup>Por ti, o Zot, tallesh me ta, ti i përqesh këta të pabesë. <sup>10</sup>Kam besim tek ti, sepse ti më bën të fortë; ti, o Perëndi, më jep mbrojtje të sigurt. <sup>11</sup>Ti je kaq i mirë ndaj meje, ti më ndihmon dhe më bën të triumfoj mbi armiqtë e mi. <sup>12</sup>Mos i shfaros të gjithë menjëherë: përndryshe, populli im këtë do ta harrojë. Shpërndaji me fuqinë tënde, gjunjëzoji; ti je mbrojtësi im, o Zot! <sup>13</sup>Me çdo fjalë të shajnë ty. Mendjemadhësia e tyre u bë grackë, sepse më përndjekin me sharje e me gënjeshtër. <sup>14</sup>Asgjësoji në zemërimin tënd, shkatërroji, që të mos u mbetet asnjë gjurmë! Deri në skaj të botës, të gjithë ta pranojnë se ti, o Perëndi, mbretëron në Izrael. <sup>15</sup>Çdo mbrëmje, ata kthehen dhe sillen tinëz rreth qytetit si një tufë qensh që angullin. <sup>16</sup>Gjithkund kërkojnë diçka për të ngrënë dhe kur nuk u mjafton, fillojnë të hungërojnë. <sup>17</sup>Por unë i këndoj fuqisë sate, herët në mëngjes lavdëroj mirësinë tënde; sepse ti më ruan si kështjellë, tek ti gjej strehim në kohën e rrezikut. <sup>18</sup>Për ty këndoj këngën time, sepse ti më forcon; ti, o Perëndi, më jep mbrojtje të sigurt, ti je kaq i mirë ndaj meje!

### Lutje në vështirësinë e madhe

**60** *Këngë e Davidit, sipas melodisë 'Zambaku i paralajmërimit'.<sup>2</sup> E hartoi në kohën e luftës kundër aramasve në Mesopotami dhe në Cova, kur Joavi mundi gjatë kthimit ushtrinë edomase, duke vrasë 12.000 njerëz, në Luginën e Kripës.*

<sup>3</sup>O Perëndi, ti na hodhe tej dhe na i theve radhët. Ti u zemërove me ne, por tani na mëkëmb! <sup>4</sup>Ti e tunde dhe e çave tokën; mbylle të çarat, që të mos binim brenda. <sup>5</sup>Ti bërë që populli të kalonte nëpër prova të rënda; na detyrove të pinim verë që të deh. <sup>6</sup>Ti na paralajmërove, që të duam dhe të nderojmë, që t'i shpëtojmë shkatërrimit. <sup>7</sup>Ndërhyr me pushtetin tënd, jepi përgjigje thirrjes sonë, shpëtona – ti na do! <sup>8</sup>Nga shenjtorja e tij, Perëndia jep përgjigje: «Mua më përket fitorja! – thotë ai. – Popullit tim do t'i jap për trashëgim Shehemin, do t'i ndaj luginën e Sukotit. <sup>9</sup>Gileadi më takon mua, edhe Mënasheu, gjithashtu. Efraimi është helmëta ime dhe Juda është skeptri im. <sup>10</sup>Moavi do të më shërbejë si legen, mbi Edom do të hedh këpucën time. Kundër Filistisë lëshoj kushtimin e luftës.» <sup>11</sup>Kush do të më sjellë në qytetin e fortifikuar, kush do të më çojë deri në Edom? <sup>12</sup>Përveç teje, kush mund ta bëjë këtë, o Perëndi? Por ti na hodhe tej dhe nuk i shoqëron më ushtritë tona në luftë! <sup>13</sup>Eja të na ndihmosh në ngushticën ku kemi rënë; nuk ia kemi besën ndihmës së njerëzve! <sup>14</sup>Me Perëndinë në anën tonë do të korrim fitore, sepse ai do t'i dërrmojë armiqtë tanë.

### Nën mbrojtjen e Perëndisë

**61** *Këngë e Davidit, shoqëruar me vegla me tela.*  
<sup>2</sup>O Perëndi, dëgjoje ankesën time; merre parasysht lutjen time! <sup>3</sup>Të thërras nga skaji i tokës, sepse

forcat po më shterojnë.

Më ngri lart në shkëmbin e sigurt; vetë nuk mund ta arrij, është tepër i lartë për mua. <sup>4</sup>Ti je strehimi im, kulla e fortë, kur më kërcënon armiku. <sup>5</sup>Dua të mbetem përgjithmonë në Tempullin tënd dhe të gjej mbrojtje nën flatrat e tua. <sup>6</sup>Ti e dëgjove, o Zot, atë që të premtova, dhe do ta plotësosh lutjen time.

Ti i shpërblen me dhurata të shumta të gjithë ata që të afrohen me respekt të thellë. <sup>7</sup>Jepi mbretit jetë të gjatë; të mbretërojë në shumë breznit! <sup>8</sup>Të jetojë përgjithmonë nën shikimin tënd, që veprimet e tij t'i përcaktojnë mirësia dhe besnikëria! <sup>9</sup>Pa mbarim do të të falënderoj me këngën time dhe çdo ditë do ta plotësoj premtimin që të bëra.

### **Te Perëndia gjej qetësi**

**62** *Këngë e Davidit, sipas melodisë së Jedutunit.*

<sup>2</sup>Te Perëndia kthehem, prandaj jam i qetë; vetëm nga ai pres ndihmë. <sup>3</sup>Ai është shkëmbi dhe kështjella ku jam i sigurt; mund të tundem, por jo të bie! <sup>4</sup>Edhe për sa kohë do t'i turreni të vetmuarit, ju të gjithë së bashku, për t'i mbytur? Mur që tashmë priret, një mur i thyeshëm dhe i lëkundur – më tepër nuk jam! <sup>5</sup>Ju hartoni vazhdimisht plane për të më rrëzuar nga vendi i nderit; ju pëlqen të shpifni për mua. Goja juaj nxjerr për mua urime dhe bekime, por me zemër më shani. <sup>6</sup>Gjithnjë e më shumë duhet të them me vete: ktheju Perëndisë, atëherë do të gjesh qetësi! Vetëm ai më jep shpresë. <sup>7</sup>Vetëm ai është shkëmbi dhe kështjella ku jam i sigurt; prandaj nuk do të tundem. <sup>8</sup>Perëndia është Shpëtimtari im; ai e mbron nderin tim. Ai është shkëmbi im i fortë, strehimi im! <sup>9</sup>Ju që i takoni popullit të tij, vazhdoni t'i besoni atij, hapjani zemrën tuaj, sepse Perëndia është streha jonë! <sup>10</sup>Njerëzit, të lartët ose të ultët, janë një puihi, një hiç që mashtron! Në kupën e peshores ngrihen lart; të gjithë së bashku janë më të lehtë se puhia. <sup>11</sup>Mos u mbështetni te dhuna, mos pritni fitim nga vjedhja! Edhe nëse shtohet mirëqenia jote, mos e ngiitni zemrën pas asaj! <sup>12</sup>Perëndia ka folur, e kam dëgjuar më shumë se një herë se tek ai është pushteti – <sup>13</sup>Po, o Zot, si dhe besueshmëria; ti e shpërblen secilin sipas veprave të tij.

### **Malli për shoqërinë me Perëndinë**

**63** *Këngë e Davidit, kur ishte në shkretëtirën e Judës.*

<sup>2</sup>O Perëndi! Ti je Perëndia ime, ty të kërkoj! Kam mall për ty me mish e me shpirt; kam etje për ty si një tokë e thatë dhe pa ujë. <sup>3</sup>Në Tempull të kërkoj me sy për të parë fuqinë dhe madhësinë tënde. <sup>4</sup>Dashuria jote ka më shumë rëndësi për mua sesa vetë jeta; për këtë do të të lavdëroj. <sup>5</sup>Tërë jetën time do të të falënderoj dhe drejt teje do t'i zgjas duart lart duke u lutur.

<sup>6</sup>Ti më ngop dhe më gazmon si në gosti; të lavdëroj me buzë të qeshura. <sup>7</sup>Në orët e natës, i shtrirë në shtrat, mendimet e mia të drejtohen ty dhe në lutje mendoj vetëm për ty. <sup>8</sup>Po, ti më ndihmove, nën mbrojtjen e flatrave të tua mund të këndoja nga gëzimi. <sup>9</sup>Jam i lidhur ngushtë me ty, e ti më mban me dorën tënde të fuqishme. <sup>10</sup>Të gjithë ata që presin rrënimin tim, të zbresin vetë në botën e të vdekurve! <sup>11</sup>Ti dorëzohen shpatës, si ushqim për çakajtë!

<sup>12</sup>Por mbreti kënaqet me Perëndinë! Lum ai që, kur betohet, thërret për dëshmitar Perëndinë! Por gënjeshtarëve do t'u mbyllet goja!

### **Gjyqi i Perëndisë për armiqtë mashtrues**

**64** *Këngë e Davidit.*

<sup>2</sup>O Perëndi, dëgjoje lutjen time të dëshpëruar! Mbroje jetën time nga armiqtë që më futin frikë dhe tmerr! <sup>3</sup>Hartojnë plane për fatkeqësinë time, bëhen bashkë kundër meje. Më largo prej tyre, më çon në vend të sigurt!

<sup>4</sup>Gjuhët e tyre janë si shpata të mprehta; si shigjeta që llojnë me fjalë helmuese, <sup>5</sup>nga prita, pa paralajmërim dhe pa ngurrim, për të qëlluar në njerëz të pafajshëm. <sup>6</sup>E nxitin njëri-tjetrin dhe këshillohen se si duhet ta ngrenë kurthin; mendojnë se askush nuk do t'i zbulojë. <sup>7</sup>Krimin e tyre e planifikojnë duke thënë: «E shihni, pra, tani sigurisht do të na dalë mirë! – Prej kokës me mend vijnë mendime të mprehta.» <sup>8</sup>Por Perëndia i qëllon me hark, papritur lëshohen shigjetat e tij. <sup>9</sup>Fjalët e tij i rrëzojnë. Kush i sheh të shtrirë për tokë, tund kokën. <sup>10</sup>Të gjithë i kap frika; e përhapin atë që bëri Perëndia, dhe pësimi u bëhet mësim. <sup>11</sup>Kush ia mban besën Zotit, do të gjejë tek ai gëzim dhe strehim. Kushdo që e dëgjon me zemër, mund të krenohet e të gëzohet.

### **Falënderim për të mirat e Perëndisë**

**65** *Këngë e Davidit.*

<sup>2</sup>O Perëndi, që banon në malin e Cionit, ka hije që të të lavdërojmë ty, që secili ta plotësojë betimin e tij. <sup>3</sup>Ti i dëgjon lutjet, prandaj të gjithë njerëzit vijnë tek ti. <sup>4</sup>Gabimet tona rëndojnë shumë mbi ne, por ti mund të na e falësh fajësinë. <sup>5</sup>I lumtur është kushdo që zgjedh ti dhe e lejon të të afrohet ty, të banojë në oborret e Tempullit tënd. Ne duam të përfitojmë nga të gjitha të mirat që marrim në Tempullin tënd.

<sup>6</sup>O Perëndi, Shpëtimtari ynë, ti na e mban besën, ti na jep përgjigje nëpërmjet veprave që ngjallin nderim

të thellë. Ti je shpresa e tërë botës, deri në detet më të largëta. <sup>7</sup>Me fuqinë tënde malet i vure në vend. Ti afrosh me fuqi të madhe, <sup>8</sup>dhe qetëson tërbimin e detit, e shuan gjëmimin e valëve të tij; dhe tërbimin e popujve e qetëson. <sup>9</sup>Ata tmerrohen nga mrekullitë e tua edhe në skajet më të largëta të tokës. Veprat e tua ngjallin gëzim dhe brohoritje gjithkund në botë ku banojnë njerëzit.

<sup>10</sup>Ti kujdesesh për tokën; ti e pasuron dhe i jep asaj pjellori; kështu bën të rritet drithi për njerëzit. O Perëndi, përrrenjtë e tu janë gjithnjë plot me ujë. <sup>11</sup>Hullitë i njom dhe plisat i rrafshon; arat i ujit me shiun jetëdhënës dhe bën të lulëzojë gjithçka që mbin në to. <sup>12</sup>Vitin e kurorëzon me dhurata të mira, në gjurmët e tua lëshon begati. <sup>13</sup>Kullotat në stepë janë të lagështa dhe të gjelbëra, kodrat kumbojnë përsëri nga thirrjet e gëzimit. <sup>14</sup>Livadhet mbushen plot me kope, luginat mbulohen me drithë që vallëzon në erë; gjithçka është plot brohoritje dhe këngë.

### **Këngë falënderimi për ndihmën e Perëndisë**

## **66** *Një këngë.*

Brohoritni për Perëndinë, të gjithë ju kombet e botës! <sup>2</sup>Këndoni për nder të emrit të tij, lavdërojeni me këngët e lavdërimit. <sup>3</sup>Thuajini Perëndisë: «Sa të mëdha janë veprat e tua! Armiqtë duhet të përkulen para teje, sepse ti je shumë i fuqishëm. <sup>4</sup>Të adhuroftë mbarë bota, këndofshin të gjithë për nderin tënd, të adhurofshin me këngët e tyre!»

<sup>5</sup>Ejani këtu e shikoni se ç'bëri Perëndia! Veprat e tij i mbushin njerëzit me frikë e me habi. <sup>6</sup>Detin e shndërroi në tokë të thatë, që ta kalonim pa na u lagur këmbët. Dhe ne për këtë u gëzuam shumë! <sup>7</sup>Me fuqinë e tij ai mbretëron përgjithmonë dhe nuk i heq nga sytë kombet. Kush guxon t'i bëjë ballë atij? <sup>8</sup>Ju, o kombe, nderojeni Perëndinë tonë, lavdërojeni atë me zë të lartë! <sup>9</sup>Ai na mban në jetë dhe na mbron nga rrënimi.

<sup>10</sup>O Perëndi, ti na vure në provë. Siç pastrohet argjendi, ashtu na pastrove edhe ne. <sup>11</sup>Ti bëre që ne të binim në kurth për të na ngarkuar me barrë të rënda. <sup>12</sup>Armiqtë tanë ti i lejove të na rrëzonin përdhe në pluhur. Nëpër zjarr e ujë na duhej të kalonim; e megjithatë, ti lart na nxore, që të marrim frymë përsëri. <sup>13</sup>Me flijimet e përkushtimit po vij në shtëpinë tënde për të plotësuar premtimin tim. <sup>14</sup>Po ta sjell atë që të premtova, kur isha në gjendje të vështirë. <sup>15</sup>Po t'i sjell flitë më të mira, deshtë, cjeptë, dhe demat po t'i përgatit. Nga altari të ngrihet, drejt teje, tymi dhe aroma e tyre.

<sup>16</sup>Ju që nderoni Perëndinë, ejani këtu! Do t'ju tregoj se ç'bëri ai për mua. <sup>17</sup>E thirra për ndihmë, i bindur se do ta lavdëroja. <sup>18</sup>Po të kisha të keqen ndër mend, Zoti kurrë nuk do të më dëgjonte. <sup>19</sup>Por ja, më dëgjoi, kjo është e sigurt; Perëndia e dëgjoi thirrjen time për ndihmë. <sup>20</sup>E falënderoj Perëndinë! Lutjen time nuk e hodhi poshtë dhe nuk m'i mohoi të mirat e tij.

### **Të gjitha kombet lavdërofshin Perëndinë!**

## **67** *Këngë që shoqërohet me vegla me tela.*

<sup>2</sup>O Perëndi, na trego dashurinë tënde dhe na beko, na shiko me dashamirësi! <sup>3</sup>Atëherë mbarë bota do ta shikojë se si na udhëheq, dhe të gjitha kombet do ta pranojnë se ti na ndihmon e na çliron.

<sup>4</sup>O Perëndi, të gjitha kombet të falënderofshin, të gjithë popujt të lavdërofshin! <sup>5</sup>Nga lumturia dhe nga gëzimi këndofshin, sepse ti sundon me drejtësi mbi ta, ti i udhëheq kombet mbi tokë. <sup>6</sup>O Perëndi, të falënderofshin të gjitha kombet!

<sup>7</sup>Toka ka dhënë të korra të mbara, sepse na bekon Perëndia, Perëndia jonë! <sup>8</sup>Ai na ka bekuar dhe mbarë bota e nderoftë!

### **Fitorja e Perëndisë**

## **68** *Këngë e Davidit .*

<sup>2</sup>Perëndia ngrihet lart dhe armiqtë e tij shpërndahe; të gjithë ata që e urrejnë, ia mbathin para tij.

<sup>3</sup>Si tymi që e shpërndan era, si dylli që e shkrin zjarri, ashtu zhduken të këqijtë para Perëndisë.

<sup>4</sup>Por ata që marrin anën e tij, gëzohen dhe ngazëllohen para tij me gëzim që nuk shteron.

<sup>5</sup>Këndoni për nder të Perëndisë, lavdërojeni atë me këngë! Ndërtojeni rrugën për kalorësin e reve – Zot është emri i tij – gëzohuni dhe ngazëllohuni para tij! <sup>6</sup>Ati i jetimëve, përkrahja e vejushave – i tillë është Zoti në banesën e tij të shenjtë! <sup>7</sup>Të vetmuarit i bën me familje, robërve u jep liri dhe lumturi; por rebelët i lë të banojnë mes shkëmbinjeve të zhveshur.

<sup>8</sup>O Perëndi, ti dole në krye të popullit tënd, kur e udhëhoqe nëpër shkretëtirë. <sup>9</sup>Atëherë toka u tund, atëherë qielli rrodhi para teje, para Perëndisë së Sinait, Perëndisë së Izraelit. <sup>10</sup>Ti bëre të binte një shi i madh për ta gjallëruar përsëri tokën tënde të rraskapitur. <sup>11</sup>Atje, në atë vend populli yt u ngul dhe në mirësinë tënde, ti u kujdesë për të varfrit.

<sup>12</sup>Zoti thotë fjalën vendimtare, dhe tashmë shumë gra e përhapin lajmin për fitoren: <sup>13</sup>«Mbretërit e armikut po ikin, ushtritë e tyre marrin arratinë! Për ne gratë në shtëpi, ka plaçkë të madhe për të ndarë. <sup>14</sup>Krahët e pëllumbit vezullojnë nga argjendi, dhe puplat e tij janë të mbuluara me ar të kulluar. Ende vazhdoni të rrini te kopetë?» <sup>15</sup>Kur Perëndia, i Fuqishmi, dëboi mbretërit, mbi malin e zi ra dëborë. <sup>16</sup>Mali i Bashanit është vargmal i madh, është një vargmal me shumë maja. <sup>17</sup>Përse je xheloz, ti me shumë majat e tua,

përse e shikon me bisht të syrit malin që Perëndia zgjodhi si vendbanimin e vet? Zoti do të rrijë atje përgjithmonë!

<sup>18</sup>Perëndia ka me dhjetëra, me qindra mijëra karroca të shkëlqyeshme, e në mes të tyre është vetë Perëndia, i Shenjti, në madhësinë e tij. <sup>19</sup>Ai u ngrit lart në qiell duke sjellë me vete robërit e liruar. Njerëzve ua ndau dhuratat nga plaçka e luftës, por rebelët nuk mund të banojnë te Zoti, Perëndia jonë.

<sup>20</sup>Qoftë lavdëruar Zoti gjithmonë, sepse na mban – ai është ndihmësi ynë! <sup>21</sup>Ai është Perëndia që na ndihmon herë pas here; Ai është Zoti ynë, i cili na shpëton nga vdekja. <sup>22</sup>Por armiqve tanë Perëndia do t'ua thyejë kokën, të gjithë atyre që mbeten tek krimet e tyre. <sup>23</sup>Zoti ka shpallur: «Do t'i kthej nga mali i Bashanit, edhe nga thellësitë e detit do t'i kthej. <sup>24</sup>Ti do të ecësh mbi gjakun e armiqve, dhe qentë e tu me gjuhë do ta lëpinë derisa të jenë të ngopur.»

<sup>25</sup>O Perëndi, të gjithë e panë procesionin tënd të triumfit, hyrjen tënde në Tempull, ti, Perëndia ime dhe mbreti im! <sup>26</sup>Në krye këngëtarët, pastaj harpistët, rreth e rrotull vajzat që u bien dajreve. <sup>27</sup>«Falënderojeni Perëndinë, kur të mblidheni për festë! Falënderojeni Zotin, ju pasardhësit e Jakovit!» <sup>28</sup>Benjamini u vjen në krye, fisi më i vogël, pastaj vijnë kryetarët e Judës, me turmat e tyre të ngazëlluara, dhe më pas kryetarët e Zevulunit dhe të Naftaliut.

<sup>29</sup>Ju do të forcoheni, o Izrael; kështu vendosi Perëndia juaj. «O Perëndi, fuqizojë atë që bëre për ne! <sup>30</sup>Në Tempullin tënd në Jerusalem, mbretërit sjellin haraçin e tyre. <sup>31</sup>Bërtiti Egjiptit, kësaj egërsire të kulmakut; kërcënoji kombet, këtë tufë demash dhe vëshash, të gjithë ata që bien përmbys para teje me monedha të argjendta në duar!» Shpërndaj kombet që kënaqen me luftëra. <sup>32</sup>Prej Egjiptit njerëzit sjellin stofra të kuqe, prej Etiopisë vijnë me vrap dhe e nderojnë Perëndinë me dhuratat e tyre.

<sup>33</sup>Ju, të fuqishmit e botës, këndonin për nder të Perëndisë, lavdërojeni Zotin me këngë! <sup>34</sup>Ai po kalon nëpër qiellin më të lartë që është që nga përjetësia. Dëgjoni se sa fuqishëm kumbon zëri i tij! <sup>35</sup>Pranojeni pushtetin e tij! Mbretëron në Izrael në madhësinë e tij, dhe pushteti i tij përfshin mbarë qiellin. <sup>36</sup>Që nga Tempulli i tij Perëndia ngjall respekt të thellë. Ai është Perëndia e Izraelit; i jep kombit të tij forcë e fuqi. Qoftë lavdëruar Perëndia!

### **Për shkak të Perëndisë i zhytur në turp dhe në faqe të zezë**

**69** *Këngë e Davidit, e kënduar sipas melodisë 'Zambakët.'*

<sup>2</sup>Më ndihmo, o Perëndi! Uji më ka ardhur deri në grykë! <sup>3</sup>Po fundosem në baltën që më thith dhe këmbët nuk gjejnë vend për t'u mbështetur. Po zhytem në thellësi të ujit, i rrëmbyer nga rryma e fortë! <sup>4</sup>U këputa duke të thirrur ty dhe gryka ime m'u tha duke të kërkuar. Sytë m'u veshën duke të pritur ty, o Perëndia ime! <sup>5</sup>Ata që më urrejnë pa arsye, janë më të shumtë se qimet e flokëve në kokën time. Armiqtë e mi përhapin gënjeshtër për mua, ata janë të fuqishëm dhe duan të më shkatërrojnë. Ata kërkojnë që t'u kthej atë që nuk ua kam vjedhur!

<sup>6</sup>O Perëndi, ti e di, se sa i pamend kam qenë; mëkatet e mia nuk janë të panjohura për ty. <sup>7</sup>O Zot, Perëndia e mbarë botës, për shkakun tim mos i mbulo me turp edhe ata që të kërkojnë; <sup>8</sup>o Perëndia e Izraelit, për hatrin tim mos i zhgënjë edhe ata që shpresojnë tek ti! Prej dashurisë që kam për ty, më kanë fyer e më kanë mbuluar me turp. <sup>9</sup>U bëra i huaj për fafesisin tim, edhe vëllezërit e mi nuk më njohin më. <sup>10</sup>Dashuria për shtëpinë tënde më djeg përbrenda si zjarr. Fjalët, me të cilat të shajnë ty, mua më prekin thellë në zemër. <sup>11</sup>Qaj dhe agjëroj, po për këtë vetëm me tallin. <sup>12</sup>Vishem me të zeza, dhe për këtë më përqeshin. <sup>13</sup>Atje ku mblidhen njerëzit, bëhem objekt i thashethemeve të tyre dhe temë e këngëve tallëse të pijanecëve.

<sup>14</sup>Megjithatë unë të lutem ty, o Zot! Më ndihmo në kohën që cakton Ti! O Perëndi, ti je kaq i pasur me mirësi, prandaj më jep përgjigje! Ti je, megjithatë, Shpëtimtari i besuar. <sup>15</sup>Mos më lër të fundosem në baltë, më tërhiq! Më shpëto nga ata që më urrejnë! Më nxirr nga thellësia e ujit! <sup>16</sup>Përndryshe, rryma do të më rrëmbejë, humnera do të më përpijë, dhe gropa do të mbyllet përmbi mua! <sup>17</sup>Më jep përgjigje, o Zot, sepse mirësia jote më bën mirë; më drejto në mëshirën tënde të pamasë! <sup>18</sup>Mos u fshih më prej meje, o Zoti im! Më ka pushtuar frika, më dëgjo sa më shpejt! <sup>19</sup>Eja tek unë dhe më çliro; më shpëto, që të pushojnë armiqtë e mi!

<sup>20</sup>Ti e di se si më përbuzin, më fyejnë dhe më mbulojnë me faqe të zezë; të gjithë kundërshtarët më qëndrojnë para syve. <sup>21</sup>Poshtërimi ma ka thyer zemrën, jam fyer rëndë. Kam pritur të më përkrahin, por askush nuk u solidarizua me mua. Kërkova dikë që të më ngushëllonte, por nuk gjeta as edhe një të vetëm. <sup>22</sup>Në vend të ushqimit më dhanë helm, dhe uthull më ofruan për të më shuar etjen. <sup>23</sup>Gostitë e flijimet iu bëfshin kurth që i shpie në shkatërrim, ata bashkë me shoqëruesit e tyre të tryezës. <sup>24</sup>U verbofshin, që të mos shohin më, bëji të sëmure dhe të pafuqishëm përgjithmonë! <sup>25</sup>Derdhe zemërimin tënd mbi ta, i përpiftë zjarri i inatit tënd! <sup>26</sup>U shkretëftë vendbanimi i tyre, dhe çadrat e tyre mbetshin pa njeri! <sup>27</sup>Sepse e ndjekin kundërshtarin, edhe atëherë kur tashmë e gjeti dënimi yt, dhe me dëshirë flasin për ata që ke plagosur. <sup>28</sup>Llogaritju çdo mëkat, që të mos gjejnë miratim tek ti! <sup>29</sup>Fshijua emrat nga libri i jetës, që të mos jenë në listë bashkë me ata që të qëndrojnë besnikë.

<sup>30</sup>Unë vetë jam i varfër dhe i munduar nga vuajtjet, me ndihmën tënde, më sill në siguri! <sup>31</sup>Atëherë do të të lavdëroj me këngën time dhe të bëj të njohur madhësinë tënde me falënderimin tim. <sup>32</sup>Kjo të pëlqen më

shumë se flijimi i një kau ose flijimi i demit të fortë dhe të rritur. <sup>33</sup>Të shtypurit këtë do ta shohin e do të gëzohen.

Ju të gjithë që kërkonin Perëndinë, le t'ju mbushen zemrat me gëzim të ri! <sup>34</sup>Sepse Zoti e dëgjon thirrjen e nevojtarëve dhe besnikët e tij nuk i braktis kur janë në burg. <sup>35</sup>E lavdërofshin qielli dhe toka, deti dhe gjithçka që banon në të. <sup>36</sup>Sepse Zoti do të çlirojë malin e Cionit e do të rindërtojë qytetet e Judës. Populli i tij do të banojë përsëri atje, dhe atij do t'i takojë toka (e premtuar). <sup>37</sup>Fëmijët e shërbëtorëve të tij do ta trashëgojnë dhe të gjithë ata që e duan Zotin, do të banojnë atje.

### Në pritje të Perëndisë

**70** *Këngë e Davidit për të përkujtuar Perëndinë.*

<sup>1</sup>O Perëndi, më shpëto! Eja, më ndihmo shpejt! <sup>2</sup>Turp e faqja e zezë për ata që përpiqen të më vrasin! U tërheqshin të turpëruar ata që kënaqen me fatkeqësinë time! <sup>3</sup>U kthefshin prapa me turp ata që qeshin me ligësi me mua. <sup>4</sup>Por të gjithë ata që kërkojnë praninë tënde, u gëzofshin e të ngazëllofshin për ty! Të gjithë ata që dëshirojnë ndihmën tënde, thirrshin gjithnjë: «I madh është Perëndia!»

<sup>5</sup>Jam i varfër dhe i pambrojtur; o Perëndi, eja shpejt e më ndihmo! Ti je Ndihmësi dhe Çlirimtari im, o Zot, mos u vono!

### Lutja për mbrojtje në pleqëri

**71** O Zot, tek ti kërkoj strehim; mos më zhgënj! <sup>2</sup>Më shpëto, më çliro, siç më premtove! Më dëgjo, më ndihmo! <sup>3</sup>Bëhu për mua shtëpi e sigurt, ku mund të hyj në çdo kohë! A nuk premtove të më ndihmosh? Ti je shkëmbi im dhe kështjella ime!

<sup>4</sup>Armiqtë e mi të përbuzin, o Perëndi, e shkelin besën dhe më keqtrajtojnë. Më shpëto nga grushtet e tyre.

<sup>5</sup>O Zot, ti je shpresa ime, që nga rinia besoj në ty. <sup>6</sup>Që nga dita kur linda ti je mbështetja ime, ti më nxore nga mitra e nënës, prandaj ty të takon falënderimi im përgjithmonë. <sup>7</sup>Shumë mendonin se më kishe mallkuar, por ti je Mbrojtësi im i fuqishëm. <sup>8</sup>Goja ime këndon gjithnjë lavdërime për ty, shpall gjithë ditën lavdinë tënde.

<sup>9</sup>Tani që u plaka, mos më largo nga prania jote! Tani që po më shterojnë forcat, mos më braktis! <sup>10</sup>Armiqtë e mi këshillohen e hartojnë plane për të më vrarë. <sup>11</sup>«Perëndia e ka mohuar – thonë. – Shpejt, kapeni! Tani askush nuk do t'i vijë në ndihmë!»

<sup>12</sup>O Perëndi, mos më qëndro larg! Eja shpejt, o Zot, të më ndihmosh! <sup>13</sup>Mundi dhe shkatërroji ata që më akuzojnë! U tërheqshin me turp dhe me faqe të zezë, të gjithë ata që kërkojnë rrënimin tim!

<sup>14</sup>Kurrë nuk do ta humb shpresën; e di se edhe në të ardhmen do të të lavdëroj. <sup>15</sup>Do t'u them të gjithëve se ti e mban fjalën; gjithë ditën do të tregoj se si na ndihmon, se veprat e tua të mira janë të panumërta. <sup>16</sup>Do të të lavdëroj për veprat e tua të mëdha, o Zot, Perëndia ime! Vetëm për ty dhe për besnikërinë tënde do të flas.

<sup>17</sup>O Perëndi, ti më mësove, që nga rinia ime e deri më sot tregoj për mrekullitë e tua. <sup>18</sup>Tani që u plaka dhe u thinja, mos më lër, o Perëndi! Dëshiroj t'u tregoj fëmijëve dhe stërnipërve të mi, sa i fuqishëm je, sa të madhërishme janë veprat e tua! <sup>19</sup>O Perëndi, besnikëria jote arrin deri në qiell! Ti bëre gjëra kaq të mëdha! Kush është si ti? <sup>20</sup>Ti bëre që të provoja kohë të këqija, por ti do të vish për të ma kthyer jetën; ti do të vish për të më ringjallur nga varri. <sup>21</sup>Edhe një herë ti do të më ngushëllosh; ti do të ma kthesh nderin e humbur. <sup>22</sup>Prandaj do të të lavdëroj duke i rënë harpës, do të këndoj për besnikërinë tënde, o Perëndia ime! Me lirë do të këndoj këngë lavdërimi për nderin tënd, për nder të Perëndisë së shenjtë të Izraelit.

<sup>23</sup>Buzët e mia do të këndojnë me ngazëllim, me këngë do t'i shpall lavdërimet e mia për ty, o Perëndi, që më ke çliruar.

<sup>24</sup>Ti e mban premtimin; për këtë do të tregoj gjithë ditën. Të gjithë ata që përpiqen të më vrasin, me turp do të mbarojnë.

### Urimi i bekimit për mbretin

**72** *Për Solomonin.*

O Perëndi, jepi mbretit urtësinë sipas frymës sate, që të nxjerrë vendime të drejta, atij, trashëgimtarit të drejtë të fronit, jepi fuqi të plotë gjyqësore! <sup>2</sup>I paanshëm ta gjykojë popullin tënd dhe t'i ndihmojë të shtypurit për të rifituar të drejtat e tyre. <sup>3</sup>Me anë të sundimit të tij, ardhte paqja për popullin dhe pasuria nga të gjitha malet dhe kodrat! <sup>4</sup>Të dëmtuarve mbreti do t'u sigurojë të drejtat dhe nevojtarëve do t'u vijë në ndihmë; por shtypësit ai do t'i shkelë me këmbë.

<sup>5</sup>Rroftë mbreti sa kohë të ndriçojnë dielli dhe hëna, brez pas brezi! <sup>6</sup>Ai i ngjan shiut që bie në fusha dhe rrebeshit që njom tokën e thatë! <sup>7</sup>Nën sundimin e tij do të lulëzojë drejtësia, dhe mirëqenia do të rritet, sa kohë të ekzistojë hëna.

<sup>8</sup>Mbretëria e tij do të shtrihet nga deti (i Vdekur) deri në detin (Mesdhe), nga lumi Eufrat deri në skajin e tokës (së premtuar)! <sup>9</sup>Para tij do të përkulen fiset e shkretëtirës; armiqtë e tij do të bien përmbys para tij!

<sup>10</sup>Mbretërit e Tarshishit dhe të ishujve më të largët do t'i dërgojnë atij dhuratat e tyre dhe mbretërit e Sabës dhe Shebës do t'i dërgojnë haraçin e tyre. <sup>11</sup>Të gjithë sundimtarët dhe të gjitha kombet atij do t'i

shërbejnë!

<sup>12</sup>Ai do t'i shpëtojë nevojtarët që e thërrasin për ndihmë, të shtypurit që nuk kanë asnjëri për t'i ndihmuar.

<sup>13</sup>Ai do të kujdeset për të dobëtit dhe të varfrit, dhe do t'u shpëtojë jetën atyre. <sup>14</sup>Ai do t'i çlirojë nga dhuna dhe shtypja, sepse jeta e tyre ka vlerë para tij. <sup>15</sup>Rroftë mbreti! Atij do t'i jepet ar nga Sheba, për të do të lutet në çdo kohë dhe bekimin do t'i japin dita ditës! <sup>16</sup>Drithi u rritet në mbarë tokën (e premtuar), deri lart në majat e maleve, i dendur dhe i tundur si pyjet lart në Liban! Qytetet lulëzofshin si luadhet e gjelbëra!

<sup>17</sup>Kurrë mos u harroftë nami i mbretit, sa të ekzistojë dielli! Kur njerëzit t'i urojnë njëri-tjetrit bekim, thënë: «Perëndia të bekoftë ashtu siç ka bekuar edhe mbretin!» Dhe të gjitha kombet do të tregojnë për lumturinë e tij. <sup>18</sup>Qoftë lavdëruar Zoti, Perëndia e Izraelit, i vetmi që bën mrekulli. <sup>19</sup>Qoftë lavdëruar përgjithmonë emri i tij i lavdishëm. Fuqia e tij u bëftë e njohur në mbarë botën! Amen, ashtu u bëftë!

<sup>20</sup>Këtu përfundojnë lutjet e Davidit, birit të Jishait.

## LIBRI I TRETË

### Nuk mund të largohem nga Perëndia

#### 73 *Këngë e Asafit.*

Unë e di: Perëndia është i mirë ndaj Izraelit, ndaj të gjithë atyre që e dëgjojnë me gjithë zemër.

<sup>2</sup>Për pak bëra gabim, shpëtova për një qime, se do të kisha rënë. <sup>3</sup>Isha xheloz për njerëzit që nuk pyesin për vullnetin e Perëndisë, sepse pashë që gjithçka u shkonte mbarë. <sup>4</sup>Nuk njohin asnjë sëmundje deri në vdekjen e tyre; janë të shëndoshë dhe të ushqyer mirë. <sup>5</sup>Bëjnë një jetë pa shqetësime dhe nuk kanë nevojë të mundohen si njerëzit e tjerë. <sup>6</sup>Mendjemadhësinë e mbajnë si stoli, kurse ashpërsinë si rrobë të çmuar. <sup>7</sup>Jeta e tyre luksoze i çon në mëkat; nga zemra e tyre burojnë plane të këqija. <sup>8</sup>Të folurit e tyre është plot me tallje dhe shpifje; njerëzit i trembin me fjalë të mëdha. <sup>9</sup>Hapin gojën për të sharë qiellin; gjuha e tyre e keqe nuk kursen asgjë në botë. <sup>10</sup>Prandaj edhe populli i Perëndisë shkon prapa dhe e dëgjon me vëmendje llomotitjen e tyre. <sup>11</sup>«Perëndia nuk vë re asgjë! – thonë. – E si mund të dijë ai lart në qiell se çfarë bëhet këtu poshtë?» <sup>12</sup>Të tillë janë të gjithë ata që nuk e përfillin Perëndinë; grumbullojnë fuqi dhe pasuri dhe çdo gjë u shkon mbarë.

<sup>13</sup>Pra, ishte e kotë, o Zot, që e mbaja ndërgjegjen të pastër dhe që gjithnjë e më shumë ruaja pafajësinë time. <sup>14</sup>Po megjithatë, më mendojnë çdo ditë, gjithnjë më ndjek fatkeqësia. <sup>15</sup>Por në qoftë se do të flisja edhe unë si ata, do t'i tradhtoja të gjithë ata që të takojnë ty. <sup>16</sup>Mundohesha t'i kuptoja të gjitha këto, por kjo më dukej krejtësisht e pamundur. <sup>17</sup>Por, kur hyra në Tempullin tënd, e kuptova fatin që i priste ata. <sup>18</sup>Ti i vë ata në tokë të rrëshqitshme; ti i verbon, që të rrëzohen. <sup>19</sup>Mbarojnë papritur, marrin fund të tmerruar. <sup>20</sup>O Zot, kur të ngrihesh, do t'i shuash ata, porsì ëndrra që zhduket. <sup>21</sup>Kur isha i helmuar nga jeta dhe i tronditur përbrenda, <sup>22</sup>e kisha humbur logjikën, dhe u bëra kafshë. <sup>23</sup>Megjithatë, nuk mund të ndahem nga ti. Ti më kape për dore dhe më ruajte; <sup>24</sup>ti më udhëheq sipas planit tënd dhe në fund do të më marrësh në praninë tënde madhështore. <sup>25</sup>Në qiell, kush mund të më ndihmonte veç teje? Edhe mbi tokë, ç'do të doja më shumë kur të kam ty? <sup>26</sup>Edhe në qoftë se do t'i humbisja të gjitha, ti, o Perëndi, më ruan; ti qëndron përgjithmonë me mua.

<sup>27</sup>Kush largohet prej teje, rrënohet; kush nuk të qëndron besnik, atë ti e shkatërron. <sup>28</sup>Por unë besoj në ty, o Zoti im; prania jote është lumturia më e madhe. Ngado do të tregoj për çdo gjë që ke bërë ti.

### Vajtim për Tempullin e shkatërruar

#### 74 *Këngë e Asafit.*

O Perëndi, mos na ke braktisur përgjithmonë? Përse vlon zemërimi yt me kaq tmerr kundër nesh?

Por ne jemi kopeja jote, e ti je bari ynë! <sup>2</sup>Kujto kohën kur na çlirove! Atëherë na bërë pronën tënde, dhe prej asaj kohe jemi populli yt. Kujtoje malin e Cionit, që caktove si banesën tënde! <sup>3</sup>Eja të shohësh gërmadhat e hidhura! Armiqtë e shkatërruan gjithë Tempullin.

<sup>4</sup>Me ulërima e me dhunë hynë në shenjtërore dhe vendosën atje flamurin e tyre. <sup>5-6</sup>Silleshin si druvarë që vringëllonin sëpatat në pyll. Me sëpatat dhe shkopinjtë e tyre të hekurt, ata shkatërruan skulpturat e çmuara. <sup>7</sup>I vunë zjarrin Tempullit tënd, e shembën dhe e çnderuan banesën tënde. <sup>8</sup>Thirrën: 'Do t'i japim fund kombit tuaj! I djegim të gjithë tempujt e botës!'

<sup>9</sup>Nuk ka më asnjë shenjë se ti je ende mes nesh. Nuk flet më asnjë profet; askush nga ne nuk e di se edhe sa kohë do të zgjatë kjo. <sup>10</sup>O Perëndi, edhe sa kohë do të të provokojë armiku? Vallë nuk pushon së shari emrin tënd? <sup>11</sup>Përse i shikon pa vënë fare gisht? Kur do të ndërhysh, më në fund?

<sup>12</sup>O Perëndi, prej kohësh ti je mbreti ynë; ti e ke shpëtuar tokën kaq herë. <sup>13</sup>Me fuqinë tënde çave detin dhe ia shtype kokën përbindëshit të detit. <sup>14</sup>Ti ia preve kokat kuçedrës, dhe peshkaqenëve ua dhe për ushqim. <sup>15</sup>Ti bërë të buronin gurat dhe përrenjtë dhe lumenjtë e pashtershëm i bërë të shteronin. <sup>16</sup>Dita të takon ty, ashtu edhe nata; diellin dhe hënën i vendose ti. <sup>17</sup>Ti i vure kufijtë e të gjitha krahinave të tokës; ti krijove verën dhe dimrin.

<sup>18</sup>O Zot, dëgjo se si të provokojnë armiqtë tanë, ty të përbuzin dhe shajnë emrin tënd. <sup>19</sup>Mos e dorëzo popullin tënd te këta hajdutë që na shtypin! Mos na lër të vuajmë vazhdimisht! <sup>20</sup>Mendo për besëlidhjen



tënde me ne! Të gjitha qoshet e skutat janë të mbushura me kriminelë dhe dhunë. <sup>21</sup>Mos i zhgënjë të përndjekurit; shpëtoji të varfrit dhe të shtypurit, që ata të të lavdërojnë. <sup>22</sup>Ndërhyr, o Perëndi, mbroje çështjen tënde! Kujtoji shpifjet që bëjnë armiqtë e tu të paturpshëm. <sup>23</sup>Dëgjoji se si po tërbohen; thirrja e tyre po shtohet gjithnjë!

### **Perëndia vjen për të bërë gjyqin**

**75** *Këngë e Asafit, sipas melodisë 'Mos shkatërro gjithçka'.*

<sup>2</sup>Të falënderojmë, o Perëndi, të falënderojmë! Tregojmë për mrekullitë që bën.

<sup>3</sup>«Kur të vijë çasti, koha që kam caktuar unë, – thotë Perëndia, – atëherë do të bëj gjyq të paanshëm. <sup>4</sup>Edhe në qoftë se tundet toka dhe banorët e saj vdesin nga tmërri, shtyllat i kam vendosur në themele të forta.»

<sup>5</sup>Prandaj u them mendjemdhenjve: «Mjaft më me mburrjen!» Atyre që përbuzin urdhërimet e Perëndisë u them: «Mos u mburrni! <sup>6</sup>Loja juaj mbaroi, pushoni së foluri me kaq guxim! <sup>7</sup>Nuk mund të pritni asgjë, as prej lindjes, as prej perëndimit, as prej veriut, dhe as prej jugut. <sup>8</sup>Vetë Perëndia do të vijë për të bërë gjyqin; njërin do ta rrëzojë, tjetrin do ta ngrejë.»

<sup>9</sup>Zoti ka në dorë një gotë, plot me verë të gazuar e me erëza. Të gjithë atyre në tokë që e kundërshtojnë, do t'u japë të pinë prej kësaj vere të hidhur; të gjithë do të detyrohen ta pinë deri në pikën e fundit.

<sup>10</sup>E unë nuk pushoj së foluri për veprat e tij dhe Perëndinë e Jakovit e nderoj me këngë. <sup>11</sup>Ai do t'ua shkatërrojë pushtetin keqbërësve; ndërsa ata që i qëndrojnë besnikë, do t'i forcojë.

### **Perëndia është fitimtar**

**76** *Këngë e Asafit, e shoqëruar me vegla me tela.*

<sup>2</sup>Perëndia është njohur në Judë; në Izrael nderohet emri i tij. <sup>3</sup>Në Jerusalem ka shtëpinë. Banesën e ka në malin e Cionit. <sup>4</sup>Atje të gjitha armët e luftës i ka thyer, shigjetat, shpatat dhe mburojat.

<sup>5</sup>Sa madhështor je, o Perëndi; sa i fuqishëm je, ndërsa kthehesh nga malet, ku i ke mundur armiqtë e tu.

<sup>6</sup>Luftëtarëve të tyre të patrembur iu grabitën të gjitha, dhe tani bëjnë gjumin e vdekjes; gjithë fuqia dhe shkathtësia e tyre ishin të kota. <sup>7</sup>Kur ti i kërcënove, o Perëndia e Jakovit, kuajt dhe kalorësit ranë të vdekur.

<sup>8</sup>Por ti, o Zot, ngjall respekt të thellë! Askush nuk mund të qëndrojë në praninë tënde, kur zemërohesh.

<sup>9</sup>Nga qielli ke bërë të njohur vendimet e tua gjyqësore; bota u frikësua dhe heshti, <sup>10</sup>kur u ngrite, o Perëndi, për të bërë gjyqin, për t'i çliruar të shtypurit në botë. <sup>11</sup>Tërbimi i njeriut vetëm shton lavdinë tënde; ata që mbijetojnë nga luftërat do t'u përmbahen festave të tua.

<sup>12</sup>Jepini Perëndisë ato që i premtuat. Ju popuj që banoni rreth tij, silljani dhuratat Perëndisë, që ngjall nderim! <sup>13</sup>Ai mposht udhëheqës mendjemdhenj dhe sundimtarëve të botës u ngjall frikë.

### **Ngushëllimi në gjendje të dëshpëruar**

**77** *Këngë e Asafit, sipas melodisë së Jedutunit.*

<sup>2</sup>E thërras Perëndinë me sa zë kam; e thërras për ndihmë, e ai do të më dëgjojë. <sup>3</sup>Në frikën time e kërkova Zotin; natën zgjata dorën drejt tij, pa u lodhur.

<sup>4</sup>Ngushëllimi i njerëzve nuk mund të më ndihmojë! <sup>5</sup>Po mendoja për Perëndinë, duhej të rënkoja; po mendohesha, më kapi dëshpërimi. Ai më pengon t'i mbyll sytë; jam i hutuar, dhe nuk di se ç'të them.

<sup>6</sup>Mendoj për kohët e kaluara, më kujtohen vitet e dikurshme, <sup>7</sup>kur u mbusha me gëzim duke i rënë veglës me tela. Tërë natën e kaloj duke vlarë mendjen, gjithnjë më mendojnë të njëjtat pyetje:

<sup>8</sup>Vërtetë na ka dëbuar Zoti përgjithmonë? Vërtetë nuk do t'ia dijë më për ne? <sup>9</sup>Vërtetë nuk do të na e tregojë mirësinë? A nuk vlen më premtimi i tij? <sup>10</sup>Vallë harroi Perëndia të ketë mëshirë për ne? Mos na e ka mbyllur zemrën prej zemërimit? <sup>11</sup>Nuk shihet asnjë shenjë nga fuqia e Perëndisë, më i Larti nuk bën asgjë më për ne – pikërisht kjo më mundon!

<sup>12</sup>Mendoj për veprat e tua, o Zot, i përmend mrekullitë e tua të kaluara. <sup>13</sup>Numëroj ato që kreve, dhe gjithnjë mendoj për to. <sup>14</sup>O Perëndi, gjithçka që bën, është e shenjtë! Asnjë perëndi tjetër nuk është kaq i fuqishëm sa ti! <sup>15</sup>Ti je i vetmi që bën mrekulli; të gjithë kombet e njohin fuqinë tënde. <sup>16</sup>Me dorë të fortë e çlirove popullin tënd, pasardhësit e Jakovit dhe të Josefit.

<sup>17</sup>Kur të panë ujërat, o Perëndi, atëherë filluan të lëkundeshin, thellësia e detit filloi të dridhej. <sup>18</sup>Shiun me gjyma e derdhën retë, mes tyre gjëmonte bubullima, dhe shigjetat e tua godisnin ngado. <sup>19</sup>Në gjëmimin e bubullimës sate, rrufeja jote ndriti mbarë tokën; toka u drodh dhe u lëkund.

<sup>20</sup>Rrugën tënde ti e hape përmes detit; shtegun tënd e çave nëpër thellësi, por gjurmët e tua nuk i pa asnjëri. <sup>21</sup>Me anë të shërbëtorëve të tu, Moisiut dhe Aharonit, popullin tënd e udhëhoqe si kope.

### **Mësimet nga historia fetare e Izraelit**

**78** *Këngë e Asafit.*

<sup>2</sup>O populli im, dëgjoje mësimin tim! Ju të gjithë, vini re fjalët e mia! <sup>3</sup>Do t'ju kujtoj të kaluarën, do t'ju tregoj udhëheqjen e fshehtë të Perëndisë. <sup>4</sup>Të gjitha këto i dimë prej kohësh, sepse vazhdimisht

i mësojmë, kur etërit na i tregojnë. <sup>4</sup>Nuk do t'ua fshehim fëmijëve tanë. Edhe brezave të ardhshëm do t'ua tregojmë për fuqinë e Zotit, për mrekullitë e tij, për të gjitha veprat për të cilat e lavdërojmë.

<sup>5</sup>Ai bëri besëlidhje me Izraelin, pasardhësve të Jakovit u dha udhëzimet e tij. Të parët tanë ai i urdhëroi, fëmijëve të tyre t'ua tregojnë për këto. <sup>6</sup>Kështu, edhe brezi që vjen më pas, edhe fëmijët që ende nuk kanë lindur, këto t'i mësojnë e, kur të bëhen vetë prindër, t'ua përcjellin fëmijëve të tyre. <sup>7</sup>Ata duhet të besojnë në Perëndinë, të mos i harrojnë kurrë veprat e tij dhe t'ua përmbahen me besnikëri urdhërimeve të tij. <sup>8</sup>Ata nuk duhet t'ua ngajnë të parëve, brezit të rebelëve të pabindur, të pabesuar dhe të lëkundshëm, të pabesë ndaj Perëndisë. <sup>9</sup>Efraimasit, të armatosur me shigjeta e harqe, ikën në ditën e betejës. <sup>10</sup>Nuk iu përmbajtën besëlidhjes me Perëndinë, dhe nuk deshën t'i zbatonin urdhërimet e tij. <sup>11</sup>Ata i harruan të mirat e tij dhe mrekullitë që kishin parë prej tij.

<sup>12</sup>Në Egjipt, në krahinën e Coanit, para syve të të parëve, Perëndia bëri vepra të fuqishme. <sup>13</sup>E ndau detin dhe i lejoi të kalonin; ujërat i bllokoi si me digë. <sup>14</sup>Ditës i udhëhiqte me një re dhe natës me ndriçimin e një zjarri. <sup>15</sup>Shkëmbin e çau në shkretëtirë dhe bëri të dilte uji nga thellësia. <sup>16</sup>Nga shkëmbi i fortë shpërthyen përrenjtë dhe rrodhën prej tij rrëke të fuqishme.

<sup>17</sup>Por ata mëkatuan vazhdimisht kundër të Lartit; e kundërshtuan atje në shkretëtirë. <sup>18</sup>Guxuan ta vinin Perëndinë në provë, kur kërkuan ushqim sipas qejfit. <sup>19</sup>Dyshuan në të e thanë: «A është në gjendje Perëndia ta shtrojë tavolinën këtu në shkretëtirë? <sup>20</sup>Vërtet shkëmbin e goditi dhe ujërat rrodhën me furi e dolën përrenj të rrëmbyeshëm. Po bukën, a mund të na e sigurojë? A mund ta sjellë ushqimin për popullin e tij?» <sup>21</sup>Kur i dëgjoji duke folur kështu, Zoti u zemërua me pasardhësit e Jakovit; zemërimi i tij ra mbi Izrael si zjarr. <sup>22</sup>Ata nuk i kishin besuar Perëndisë së tyre, e as nuk kishin pritur ndihmën e tij. <sup>23</sup>Megjithatë, u dha urdhër reve dhe portat e qiellit i hapi; <sup>24</sup>bëri të binte manë mbi ta, dhe u dha për ushqim bukën e qiellit. <sup>25</sup>Të gjithë e hëngrën 'bukën e engjëjve'; Perëndia ua dërgoi për ushqim dhe ata u ngopën. <sup>26</sup>Në qiell lëshoi erën e lindjes, bëri të afrohej dhe era e jugut. <sup>27</sup>Pastaj bëri që mbi ta të binte mishi me shumicë, zogj, të panumërt si mizat e dheut. <sup>28</sup>I bëri të binin në mes të fushimit, ngado rreth çadrave të izraelitëve. <sup>29</sup>Hëngrën të gjithë dhe u ngopën; Perëndia ua dha atë që kishin kërkuar, <sup>30</sup>por lakmia e tyre nuk u shua. Ende e kishin gojën plot mish, <sup>31</sup>kur Perëndia u zemërua dhe goditi; burrat e rinj e të fortë i vrau.

<sup>32</sup>Megjithatë, ata mëkatuan vazhdimisht; nuk u zunë besë mrekullive të tij. <sup>33</sup>Prandaj jetës së tyre ua hoqi gëzimin dhe i bëri të mbaronin në ankth e në tmerr. <sup>34</sup>Sa herë që vdekja vërsulej mbi ta, ata kujtoheshin, i ktheheshin Perëndisë dhe me lutje kërkonin mbrojtje tek Ai.

<sup>35</sup>Atëherë kujtoheshin që Perëndia ishte Mbrojtësi i tyre; Ai, më i Larti, ishte Çlirimtari i tyre. <sup>36</sup>Por kjo ishte vetëm hipokrizi; gjithçka që thanë, ishte gënjeshtër. <sup>37</sup>Ata nuk morën anën e tij dhe nuk iu përmbajtën besëlidhjes së tij. <sup>38</sup>Megjithatë, Perëndia mbeti i mëshirshëm, nuk i shfarosi plotësisht, por ua fali fajin. Shpeshherë e frenonte zemërimin e tij, dhe nuk e linte që të shpërthente. <sup>39</sup>Ai e dinte se ata ishin qenie kalimtare, si flladi që fryn dhe nuk kthehet më. <sup>40</sup>Sa herë e kundërshtuan dhe e provokuan në shkretëtirë! <sup>41</sup>Herë pas here e vinin atë në provë dhe e fyenin atë, Perëndinë e shenjtë të Izraelit. <sup>42</sup>I harruan veprat e tij të mëdha, harruan si i çliroi nga armiqtë; <sup>43</sup>harruan veprat që kreu në Egjipt dhe mrekullitë që bëri në krahinën e Coanit. <sup>44</sup>Lumenjtë dhe përrenjtë i shndërroi në gjak, që askush prej egjiptianëve të mos pinte prej tyre. <sup>45</sup>U dërgoi dëmtuesit që i munduan dhe bretkosa që molepsën vendin e tyre. <sup>46</sup>Mbi të korrat e tyre lëshoi karkalecat, të lashtat e tyre i shkretuan ata. <sup>47</sup>Ai ua shkatërroi vreshtat me breshër dhe fiqtë e tyre i thau me ngricë. <sup>48</sup>Bagëtinë e tyre e goditi me breshër dhe kopetë e tyre i qëlloi me rrufe. <sup>49</sup>Lëshoi mbi ta zemërimin e tij, tërbimin e papërmbajtur dhe fatkeqësitë e tmerrshme, një mori të tërë engjëjsh shkatërrues. <sup>50</sup>Rrugën i hapi zemërimit të tij, dhe vdekjen nuk ua kurseu, të gjithë i lëshoi në prehrin e murtajes. <sup>51</sup>Në familjet egjiptiane, në pasardhësit e Hamit, çdo bir të parëlindur ai e vrau.

<sup>52</sup>Pastaj popullin e tij e nxori që andej si një kope dhensh që del nga vatha, dhe rrugën ia udhëhoqi nëpër shkretëtirë. <sup>53</sup>I udhëhoqi me siguri, e ata nuk kishin përse të frikësoheshin, se armiqtë e tyre i mbuloi deti. <sup>54</sup>I çoi në tokën e tij të premtuar, deri në malin që kishte pushtuar vetë. <sup>55</sup>Para tyre dëboi popujt e tjerë; tokën (e premtuar) ua ndau me short dhe ua dha për trashëgim. Në shtëpitë e kënanasve lejoi të banonin fiset e Izraelit.

<sup>56</sup>Por ata e provokuan gjithnjë më të Lartin, nuk u drejtuan sipas urdhërimeve të Perëndisë. <sup>57</sup>Dolën të pabesë dhe e tradhtuan, pikërisht ashtu si të parët e tyre, të pabesë si harku, të cilit i këputet korda.

<sup>58</sup>Zotin e provokuan me vendet e tyre të flijimit, ia ndezën zemërimin me shtatoret e tyre idhujtare.

<sup>59</sup>Perëndia i pa të gjitha këto dhe u zemërua; i la izraelitët në baltë. <sup>60</sup>Tendën, që kishte ngritur tek ata, banesën në Shilo, ai e braktisi. <sup>61</sup>I lejoi armiqtë të merrnin arkën e besëlidhjes, shenjën e pushtetit dhe të madhësisë së tij. <sup>62</sup>U zemërua aq shumë me popullin e tij, sa që ia dorëzoi atë shpatës së armiqve. <sup>63</sup>Të rinjtë i përpiu zjarri, vajzave nuk u këndohej më kënga e dasmës. <sup>64</sup>Priftërinjtë u vranë të gjithë me shpatë, e vejshat e tyre nuk i lejoi të vajtonin.

<sup>65</sup>Pastaj Zoti u zgjua si njeriu që ngrihet nga gjumi i thellë, si luftëtari që vjen në vete pas dehjes. <sup>66</sup>Ai i shpartalloi armiqtë e tij, i mbuloi me turp të pamasë. <sup>67</sup>I largoi pasardhësit e Josefit, nuk e zgjodhi fisin e Efraimit, <sup>68</sup>por zgjodhi fisin e Judës, si dhe malin e Cionit. <sup>69</sup>Atje ndërtoi Tempullin e tij, të lartë si qielli dhe të sigurt si toka, të cilën e kishte themeluar për të gjitha kohët.

<sup>70</sup>Zgjedhi Davidin për të besuarin e tij. E mori nga kullotat, <sup>71</sup>prej tëbanave të kopeve e thirri të vinte dhe e emëroi mbret të Izraelit, bari mbi popullin e Perëndisë. <sup>72</sup>Davidi u kujdes për ta me gjithë zemër dhe i udhëhoqi me duar të shkathta.

### **Nuk do të pushojë kurrë zemërimi i Perëndisë?**

**79** *Këngë e Asafit.*

O Perëndi, të huajt kanë depërtuar në tokën tënde; kanë çnderuar Tempullin tënd të shenjtë dhe Jerusalemin e kanë kthyer në gërmadhë. <sup>2</sup>Ata kanë vrrarë shërbëtorët e tu, të gjithë ata që të qëndruan besnikë, dhe ua lanë gjithkund larashëve dhe kafshëve të egra për ushqim. <sup>3</sup>Në tërë krahinën e Jerusalemit u derdh lumë gjaku i popullit tënd e askush nuk ishte atje për t'i varrosur të vdekurit. <sup>4</sup>Popujt fqinjë na mbytën me tallje të hidhura; u tallën me ne dhe na përqeshën. <sup>5</sup>Edhe sa kohë do të vazhdosh kështu, o Zot? Do të jesh i zemëruar me ne përgjithmonë? Deri kur zemërimi do të të vlojë porsì zjarri? <sup>6</sup>Derdhe zemërimin tënd mbi të huajt, mbi popujt që nuk të njohin, mbi mbretëritë ku nuk nderohesh. <sup>7</sup>Sepse ata e shkatërruan Izraelin dhe e shkretuan tokën e tij të premtuar. <sup>8</sup>Mos na i llogarit neve padrejtësitë që bënë të parët tanë! Eja sa më shpejt me mëshirën tënde, sepse jemi të humbur, po mbarojmë. <sup>9</sup>O Perëndi, Shpëtimtari ynë, eja na ndihmo; nderi yt është vënë në rrezik! Na çliro, na i fal mëkatet, nderoje përsëri emrin tënd! <sup>10</sup>Përse ua lejon popujve të thonë: 'Ku është futur Perëndia jote?' Para syve tanë bëj që kombet ta njohin hakmarrjen për gjakun e derdhur të shërbëtorëve të tu! <sup>11</sup>Le të vijë tek ti rënkimi i robërve! Fuqia jote është aq e madhe, prandaj ruaje jetën e të dënuarve me vdekje! <sup>12</sup>Fqinjët tanë u tallën me ty, o Zot; bëj që t'i paguajnë shtatë fish talljet e tyre! <sup>13</sup>Por ne, populli yt, për të cilin kujdesesh si bariu për kopenë e tij, ne do të të falënderojmë në çdo kohë dhe do ta përhapim famën tënde brez pas brezi!

### **Na dëgjo, o bariu i Izraelit!**

**80** *Këngë e Asafit, një kredo, e kën duar sipas melodisë 'Zambakët'.*

<sup>2</sup>Na dëgjo, o bariu i Izraelit, ti që udhëhoqe pasardhësit e Josefite si kope! Ti që rri ulur në fron përmbi engjëjt rojtarë, tregoje veten në shkëlqimin tënd të ndritshëm! <sup>3</sup>Tregoje fuqinë tënde të madhe para syve të fiseve të tua, para Efraimit, Benjamine dhe Mënasheut! Eja të na ndihmosh! <sup>4</sup>O Perëndi, na rimëkëmb! Na vështro mirë, atëherë do të shpëtojmë! <sup>5</sup>O Perëndi, Zoti i mbarë botës, edhe sa kohë do të vlosh nga zemërimi, kur të të lutet populli yt? <sup>6</sup>Ti na ke dhënë të hanim hidhërim dhe të pinim lotët që rrjedhin si lumë. <sup>7</sup>Për fqinjët ti na bëre mollë sherri; armiqët tanë tallen me ne. <sup>8</sup>O Perëndi, Zoti i mbarë botës, na rimëkëmb! Na prano përsëri, atëherë ne do të shpëtojmë! <sup>9</sup>Ti shkule një hardhi nga Egjipti, popujt i përzure për të mbjellë atë <sup>10</sup>dhe vendin e pastrove përpara saj. Ajo lëshoi rrënjë të shumta dhe zuri tërë tokën (e premtuar). <sup>11</sup>Me hijen e saj mbuloi malet, me degët e saj cedrat e fuqishme, <sup>12</sup>shermendet kacavarëse i zgjati deri në det, filizat i lëshoi deri në Eufrat. <sup>13</sup>Përse e rrëzove gardhin e saj? Tani e plaçkit çdo kalimtar, <sup>14</sup>derri i egër nga pylli e shkretot, dhe kafshët e stepës kullosin atje. <sup>15</sup>Eja përsëri te ne, o Perëndi, o Zoti i mbarë botës! Që lart nga qielli shiko se ç'po na ndodh, ndërhyr përsëri për këtë hardhi! <sup>16</sup>Mbroje atë që vetë e mbolle – birin që ti e bëre të rritej. <sup>17</sup>Bëj që ata që e dogjën dhe e rrafshuan, të zhduken nga kërcënimet e tua! <sup>18</sup>Që dora jote të qëndrojë mbi mbretin që rri në të djathtë tënde, mbi këtë njeri që ti vetë e rrite. <sup>19</sup>Atëherë nuk do të largohemi më nga ti; ti do të na e rikthesh jetën dhe ty do të të adhurojmë. <sup>20</sup>O Zot, Perëndi i mbarë botës, na prano përsëri! Atëherë ne do të shpëtojmë!

### **Ah, sikur të më dëgjonte populli im!**

**81** *Këngë e Asafit, që shoqërohet me instrument gatas.*

<sup>2</sup>Brohoritni për Perëndinë, mbrojtësin tonë të fuqishëm. Këndoni nga gëzimi për Perëndinë e Jakovit!

<sup>3</sup>Bjerini harpës, bjerini dajres, bjeruni telave të lirës dhe të lahutës!

<sup>4</sup>Bjerini bririt për hënën e re, përsëri bjerini për hënën e plotë, për ditën e festës sonë! <sup>5</sup>Sepse është urdhri për Izraelin, kështu ka urdhëruar Perëndia e Jakovit. <sup>6</sup>Këtë urdhër ia dha popullit të Izraelit, kur luftonte kundër egjiptianëve.

Po dëgjoj fjalët që kurrë nuk i kisha dëgjuar më parë. <sup>7</sup>«Ta hoqa barrën nga supet; dhe shportën e rëndë nga duart. <sup>8</sup>Kur halli i madh të kishte zënë, mua më thirre dhe të çlirova. Përgjigje të dhashë nga mesi i resë së stuhisë ku fshihesha. Në provë të vura te burimi i Merivës. <sup>9</sup>O populli im, më dëgjo, duhet të të paralajmëroj!

Ah, sikur të më dëgjoje mua, o Izrael! <sup>10</sup>Tek ti nuk ka vend për perëndi tjetër, mos u përkul para perëndisë

së huaj! <sup>11</sup>Zoti jam, Perëndia jote. Unë të nxora nga Egjipti. Hape gojën plotësisht dhe unë do ta mbush!

<sup>12</sup>Por populli im nuk më dëgjoi; Izraeli nuk donte t'ia dinte më për mua. <sup>13</sup>Prandaj ia dorëzova kokëfortësisë së tij, që të shkonte sipas kokës.

<sup>14</sup>Ah, sikur të më dëgjonte populli im! Sikur Izraeli të zbatonte urdhërimet e mia! <sup>15</sup>Sa shpejt do t'i mundja armiqtë e tij dhe shtypësit e tij do t'i mposhtja.»

<sup>16</sup>Të gjithë ata që e urrejnë Zotin, do t'ia puthnin pëqirin, dhe koha e tyre do të mbaronte përgjithmonë.

<sup>17</sup>Izraelin do ta ushqente me drithin më të mirë, dhe do ta ngopte me mjaltë malësie.

### Gjyqtarët do të dalin në gjyq

**82** *Këngë e Asafit.*

Perëndia ngrihet në mbledhjen e gjyqtarëve, në mesin e 'perëndive' shpall vendimin e tij:

<sup>2</sup>Edhe sa kohë do ta shtrembëroni drejtësinë e do të merrni anën e fajtorëve? <sup>3</sup>Mbrojini të varfrit dhe jetimët, kërkoni të drejtën e të pambrojturve! <sup>4</sup>Lirojini të shtypurit dhe të dobët, rrëmbejini nga kthetrat e shtypësve!

<sup>5</sup>Por ju nuk merrni vesh, nuk kuptoni gjë! Pa ndihmë jeni në terr, dhe themelet e botës po lëkundën.

<sup>6</sup>Vërtet ju thashë: «Ju jeni perëndi, ju bijtë e mi, bijtë e më të Lartit!»

<sup>7</sup>Por ju do të vdisni si njerëzit e tjerë, si ministrat e paaftë, do të shkarkoheni nga pozitat!»

<sup>8</sup>Ndërhyr, o Perëndi, sundoju kombet; sepse ty të takojnë të gjitha kombet!

### Lutja në rrezik lufte

**83** *Këngë e Asafit.*

<sup>2</sup>O Perëndi, mos hesht më! Mos qëndro më duarkryq. <sup>3</sup>Shikoj sa janë tërbuar armiqtë e tu, sa mendjemdhënjanë janë, të gjithë ata që të urrejnë. <sup>4</sup>Ata komplotuan kundër nesh. Të pabesët hartojnë plane kundër popullit tonë, që u vu nën mbrojtjen tënde. <sup>5</sup>«Ngrihuni, – thanë, – do të shfarosim Izraelin! Ky popull duhet të zhduket, dhe emri i tij duhet harruar!» <sup>6</sup>Ata këshillohen për të lidhur marrëveshje kundër teje dhe së shpejti do të jenë një me mish e me shpirt; <sup>7</sup>populli edomas, jishmaelasit, ata nga Moavi edhe hagarasit; <sup>8</sup>ata nga Gevali, Amoni dhe nga Amaleku; filistenjtë dhe banorët e Tirit, <sup>9</sup>edhe asirianët vijnë duke u sjellë përforcime pasardhësve të Lotit.

<sup>10</sup>O Perëndi, goditi siç godite midjanasit, si Siserën dhe Javinin pranë përroit Kishon. <sup>11</sup>Ata u asgjësuan në EinDor dhe mbetën të shtrirë në fushë si pleh. <sup>12</sup>Trajtoji kryetarët e tyre siç trajtove Orevin dhe Zëevin, udhëheqësit e tyre, si Zevahun dhe Calmunën, <sup>13</sup>të gjithë ata që vendosën: «Do të pushtojmë tokën e Perëndisë!»

<sup>14</sup>Ti, o Perëndia ime, bëj që të ikin si era, si gjëmbaçë të thatë, si kashta në erë! <sup>15</sup>Bëhu si zjarri që e përpin pyllin, si flaka që ndez malet! <sup>16</sup>Dëboji me stuhinë tënde, futi në panik me tufanin tënd! <sup>17</sup>Turpëroji, që të fillojnë të të kërkojnë, o Zot! <sup>18</sup>T'i kapë përgjithmonë turpi e tmerri, dhe të mbarojnë të mbuluar me turp! <sup>19</sup>Që ta pranojnë se ti je Zot, se ti je më i Larti në mbarë botën!

### Këngë e pelegrinëve që arrijnë në Jerusalem

**84** *Këngë nga përmbledhja e kole gjiumit të Korahut, që shoqërohet me vegël gatase.*

<sup>2</sup>O Zoti i gjithësisë, sa e dua shtëpinë tënde! <sup>3</sup>Po vdes nga padurimi duke pritur që të hyj në oborret e Tempullit tënd. Me mish e me shpirt po të thërras, o Perëndi që vepron! <sup>4</sup>Edhe trumcaku gjen një çerdhe, edhe dallëndyshja një fole ku mund t'i pjellë të vegjlit, pranë altareve të tua, o Zoti i gjithësisë, o mbreti im dhe Perëndia ime! <sup>5</sup>Sa të lumtur janë ata që banojnë në ty, që mund të të lavdërojnë pa pushim! <sup>6</sup>Sa të lumtur janë ata që gjejnë strehim tek ti, që kanë në zemër këtë pelegrinazh! <sup>7</sup>Kur kalojnë nëpër luginën (e shkretë) të balsamit, Perëndia e shndërron atë në oazë, duke hedhur atje shiun e freskët si bekim të parë. <sup>8</sup>Ata marrin forca dhe ecin më tej për t'u paraqitur para Perëndisë në Cion.

<sup>9</sup>O Zot, o Perëndia e gjithësisë, dëgjoje lutjen time, dëgjo, o Perëndia e Jakovit. <sup>10</sup>O Perëndi, shikoj mbretin, mburojën tonë, prite mirë atë që ti e kushtove. <sup>11</sup>Po, vetëm një ditë në oborret e Tempullit tënd ua kalon mijëra të tjerave të kaluara gjetkë. Më mirë të rri në prag të shtëpisë sate, o Perëndi, sesa të jetoj mes njerëzve që nuk kanë as besë, as fe!

<sup>12</sup>Ja titujt e Zotit: Dielli dhe Mburoja; gjëja që e dallon Perëndinë është dashamirësia dhe madhështia. Me kënaqësi Zoti i jep lumturi atij që bën jetë të panjollësor. <sup>13</sup>O Zoti i gjithësisë, lum ai që beson në ty!

### Paqe për popullin e Perëndisë

**85** *Këngë nga përmbledhja e kolegjiumit të Korahut.*

<sup>2</sup>O Zot, ti e tregove mëshirën tënde ndaj tokës që të takon; ti e ndryshove fatin e pasardhësve të Jakovit. <sup>3</sup>Ti dëshmove në favor të popullit tënd, i fale të gjitha mëkatet tona. <sup>4</sup>Ti e përmbajte zemërimin tënd, hoqe dorë nga shpërthimi i inatit tënd kundër nesh.

<sup>5</sup>O Perëndi, shpëtimtari ynë, na rimëkëmb. Mos u zemëro më me ne! <sup>6</sup>A do të mbash gjithnjë inat kundër nesh? A do të vazhdojë zemërimi yt brez pas brezi? <sup>7</sup>A nuk do të na kthesh në jetë, ne që jemi populli yt, që të gjejmë përsëri lumturi tek ti? <sup>8</sup>O Zot, bëj që të shohim mirësinë tënde, jepna ndihmën tënde.

<sup>9</sup>Dëshiroj të dëgjoj atë që më thotë Perëndia: Zoti flet për paqen për popullin e tij, për besnikët e tij, për ata që do t'i besojnë përsëri. <sup>10</sup>Po, ndihma e tij na pret menjëherë. Madhështia e tij do të banojë së shpejti në tokën tonë (të premtuar). <sup>11</sup>Atëherë do të bashkohen mirësia dhe besnikëria, drejtësia dhe paqja do të përqafohen. <sup>12</sup>Besnikëria do të burojë nga toka, kurse drejtësia do të zbresë nga qielli. <sup>13</sup>Vetë Zoti do të na japë sukses, dhe toka jonë do të japë prodhimet e saj. <sup>14</sup>Drejtësia do t'i shkojë (Zotit) përpara dhe do t'i përgatitë rrugën atij.

### Thirrje për ndihmë në vështirësi të madhe

**86** *Lutje e Davidit.*

<sup>1</sup>O Zot, jam i varfër dhe i pambrojtur; më dëgjo dhe më jep përgjigje! <sup>2</sup>Ruajma jetën, sepse ty të takoj! Më ndihmo, sepse jam shërbëtori yt. O Perëndia ime, mbështetem në ty! <sup>3</sup>Gjithë ditën po të thërras; ki mëshirë për mua, o Zot. <sup>4</sup>Po të drejtohem ty, po të lutem të më mbushësh përsëri me gëzimin tënd. <sup>5</sup>O Zot, ti je i mirë dhe i gatshëm t'i falësh mëkatet; ti je shpirtmadh ndaj të gjithë atyre që të thërrasin për ndihmë. <sup>6</sup>Prandaj dëgjoje tani lutjen time; o Zot, kushtoji vëmendje thirrjes sime për ndihmë. <sup>7</sup>Në vështirësinë time po të thërras për ndihmë; e di që ti do të më japësh përgjigje.

<sup>8</sup>O Zot, cili prej engjëjve është si ti? Askush tjetër nuk mund t'i kryejë veprat e tua. <sup>9</sup>Ti i krijove të gjitha kombet. Ato do të vijnë të bien përmbys para teje për të të bërë nderimet e tyre. <sup>10</sup>Sepse ti je i madh dhe kryen mrekulli; ti je i vetmi Perëndi i vërtetë!

<sup>11</sup>O Zot, tregomë rrugën e drejtë, që gjatë jetës sime të të qëndroj besnik! Shqetësimi im i vetëm qoftë gjithmonë nderimi yt dhe dëgjesa ndaj teje. <sup>12</sup>O Zot, Perëndia ime, me gjithë zemër do të të falënderoj dhe do ta bëj të njohur në çdo kohë namin tënd; <sup>13</sup>sepse ti ke qenë shumë i mirë ndaj meje: ti shpëtove jetën time nga bota e të vdekurve.

<sup>14</sup>O Perëndi, njerëz të pafytyrë më sulmojnë, një turmë të egrish kërkon të më vrasë, të gjithë ata nuk duan t'ia dinë për ty. <sup>15</sup>Por ti, o Zot, je Perëndi plot dashuri dhe mëshirë, ti ke shumë durim; mirësia dhe besnikëria jote janë të pakufishme. <sup>16</sup>Prandaj të drejtohem ty, ki mëshirë për mua! Më jep fuqinë dhe ndihmën tënde! Ty të takoj me mish e me shpirt! <sup>17</sup>Më trego se ti më do të mirën! Të gjithë ata që më urrejnë, do të turpërohen, kur të shohin se si më ndihmon dhe më ngushëllon ti.

### E drejta e banimit në Cion

**87** *Këngë nga përmbledhja e kolegjiumit të Korahut.*

Zoti e ka ndërtuar qytetin e tij. Themel është mali i tij i shenjtë. <sup>2</sup>E do qytetin e Cionit, me portat e tij të bukura më shumë se të gjitha vendet e tjera ku banojnë pasardhësit e Jakovit. <sup>3</sup>Ajo që thotë Ai për ty, o qytet i Perëndisë, e rrit famën tënde.

<sup>4</sup>«Egjiptin dhe Babiloninë i numëroj ndër ata që më njohin dhe më nderojnë; edhe toka e filistenjve është njëra prej tyre, gjithashtu edhe Tiri me Etiopinë, për të cilat mund të thuhet: ky dhe ai atje janë të shtëpisë. <sup>5</sup>Por për ty, o Cion, do të thuhet: 'Secili të ka për atdhe, sepse të ka ndërtuar Perëndia, më i Larti.'»

<sup>6</sup>Zoti harton një listë me njerëzit e të gjitha kombeve, dhe pas çdo emri shkruan: «Ky gëzon të drejtën e banimit në Cion». <sup>7</sup>Të gjithë vallëzojnë nga gëzimi: «O Cion, tek ti ne jemi në atdhe.»

### Lutje në braktisje dhe në rrezik vdekjeje

**88** *Poemë e esrahasit Heman, prej përmbledhjes së kolegjiumit të Korahut, që këndohet në mënyrë melankolike.*

<sup>2</sup>O Zot, o Perëndia ime, vetëm ti mund të më shpëtosh! Ditë e natë të thërras. <sup>3</sup>Lutja ime të vijë tek ti, dëgjoje thirrjen time për ndihmë!

<sup>4</sup>Mjaft kam vuajtur, dhe tani jam në prag të vdekjes. <sup>5</sup>Të gjithë mendojnë se kam marrë fund; forcat e mia po shterojnë, nuk mundem më. <sup>6</sup>Më kanë lënë si një të vdekur; më ndodh si me një të mbytur që e kanë hedhur në një varr të përbashkët – nuk kujdesesh më për ta, ndihma jote nuk i arrin më. <sup>7</sup>Ti më ke hedhur në greminën më të thellë, ku më mbulon errësira e përjetshme e vdekjes. <sup>8</sup>Zemërimi yt më shtyp përtokë, me valë të forta kapërcen mbi mua. <sup>9</sup>Miqtë e mi m'i ke bërë të huaj; ata largojnë sytë plot neveri prej meje. Më ka rrethuar mjerimi dhe nuk gjej rrugëdalje. <sup>10</sup>Sytë e mi janë të rraskapitur nga pikëllimi. Dita ditës të thërras për ndihmë, o Zot, dhe zgjas drejt teje duart! <sup>11</sup>A bën ti ende mrekulli tek të vdekurit? Mos do të ngrihen hijet për të të lavdëruar? <sup>12</sup>A tregohet në varr për mirësinë tënde, në botën e të vdekurve për besnikërinë tënde? <sup>13</sup>A dihet në errësirë, çfarë veprash ke kryer? A flet ndonjëri prej të harruarve për plotësimin e premtimeve të tua? <sup>14</sup>Por unë po të thërras për ndihmë, o Zot; çdo mëngjes të mbym me pyetje. <sup>15</sup>O Zot, përse më ke dëbuar? Përse fshihesh prej meje?

<sup>16</sup>Që nga fëmijëria ime, kam qenë i mjerë dhe në kthetrat e vdekjes. Ti më tmerron gjithmonë me fatkeqësi të reja, kështu që për pak do të dyshoj për ty. <sup>17</sup>Si zjarr më arrin zemërimi yt, sulmet e tua të tmerrshme më kanë dërrmuar. <sup>18</sup>Ato më kërcënojnë nga të gjitha anët, arrijnë tek unë si valë vdekjeprurëse. <sup>19</sup>Miqtë dhe fqinjët m'i ke bërë të huaj; errësira është shoqëruesi im i vetëm.

## Ç'u bë me premtimet e dhëna Davidit?

**89** *Poemë e esrahasit Etan.*

<sup>2</sup>O Zot, gjithnjë do të këndoje për dëshmitë e mirësisë sate. Kënga ime do ta shpallë besnikërinë tënde për të gjithë brezat e ardhshëm. <sup>3</sup>«Mirësia jote nuk mbaron kurrë – them. – Besa jote qëndron e patundshme si qielli.»

<sup>4</sup>Ti the: «Kam zgjedhur një njeri, dhe kam lidhur besë me të; Davidit, të besuarit tim, iu përbetova:

<sup>5</sup>Gjithnjë do të jetë mbret një nga pasardhësit e tu; dinastinë tënde do ta ruaj përgjithmonë.»

<sup>6</sup>O Zot, qielli mburret për mrekullitë e tua, turma e engjëjve lavdëron besnikërinë tënde, <sup>7</sup>sepse askush atje lart nuk është si ti, asnjë nga engjëjt nuk mund të krahasohet me ty. <sup>8</sup>O Perëndi, frikën ti ngjall në këshillin qiellor; të gjithë ata që të rrethojnë, janë të mbushur me respekt të thellë për ty. <sup>9</sup>O Perëndi, Zoti i gjithësisë, kush është aq i fuqishëm sa ti, kush e mban besën si ti?

<sup>10</sup>Ti zbut detin rebel. Kur tërbohen dallgët e tij, ti i qetëson ato përsëri. <sup>11</sup>Ti e vrave kuçedrën detare dhe e shtype me dorën tënde të fortë, i shpërndave armiqtë e tu. <sup>12</sup>Ty të takon qielli, ty të takon toka, teriku me gjithçka që banon në të, sepse ti i krijove. <sup>13</sup>Ti krijove veriuin dhe jugun; malet Tavor dhe Hermon të brohorasin ty. <sup>14</sup>Vetëm ti e ke krahun e fortë, dorën e djathtë fitimtare të ngritur! <sup>15</sup>Në drejtësi dhe në pakorruptueshmëri rri froni yt; mirësia dhe besnikëria të prijnë.

<sup>16</sup>Sa i lumtur është populli që të përshëndet me brohoritje! Ai jeton në praninë tënde fitimtare. <sup>17</sup>Gëzohet çdo ditë, sepse ti je Perëndia e tij. Ti e mban atë që i ke premtuar; kështu e mban atë në jetë. <sup>18</sup>I jep atij fuqinë tënde të mrekullueshme. Meqë ti na do, jemi të fortë. <sup>19</sup>Ty, o Zot, të takon mbrojtësi ynë; mbreti ynë sundon në emrin tënd, o Perëndia e shenjtë e Izraelit.

<sup>20</sup>Dikur u fole shërbëtorëve të tu besnikë; në një vegim u the: «Kam zgjedhur një të ri prej popullit, ia premtova një heroi ndihmën time. <sup>21</sup>Kam gjetur Davidin, të besuarin tim, dhe e shugurova mbret me vaj të shenjtë. <sup>22</sup>Do ta mbaj me dorën time, do ta forcoj me fuqinë time. <sup>23</sup>Asnjë armik nuk do ta hedhë kurrë poshtë, asnjë kryengritës nuk do ta mposhtë. <sup>24</sup>Para syve të tij do t'i asgjësoj kundërshtarët e tij dhe do t'i rrëzoj përtokë të gjithë ata që e urrejnë. <sup>25</sup>Besnikëria dhe mirësia ime do të jenë për të të sigurtat. Meqë jam në anën e tij, do të shtohet pushteti i tij. <sup>26</sup>Do t'i jap pushtet mbi detin dhe do t'i nënshtroj lumenjtë e mëdhenj. <sup>27</sup>Ai do të më thotë: «Ti je ati im, je Perëndia ime, mbrojtësi im i fortë!» <sup>28</sup>Do ta bëjë të parëlindurin tim, më të lartin ndër mbretërit e tokës. <sup>29</sup>Në çdo kohë e rrethon mirësia ime, besëlidhja ime me të është e pathyeshme. <sup>30</sup>Pasardhës të vazhdueshëm atij do t'i jap, dinastia e tij do të jetojë sa qielli. <sup>31</sup>Në qoftë se pasardhësit e tij nuk i dëgjojnë urdhrat e mi, heqin dorë nga Ligji im dhe <sup>32</sup>në qoftë se shkelin urdhërimet e mia dhe nuk i dëgjojnë rregullat, <sup>33</sup>atëherë do ta dënoj rëndë mosbindjen e tyre, dhe do t'i godas për mëkatet e tyre. <sup>34</sup>Por dashamirësinë time nuk do t'ia heq (Davidit); unë do t'ia mbaj besën. <sup>35</sup>Besëlidhja ime me të nuk do të shkelet, premtimet e mia nuk do të ndryshohen. <sup>36</sup>Një herë e përgjithmonë u përbetova dhe e garantova me shenjtërinë time: kurrë nuk do ta gënjej Davidin! <sup>37</sup>Dinastia e tij do të qëndrojë përgjithmonë; fronin e tij do ta kem gjithnjë parasysh, derisa të qëndrojë dielli, <sup>38</sup>përgjithmonë do të qëndrojë si hëna, ky dëshmitar besnik në re.»

<sup>39</sup>E megjithatë, lejove që të binte dhe e dëbove! U zemërove me mbretin që vetë e emërove. <sup>40</sup>Besëlidhjen me shërbëtorin tënd e hoqe, kurorën e tij e hodhe në baltë dhe e turpërove. <sup>41</sup>Muret e qytetit të tij i theve dhe kështjellat e tij i shkatërrove. <sup>42</sup>Të gjithë kalimtarët e plaçkitën. Fqinjët e tij tallen me të. <sup>43</sup>U dhe fitore kundërshtarëve të tij dhe të gjithë armiqtë e tij i mbushe me gëzim. <sup>44</sup>Shpatën e tij të mprehtë e le të topitej, dhe në luftë nuk e ndihmove. <sup>45</sup>I dhe fund pushtetit të tij mbretëror dhe fronin e tij e rrëzove përtokë. <sup>46</sup>Ti e bëre të plakej para kohe dhe e mbyte me turp e me faqe të zezë. <sup>47</sup>Edhe për sa kohë akoma, o Zot? A do të fshihesh përgjithmonë? Edhe sa kohë do të djegë zemërimi yt? <sup>48</sup>Mendo përsëri për mua; sa e shkurtër është jeta ime! Ti na krijove ne njerëzit për të jetuar për shumë pak kohë! <sup>49</sup>A ka mundësi që dikush të jetojë pa e gjetur vdekjen, që ndonjëri t'u shpëtojë kthetrave të botës së të vdekurve? <sup>50</sup>O Zot, ku janë dëshmitë e mëparshme për mirësinë tënde? Ia premtove Davidit dhe ia garantove me besën tënde!

<sup>51</sup>Mendo se si i shajnë shërbëtorët e tu! Detyrohem të duroj përqeshjen e shumë popujve.

<sup>52</sup>O Zot, armiqtë e tu tallen me mbretin që vetë e emërove; e vënë në lojë në çdo hap. <sup>53</sup>U lavdëroftë Zoti përgjithmonë! Amen, ashtu qoftë!

## LIBRI I KATËRT

### Perëndia është i përjetshëm – njeriu i vdekshëm

*Lutje e Moisiut, njeriut të Perëndisë.*

**90** O Zot, ti ke qenë mbrojtja jonë brez pas brezi. <sup>2</sup>Ti, o Perëndi, ekzistojë para se të lindnin malet, para se bota të lindte, e ti qëndron në përjetësi. <sup>3</sup>Ti i thua njeriut: «Bëhu përsëri pluhur!» Kështu e kthen atje ku ishte më parë. <sup>4</sup>Për ty një mijë vjet janë si një ditë, si dje – të kaluara në çast, të shkurtra sa një orë gjumë. <sup>5</sup>Njerëzit i dëbon; ata zhduken si ëndërr herët në mëngjes. Ata janë si bari; <sup>6</sup>në mëngjes lulëzon dhe rritet, kurse në mbrëmje është tharë.

<sup>7</sup>Meqë zemërohesh dhe na kundërshton, jemi të humbur dhe duhet të zhdukemi. <sup>8</sup>Sepse ti shikon gabimin më të vogël; ti i zbulon të gjitha mëkatet tona. <sup>9</sup>Zemërimi yt peshon rëndë mbi jetën tonë, prandaj ajo

është kalimtare si psherëtimë. <sup>10</sup>Ndoshta jetojmë shtatëdhjetë vjet, ndoshta edhe tetëdhjetë – por edhe vitet më të mira janë mundim dhe barrë! Sa shpejt kalon gjithçka, e ne nuk jemi më!

<sup>11</sup>Por kush kupton sa i tmerrshëm është zemërimi yt, e kush e merr atë për zemër? <sup>12</sup>Ta pranojmë sa e shkurtër është jeta jonë, që të vijmë në vetë!

<sup>13</sup>O Zot, edhe sa kohë do të zemërohesh me ne? Ki mëshirë për ne dhe kthehu te ne! <sup>14</sup>Ta ndiejmë çdo mëngjes që ti na mban në dorë, atëherë ditët tona do të mbushen me ngazëllim dhe falënderim. <sup>15</sup>Për shumë vjet bëre të binin mbi ne halle dhe fatkeqësi; na jep tani po aq vjet me gëzim! <sup>16</sup>Të përjetojmë se si ndërhy, fëmijët tanë t'i shohin veprat e tua të mëdha! <sup>17</sup>O Zot, Perëndia jonë, bëhu i mirë me ne! Puna jonë të mos jetë e kotë! Po, o Zot, ndihmona që të na dalë mbarë ajo që bëjmë!

### Nën mbrojtjen e Perëndisë

**91** Kush jeton nën mbrojtjen e Perëndisë më të lartë dhe mund të banojë tek ai që ka gjithëpushtet, <sup>2</sup>mund t'i thotë Zotit: «Ti je strehimi im, tek ti jam i sigurt si në një kështjellë. O Perëndia ime, besoj në ty!»

<sup>3</sup>Mund të jesh i sigurt: Zoti do të të shpëtojë nga kurthet që të ngre njeriu nga tradhtia dhe nga shpifja. <sup>4</sup>Ai i hap flatrat mbi ty, ti je i sigurt pranë tij. Si mburojë dhe mur mbrojtës të mbron besnikëria e tij. <sup>5</sup>Nuk ke përse të frikësohesh: as nga rreziqet dhe tmerrri natën, as nga sulmet ditën, <sup>6</sup>as nga murtaja që bie në terr, as nga epidemia që bën kërdinë në mesditë. <sup>7</sup>Edhe në qoftë se pranë teje vdesin me mijëra dhe rreth teje bien me dhjetra mijëra njerëz, ty nuk do të gjejë gjë. <sup>8</sup>Me sytë e tu do ta shohësh se si Perëndia i dënon të gjithë ata që e përbuzin, ata që nuk e përfillin. <sup>9</sup>Ti do të thuash: «Zoti është strehimi im.» Po, ti e gjete mbrojtjen te Perëndia më i lartë. <sup>10</sup>Prandaj asgjë e keqe nuk do të të ndodhë, asnjë fatkeqësi nuk do ta kërcënojë shtëpinë tënde. <sup>11</sup>Perëndia u dha urdhër engjëjve të vet, që të të mbrojnë, kudo që të shkosh. <sup>12</sup>Ata do të të mbajnë për dore, që të mos pengohesh në ndonjë gur. <sup>13</sup>As luanët e as gjarpërinjtë nuk do të të bëjnë dëm; ti do t'i shkelësh të gjithë me këmbë.

<sup>14</sup>Vetë Perëndia ka thënë: «Ai më qëndron besnik, prandaj do ta ruaj. Meqë më njeh e më nderon, do ta çoj në vend të sigurt. <sup>15</sup>Kur të më thërrasë për ndihmë, do ta dëgjoj. Kur të jetë në rrezik, do t'i jem pranë; do ta nxjerr nga e keqja e do t'ia vë nderin në vend. <sup>16</sup>Do t'i jap jetë të gjatë dhe të mbarë; ai do ta përjetojë ndihmën që priste.»

### Falënderimi i Zotit sjell gëzim

**92** *Këngë për ditën e adhurimit.*

<sup>2</sup>O Zot, gëzohem të të falënderoj ty, të lavdëroj më të Lartin me këngë; <sup>3</sup>herët në mëngjes lavdëroj mirësinë tënde dhe natën bëj të njohur besnikërinë tënde, <sup>4</sup>me tingëllimin e harpës me dhjetë tela, me muzikën e lahutës dhe të lirës.

<sup>5</sup>Ajo që bëre ti, o Zot, më sjell gëzim; ndërhyrja jote më bën të brohoras. <sup>6</sup>O Zot, sa të fuqishme janë veprat e tua! <sup>7</sup>Kush nuk ka mendjemprehtësi morale, nuk i dallon. Kush nuk do t'ia dijë për to, nuk do të kuptojë asgjë. <sup>8</sup>Njerëzit që nuk i përfillin urdhërimet e tua, mund të mbijnë si bari, keqbërësit mund të lulëzojnë e të jenë të suksesshëm – në fund do të shfarosen! <sup>9</sup>Ti, o Zot, që je lart mbi të gjithë, ti qëndron përgjithmonë. <sup>10</sup>Por armiqtë e tu, o Zot, armiqtë e tu do të mbarojnë; do të dëbohen, ata keqbërësit!

<sup>11</sup>Ti më dhe forcën e demit të egër dhe më ngarkove me nder e gëzim. <sup>12</sup>Shoh rënien e armiqve të mi, dëgjoj vajtimin e kundërshtarëve që mendonin të më sulmonin.

<sup>13</sup>Kush i qëndron besnik Perëndisë, rritet si palma me blerim të përhershëm dhe bëhet i madh si cedrat e forta të Libanit. <sup>14</sup>Besniku rritet pranë Zotit, Perëndisë sonë, si pema që rri në oborrin e Tempullit. <sup>15</sup>Edhe në moshë të thyer jep fryte, mbetet gjithnjë plot me lëng dhe forcë. <sup>16</sup>Jeta e tij dëshmon se Zoti vepron drejt, atij ia kam besën, tek ai nuk ka padrejtësi!

### Zoti i mbarë botës

**93** Zoti është mbret! Madhështia e mbështjell si mantel; fuqia e rrethon si brez.

<sup>2</sup>Toka ka themel të fortë, nuk shembet. <sup>3</sup>O Zot, froni yt qëndron prej përjetësisë, ti je para çdo krijimi. <sup>4</sup>Deti tërbonte, tërbonte dhe shungullonte me ulërimë – dhe vazhdimisht donte të tërbonte, deti! <sup>5</sup>E madhe është ulërima e detit, edhe më të mëdha janë dallgët e tij, por më i madhi dhe më i forti je ti, o Zoti i qiellit!

<sup>6</sup>Urdhërimet e tua meritojnë besim të plotë dhe Tempullin tënd duhet ta përfillë çdokush, ta pranojë atë përgjithmonë si vendin e shenjtë, o Zot.

### Gjyqtari i mbarë botës

**94** Ty të takon hakmarrja! Eja në fund, o Zot, shfaqu! <sup>2</sup>Ndërhyr, ti gjyqtar i mbarë botës, jepu njerëzve të pafytyrë atë që meritojnë!

<sup>3</sup>Edhe sa kohë do të triumfojnë të gjithë ata që të përbuzin? Edhe sa kohë, o Zot? <sup>4</sup>Flasin e flasin, këta keqbërës, ata janë mburraveçë të pafytyrë dhe mendjemëdhenj. <sup>5</sup>O Zot, popullin tënd e shtypin, njerëzit që të takojnë ty i shkelin! <sup>6</sup>Pa ngurrim i vrasin vejushat dhe jetimët, si dhe të huajt, mysafirët në

tokën tënde. <sup>7</sup>«Zoti nuk sheh asgjë – thonë. – Perëndia e Izraelit nuk kujdeset për këtë!»

<sup>8</sup>A ka më të marrë se ju? Kur do të mendoni pak, ju budallenj! <sup>9</sup>Ai që u dha njerëzve veshët, a nuk do të mund të dëgjojë? Ai që u krijoi atyre sytë, a nuk do të mund të shohë vetë? <sup>10</sup>Ai që i disiplinon kombet, a nuk do t'ju dënojë edhe ju? Ai që u jep njerëzve diturinë, <sup>11</sup>ai, Zoti, i di të gjitha planet e tyre dhe i di se sa të kota dhe të paarsyeshme janë ato.

<sup>12</sup>Lum ai që e disiplinon ti, o Zot, të cilit i jep dituri nëpërmjet Ligjit tënd! <sup>13</sup>Kështu e mbron, që të mos bjerë në fatkeqësi, gjersa të hapet gropa për atë që përbuz Ligjin tënd. <sup>14</sup>Popullin tënd nuk e mohon, o Zot, nuk i lë në baltë të tutë. <sup>15</sup>Së shpejti gjyqtarët do të gjykojnë sipas drejtësisë, dhe të gjithë të drejtët do të gëzohen.

<sup>16</sup>Kush do të ndërhyjë për mua para keqbërësve? Kush do të më mbrojë nga njerëzit e këqij? <sup>17</sup>O Zot, po të mos më ndihmoje ti, unë do të kisha vdekur përgjithmonë prej kohësh. <sup>18</sup>Gjithnjë kur mendoja: «Tani po rrëzohem!», ti më mbështete me mirësinë tënde. <sup>19</sup>Kur hidhërohesh nga mijëra shqetësime, më ngushëllove dhe më ktheve gëzimin.

<sup>20</sup>A u lejohet gjyqtarëve të padrejtë të të thërrasin dhe në emër të drejtësisë sate të nxjerrin vendime të padrejta? <sup>21</sup>Ata bashkohen kundër çdo njeriu që dëshiron t'u përmbahet urdhërimeve të tua; atë e dënojnë me vdekje, megjithëse është i pafajshëm.

<sup>22</sup>Por ti, o Zot, Perëndia ime, ti je kështjella ime, vendi i sigurt ku mund të fshihem. <sup>23</sup>Ti ua shpague mëkatet dhe i asgjëson nëpërmjet së keqes së tyre. Po, o Zot, Perëndia jonë, zhduki!

### Asnjë adhurim pa dëgjese

**95** Ejani të këndojmë për nder të Zotit, ta përsëritim atë me brohoritje të gëzueshme; sepse ai është mbrojtësi ynë i fortë! <sup>2</sup>Të paraqitemi para tij me falënderimin tonë, ta nderojmë me këngët tona! <sup>3</sup>Sepse Zoti është Perëndia më i lartë, mbreti më i madh që sundon mbi të gjithë 'perënditë' e tjera. <sup>4</sup>Nën pushtetin e tij është thellësia e tokës, dhe atij i takojnë majat e maleve. <sup>5</sup>Deti i përket atij – ai e krijoi – edhe teriku, të cilin vetë e formoi. <sup>6</sup>Ejani, të përkulemi, të biem përmbys para tij, ta adhurojmë, atë, Zotin, Krijuesin tonë! <sup>7</sup>Sepse ai është Perëndia jonë, e ne jemi populli i tij, për të cilin ai kujdeset si bariu; na udhëheq si kope.

Sot vlen ta dëgjoni atë që ju thotë: <sup>8</sup>«Mos jini aq të pandreqshëm sa ç'ishin dikur të parët tuaj në Merivë ose në rastin e Masës në shkretëtirë! <sup>9</sup>Atje më provokuan, më vunë në provë, megjithëse i kishin parë veprat e mia. <sup>10</sup>Mbarë brezi ngjalli tek unë neveri për dyzet vjet! Në fund duhej ta vija re: «Gjithçka që dëshirojnë, është e mbrapshtë; kurrë nuk e kërkuan vullnetin tim.» <sup>11</sup>Prandaj në zemërimin tim u përbetova: «Ata nuk do të hyjnë kurrë në tokën (e premtuar), ku unë dëshiroja t'u jepja pushim!»

### Perëndia, mbreti i mbarë botës

**96** Këndojini Zotit një këngë të re! Këndojini Zotit, ju banorët e mbarë botës! <sup>2</sup>Këndoni për nder të Zotit, falënderojeni Perëndinë tuaj, tregoni ditë e natë se si ndihmon ai me dëshirë! <sup>3</sup>Tregojini mbarë njerëzimit madhësitinë e tij, njoftojini të gjitha kombet për veprat e tij të mëdha!

<sup>4</sup>Zoti është i fuqishëm, duhet lavdëruar; atij i duhet pasur frikë më shumë se të gjitha 'perëndive' të tjera. ♦ <sup>5</sup>Perënditë e kombeve janë vetëm idhuj të vdekur, por Zoti është ai që krijoi qiellin. <sup>6</sup>Atë e rrethon pushteti dhe madhështia; madhështia mbush Tempullin e tij.

<sup>7</sup>Ngrihuni ta takoni, ju o kombe! Nderojeni Zotin, nënshtrojeni pushtetit të tij! <sup>8</sup>Jepini atij nderin që i përket. Sillini dhuratat për t'i flijuar në Tempullin e tij! <sup>9</sup>Bini përmbys para Zotit, kur të paraqitet në shenjtëroren e tij! Mbarë bota të dridhet para tij.

<sup>10</sup>Thuajuni të gjithë njerëzve: «Zoti është mbret!» Toka ka themele të forta, nuk do të shembet. Zoti do t'i sundojë të gjitha kombet me drejtësi! <sup>11</sup>Të gëzohet qielli, të ngazëllohet toka, të tërbohohet deti me gjithçka që jeton në të.

<sup>12</sup>Të gëzohen arat, bashkë me gjithçka që rritet në to; të gëzohen të gjitha pemët! <sup>13</sup>Sepse po vjen Zoti; ai po vjen për ta siguruar drejtësinë në botë.

Ai do të mbretërojë mbi të gjitha vendet si gjyqtar i drejtë e i paanshëm.

♦ bëhet fjalë për fuqitë e errësirës që adhurohen nëpërmjet kulteve idhujtare të kombeve. Izraeli bënte përjashtim në sy të Zotit.

### Mbreti i botës dhe populli i tij

**97** Zoti është mbret! Të brohorasë mbarë toka, të gëzohen të gjithë ishujt.

<sup>2</sup>Zotin e rrethon errësira e thellë e reve; sundimi i tij është bazuar në të drejtën e në drejtësinë.

<sup>3</sup>Para tij shkon zjarri dhe i djeg të gjithë armiqtë e tij. <sup>4</sup>Vetëtimja e tij ndrit mbarë botën; bota e shesh dhe dridhet. <sup>5</sup>Malet shkrijnë si dyllë, para tij, Zotit të mbarë botës. <sup>6</sup>Qielli shpall se si e mban fjalën, dhe të gjitha kombet shohin madhësitinë e tij.

<sup>7</sup>Të gjithë ata që adhurojnë shtatoret e idhujve dhe mburren për idhujt e tyre të vdekur, do të turpërohen, sepse të gjitha 'perënditë' e nderojnë Zotin. <sup>8</sup>Në malin e Cionit flitet për këtë dhe gëzohet, brohoritet në të



gjitha qytetet e Judës, sepse ti, o Zot, korre fitore. <sup>9</sup>O Zot, ti je më i larti në botë, ti je më i lartë se të gjitha 'perënditë'! <sup>10</sup>Të gjithë ju që e doni Zotin, urrejeni të keqen! Meqë merrni anën e tij, ai e ruan jetën tuaj; ju çliron nga pushteti i armiqve të tij.

<sup>11</sup>Së shpejti do të lindë dielli për të gjithë ata që ia mbajnë besën dhe e dëgjojnë me gjithë zemër; atëherë do të këndojnë plot gëzim! <sup>12</sup>Gëzohuni për Zotin, ju që jeni besnikët e tij! Falënderojeni atë dhe mos harroni se ai është i shenjtë.

### Zoti i botës ndihmon popullin e tij

**98** Këndojuini Zotit një këngë të re! Për ne ai kreu mrekulli; me pushtetin e tij hyjnor korri fitore. <sup>2</sup>Para mbarë botës Zoti tregoi se si e çliroi popullin e tij. Tani të gjithë e kanë të qartë: mund t'i zihet besë. <sup>3</sup>E plotësoi premtimin e tij dhe i tregoi Izraelit mirësinë dhe besnikërinë. Të gjitha kombet e botës e panë se si na shpëtoi Perëndia jonë.

<sup>4</sup>Brohoritni për Zotin, ju banorët e botës! Kërceni nga gëzimi, lavdërojeni me këngë! <sup>5</sup>Të kumbojë harpa për nder të tij, nderojeni duke u rënë veglave me tela! <sup>6</sup>Të kumbojnë trumbetat dhe brirët, brohoritni për Zotin, sundimtarin e botës! <sup>7</sup>Të gjëmojë deti me gjithçka që jeton në të; të gëzohet toka me të gjithë ata që banojnë në të! <sup>8</sup>Të brohorasin lumenjtë dhe të këndojnë malet nga gëzimi! <sup>9</sup>Sepse Zoti po vjen; po vjen për të siguruar drejtësinë në botë. Do të sundojë mbi të gjitha kombet dhe në të gjitha vendet si gjyqtar i drejtë dhe i paanshëm.

### Perëndia i shenjtë është mbreti ynë

**99** Zoti është mbret! Froni i tij është mbi engjëjt rojtarë; kombet dridhen, toka tundet. <sup>2</sup>Zoti është i fuqishëm në qytetin e Cionit, sundimtar i pushtetshëm mbi të gjitha kombet.

<sup>3</sup>Të gjithë të të lavdërojnë, ty, Perëndinë e madh, që ngjall respekt të thellë! Ti je i shenjtë! <sup>4</sup>Ty, mbretit, të takon pushteti, dhe ti siguron të drejtën. Ti i caktove rregullat për jetën tonë, ti vendose në Izrael drejtësinë dhe rendin.

<sup>5</sup>Lavdërojeni Zotin, Perëndinë tonë! Bini përmbys para fronit të tij! Ai është i shenjtë! <sup>6</sup>Moisiu dhe Aharoni ishin priftërinjtë e tij, edhe Samueli mund t'i drejtohej atij; ata i luteshin atij, dhe ai u jepte përgjigje. <sup>7</sup>Foli me ta nga shtëllunga e reve, dhe ata iu përmbajtën kërkesave dhe urdhërimeve që u besoi ai.

<sup>8</sup>O Zot, Perëndia jonë, ti e dëgjoje lutjen tonë; ia fale popullit tënd mëkatet, por, megjithatë ti duhej t'i dënoje gabimet. <sup>9</sup>Lavdërojeni Zotin, Perëndinë tonë! Bini përmbys para malit të tij të shenjtë! Zoti, Perëndia jonë, është i shenjtë!

### Ne jemi populli i tij

**100** *Këngë falënderimi.*

Brohoritni për Zotin, ju banorët e botës! <sup>2</sup>Vihuni me gëzim në shërbim të tij! Afrojuni atij me brohoritje të madhe! <sup>3</sup>Mendohuni mirë: vetëm Zoti është Perëndi! Ai na krijoi dhe ne i takojmë atij. Ne jemi populli i tij, për të cilin ai kujdeset si bariu për kopenë e tij. <sup>4</sup>Hyni në portat e Tempullit me këngë falënderimi, hyni në oborrin e brendshëm me këngë lavdërimi! Lavdërojeni Zotin, falënderojeni për veprat e tij! <sup>5</sup>Sepse Zoti sillet mirë me ne; dashuria e tij nuk mbaron kurrë; e mban besën përgjithmonë.

### Premtimi solemn i mbretit

**101** *Këngë e Davidi.*

Do të këndoj për mirësinë dhe për drejtësinë, o Zot. Prandaj këndoj dhe luaj për nderin tënd.

<sup>2</sup>Kujdesem që të jetoj në mënyrë shembullore. Kur do të vish tek unë?

Me zemër të drejtë jetoj ndër ata që më rrethojnë. <sup>3</sup>Nuk merrem me plane për të keqen. Shkelja e urdhërimeve të Perëndisë ngjall neveri tek unë, askush të mos flasë kështu për mua. <sup>4</sup>Nuk dua t'ia di për ligësinë; prandaj qëndroj larg mashtrimit. <sup>5</sup>Kush shpif për të afërmin – edhe kur nuk e bën këtë publikisht – atij do t'ia mbyll gojën përgjithmonë. Nuk duroj asnjëri që është mendjemadh dhe që përçmon të tjerët. <sup>6</sup>Por i kërkoj me sy të gjithë ata që janë besnikë dhe të besuar; me njerëz të tillë shoqërohem. Kur dikush bën një jetë shembullore, e marr në shërbimin tim. <sup>7</sup>Për mashtruesin nuk ka vend pranë meje dhe gënjeshtarët duhet të zhduken. <sup>8</sup>Çdo mëngjes bëj gjyq të rreptë kundër të gjithë keqbërësve të tokës. Secilin që i shkakton tjetrit fatkeqësi, do ta largoj nga qyteti i Zotit.

### Shpresa në vështirësi

**102** *Lutja e një fatkeqi, të cilit i mbarojnë forcat dhe e qan hallin e tij para Zotit.*

<sup>2</sup>O Zot, dëgjoje lutjen time; të arrijë deri tek ti thirrja ime për ndihmë <sup>3</sup>Tani që jam në rrezik, mos ma kthe shpinën! Më dëgjo tani, po të thërras; më dëgjo shpejt. <sup>4</sup>Jeta ime po zhduket si tym, trupi im po më digjet si furrë. <sup>5</sup>Forcat e jetës sime thahen si bari në vapën e diellit, edhe ushqimin e harroj. <sup>6</sup>Vetëm të rënktoj e jam bërë i tëri kockë e lëkurë. <sup>7</sup>I ngjaj zogut të egër në shkretëtirë, kukuvajkës që banon në gërmadha. <sup>8</sup>I vetëm rri zgjuar në shtrat, si zogu i vetmuar në çati. <sup>9</sup>Armiajtë e mi më shajnë vazhdimisht. Kur dëshirojnë të shajnë dikë, përmendin emrin tim e thonë: «Rëntë mbi ty fatkeqësia, siç ra

mbi atë njeri!»<sup>10</sup>Për ushqim kam vetëm pluhur e hi, lotët më përzihen në pije.<sup>11</sup>Prej pakënaqësisë dhe zemërimit që ke ndaj meje, më ngrite lart dhe pastaj më rrëzove përtokë.<sup>12</sup>Jeta ime i ngjan ditës që po përrëndon; së shpejti nata do t'i përpijë hijet. Si bari në fushë, po fishkem, po thahem.

<sup>13</sup>Por ti, o Zot, mbretëron përgjithmonë, dhe të gjithë brezat do të flasin për ty.<sup>14</sup>Ti do të ndërhysh dhe do të kesh mëshirë për qytetin e Cionit. Është koha që të kujdesesh për të; ka ardhur koha e caktuar!<sup>15</sup>Ne, shërbëtorët e tu, i duam gurët e tij; na vjen keq që qyteti ka mbetur gërmadhë.

<sup>16</sup>Zotin ta pranojnë të gjitha kombet, të gjithë sundimtarët të përkulen para madhësisë dhe pushtetit të tij!<sup>17</sup>Meqë Zoti do ta rindërtojë qytetin e Cionit, do të shfaqet në madhësinë dhe pushtetin e tij.<sup>18</sup>Lutjet e të shtypurve nuk i refuzon, por i pranon ato me qejf.<sup>19</sup>Këto fjalë të mia duhet të shkruhen për brezin e ardhshëm; si populli i ri ai do ta lavdërojë Zotin.<sup>20</sup>Që lart nga qielli Zoti hedh vështrimin në tokë nga lartësia e vendit të tij të shenjtë; ai përkulet<sup>21</sup>për të dëgjuar rënkimin e të burgosurve dhe për të liruuar të dënuarit me vdekje.<sup>22</sup>Zotin do ta lavdërojnë në malin e Cionit, në mbarë Jerusalem do ta adhurojnë,<sup>23</sup>kur atje të mbledhen kombet dhe ta nderojnë të gjithë mbretërit.

<sup>24</sup>Në lulen e moshës Zoti m'i shteroi forcat, m'i shkurtoi ditët e jetës sime.<sup>25</sup>Prandaj i them: «Perëndia ime! Mos më lër të vdes në lulen e moshës!»

Ti vetë mbijeton nëpër breza.<sup>26</sup>Prej kohësh tokën e themelove, qiellin vetë e krijove.<sup>27</sup>Ata do të kalojnë, por ti do të mbetesh. Ata do të vjetrohen dhe do të prishen si veshjet, ti i ndërrosh si rroba, dhe ata do të zhduken.<sup>28</sup>Por ti do të mbetesh i njëjti, dhe vitet e tua nuk do të mbarojnë kurrë.<sup>29</sup>Fëmijët tanë do të jetojnë në siguri dhe fëmijët e tyre do të jenë të sigurt nën mbrojtjen tënde.

### Falja e madhe e falënderimit

## 103 *Këngë e Davidit.*

Do ta falënderoj Zotin me gjithë zemër, do t'i këndoj këngën time Perëndisë së shenjtë!<sup>2</sup>Do ta lavdëroj Zotin me të gjitha forcat e mia e kurrë nuk do ta harroj dashamirësinë e tij.

<sup>3</sup>M'i fali të gjitha mëkatet, më shëroi nga çdo sëmundje, më rrëmbeu nga varri dhe më mbuloi me mirësi dhe me mëshirë.<sup>5</sup>Me të mira e mbush jetën time dhe më jep forca të reja; ngrihem lart si shqiponjë.

<sup>6</sup>Zoti e plotëson premtimin e tij; ia siguron të drejtën popullit të shtypur.<sup>7</sup>Kështu i besoi Moisiut planet e tij, dhe popullit të Izraelit veprat e tij.<sup>8</sup>Zoti është plot mirësi dhe mëshirë, plot dashuri dhe durim të pakufishëm.<sup>9</sup>Nuk padit vazhdimisht dhe nuk mban inat përgjithmonë.<sup>10</sup>Nuk na dënon, megjithëse e meritojmë, nuk na paguan me çmimin e mëkateve tona.<sup>11</sup>Sa i pamasë është qielli, aq e madhe është mirësia e Perëndisë ndaj besnikëve të tij.<sup>12</sup>Sa e largët është lindja nga perëndimi, po aq na i largon Perëndia mëkatet.<sup>13</sup>Zoti i do të gjithë ata që e nderojnë, si ati që do fëmijën e vet.

<sup>14</sup>Ai e di nga se jemi krijuar, e ka parasysh se ne jemi veçse pluhur!<sup>15</sup>Jeta e njeriut i ngjan barit, lulëzon si lulet në fushë;<sup>16</sup>era vjen nga shkretëtira dhe e zhduk, aty ku ishte, nuk i mbetet më asnjë gjurmë.<sup>17</sup>Por mirësia e Perëndisë mbetet përgjithmonë; ai ua mban besën atyre që e nderojnë dhe kujdeset për fëmijët dhe nipërit,<sup>18</sup>kur i qëndrojnë besnikë dhe veprojnë sipas rregullave të besëlidhjes së tij.

<sup>19</sup>Zoti e ka ngritur fronin e tij në qiell; si mbret sundon mbi mbarë botën.<sup>20</sup>Ju engjëj të pushtetshëm, lavdërojeni Zotin, ju që i bindeni fjalës së tij dhe zbatoni urdhrat e tij.<sup>21</sup>Ju të pushtetshmit në qiell, lavdërojeni Zotin, ju shërbëtorët e tij, ju zbatuesit e vullnetit të tij!<sup>22</sup>Edhe ju të gjitha qeniet e tjera, që ai ju ka krijuar, lavdërojeni Zotin, kudo që banoni në mbretërinë e tij! Unë vetë them: O Zot, të falënderoj!

### Pushteti dhe mirësia e Krijuesit

## 104

Zotin do ta lavdëroj! O Zot, o Perëndi, sa i madh je! Ti je i veshur me madhësi dhe me shkëlqim,<sup>2</sup>ti je i mbuluar me dritë, porsia me mantel. E shtrin qiellin si fletë e çadrës,<sup>3</sup>banesën e ke ndërtuar mbi ujërat e qiellit. Ti i merr retë për karrocë, ti fluturon mbi flatrat e erës.

<sup>4</sup>Stuhia është lajmëtari yt, dhe zjarri në shërbimin tënd.

<sup>5</sup>Tokën e ndërtove në themele të forta; tani është e sigurt dhe nuk do të shembet.<sup>6</sup>Ujërat kishin mbuluar Tokën; ato qëndronin përmbi malet më të larta.<sup>7</sup>Nga zëri yt ato u frikësuan, nga bubullima jote ikën; nga malet u derdhën poshtë në lugina, deri në vendin që u caktove ti.<sup>8</sup>Ti u vure ujërave kufi; ato nuk do ta përmbysin më botën kurrë.

<sup>10</sup>Ti bën të dalin gurra që kthehen në përrenj, dhe rrugën e tyre e kërkojnë midis maleve.<sup>11</sup>Në to mund të pinë të gjitha kafshët; gomarët e egër shuajnë atje etjen.<sup>12</sup>Në brigje zogjtë bëjnë çerdhet e tyre; nga gjethet e dendura dëgjohen këngët e tyre.<sup>13</sup>Nga qielli ti lëshon shiun mbi male; kujdesesh që toka ta pijë sa të ngopet.<sup>14</sup>Ti bën që të rritet bari për bagëtinë dhe bimët që vetë njeriu i kultivon; kështu atyre toka u jep ushqimin:<sup>15</sup>vera për t'u gëzuar, vajin për t'u zbukuruar, bukën për t'u forcuar.

<sup>16</sup>Edhe pemët e mëdha kanë ujë sa të ngopen, cedrat e Libanit që ti vetë i mbolle.<sup>17</sup>Në degët e tyre zogjtë bëjnë foletë, lart në majat e pemëve qëndrojnë lejlekët.<sup>18</sup>Malet më të larta janë për dhitë e egra; në shkëmbinj vjedullat gjejnë strehim.

<sup>19</sup>Hënë e bëre për të shënuar kohën; dielli e di kur duhet të perëndojë.<sup>20</sup>Kur ti dërgon errësirën, bëhet natë dhe kafshët e pyllit fillojnë të lëvizin.<sup>21</sup>Luanët e rinj ulërijnë pas presë; presin nga ti, o Zot, që t'i ngopësh.<sup>22</sup>Kur ngrihet dielli, ato tërhiqen për të pushuar në skutat e tyre.<sup>23</sup>Atëherë zgjohet njeriu; shkon

në punën e tij dhe mundohet derisa të errësohet.

<sup>24</sup>O Zot, çfarë mrekullish ke bërë! Gjithçka e ke rregulluar me urtësi; toka është mbushur plot me krijesat e tua. <sup>25</sup>Ja, deti i gjerë dhe i pamasë, gëlon nga qeniet e panumërta, nga kafshët e mëdha dhe të vogla.

<sup>26</sup>Atje qarkullojnë anijet edhe kuçedra detare e rrezikshme që ti e krijoje për të luajtur me to. <sup>27</sup>Të gjitha qeniet e tua presin që t'u japësh ushqim në kohën e duhur. <sup>28</sup>Marrin atë që u shtrin dora jote; ti hap dorën dhe ata të gjithë ngopen. <sup>29</sup>Por kur u kthen shpinën, tronditen. Kur u heq frymën e jetës, ato vdesin dhe kthehen në pluhur. <sup>30</sup>Kur u dërgon rishtas frymën tënde, fillon përsëri jeta. Ti i jep tokës pamjen e re.

<sup>31</sup>Madhështia e Krijuesit do të mbetet e dukshme përgjithmonë. Zoti kënaqet për atë që krijoi! <sup>32</sup>Tokën e shikon dhe ajo tundet; malet i prek dhe ato lëshojnë tym.

<sup>33</sup>Do t'i këndoj Zotit gjithë jetën time; do ta lavdëroj Perëndinë tim, sa të kem frymë. <sup>34</sup>Dëshiroj ta gëzoj Atë me këngën time, sepse vetë gëzohem për Zotin tim. <sup>35</sup>Kush ngrihet kundër Zotit, duhet të zhduket nga toka. Të mos ketë më keqbërës!

Zotin do ta falënderoj! Lavdi Atij!

### Perëndia e mban fjalën

**105** Falënderojeni Zotin! Thuaje me zë të lartë se kush është Perëndia juaj; tregoj tu të gjitha kombeve ç'ka bërë ai! <sup>2</sup>Këndoni dhe luani për nder të tij. Kujtoni mrekullitë e tij! <sup>3</sup>Jini krenarë për të, për Perëndinë e shenjtë! Gëzohuni për të, ju që jeni besnikët e tij! <sup>4</sup>Afrojuni Zotit, sepse ai është i fuqishëm; kërkonti në çdo kohë praninë e tij! <sup>5-6</sup>Ju pasardhësit e shërbëtorit të tij, Avrahamit, ju pasardhësit e Jakovit, të zgjedhurit e tij, kujtoni veprat e tij të fuqishme, mrekullitë dhe vendimet e tij gjyqësore!

<sup>7</sup>Ai, Zoti, është Perëndia jonë, sundimi i tij përfshin mbarë botën. <sup>8</sup>Ai nuk e harron kurrë besëlidhjen e tij me ne, premtimi i tij vlen për mijëra breza. <sup>9</sup>Ashtu iu përbetua Avrahamit, ashtu ia vërtetoi Izakut me betim. <sup>10</sup>Ashtu i premtoi edhe Jakovit, si besëlidhje të përvetshme me Izraelin. <sup>11</sup>Tha: «Po ju jap mbarë tokën e Kënaanit, që ta keni si trashëgim.» <sup>12</sup>Atëherë ishte e lehtë për t'i numëruar, ishin vetëm një grusht njerëzish, të huaj të imigruar në tokën (e premtuar). <sup>13</sup>Shkonin nga një popull tek tjetri, duke u endur nëpër vendet e sundimtarëve të shumtë. <sup>14</sup>Por Perëndia nuk lejonte që të shtypeshin nga askush, për hatrin e tyre i paralajmëroi sundimtarët: <sup>15</sup>«Mos i prekni shërbëtorët e mi të zgjedhur! Mos u prekni asnjë qime flloku lajmëtarëve të mi!»

<sup>16</sup>Ai shkaktoi në vend uri të madhe, dhe njerëzit nuk gjenin asnjë për të ngrënë. <sup>17</sup>Por kishte dërguar para tyre një njeri, Josefin, që u shit skillav. <sup>18</sup>Atij i vunë prangat në këmbë, ia rrethuan qafën me unazë, <sup>19</sup>derisa të plotësoheshin profecitë e tij dhe të dilte i pafajshëm sipas fjalës së Zotit. <sup>20</sup>Mbreti dha urdhrë t'i zgjidheshin prangat; sundimtari i shumë popujve e liroi. <sup>21</sup>I besoi pushtetin, administrimin e mbarë pronës së tij, <sup>22</sup>që t'u jepte ministrave urdhra, këshilltarëve mbretërorë t'u mësonte urtësi.

<sup>23</sup>Atëherë Jakovi erdhi në Egjipt, Izraeli u bë mysafir në vendin e hamitëve. <sup>24</sup>Zoti e shumëzoi popullin, e bëri më të fuqishëm se shtypësit e tij. <sup>25</sup>Ashtu shndërroi mendjen e egjiptianëve; ata filluan t'i urrenin izraelitët dhe t'i mashtronin fshehtas shërbëtorët e Perëndisë. <sup>26</sup>Atëherë ai dërgoi Moisiun, të besuarin e tij, dhe Aharonin, të cilin vetë e kishte zgjedhur. <sup>27</sup>Ata kryen mrekulli të profetizuara, dëshmitë e tij në tokën e hamitëve. <sup>28</sup>Dërgoi errësirën më të dendur, dhe (egjiptianët) iu bindën urdhrit të tij. <sup>29</sup>Shndërroi në gjak ujërat e egjiptianëve dhe bëri të ngordhnin peshqit e tyre. <sup>30</sup>Bretkosat gëluan në mbarë vendin, hynë deri në dhomat e mbretit. <sup>31</sup>Me urdhrin e Zotit u dyndën dëmtuesit; tufat e mushkonjave mbuluan mbarë Egjiptin. <sup>32</sup>Në vend të shiut u dërgoi breshër, dhe rrufeja goditi gjithkund në tokë. <sup>33</sup>Ua shkatërroi hardhitë dhe fiqtë, të gjitha pemët i theu në krahinën e tyre. <sup>34</sup>Me urdhrin e tij u shfaqën karkalecat, një ushtri e panumërt shkatërrimtare <sup>35</sup>që nuk la në këmbë asnjë fije bari dhe shkretoi fushat anekënd. <sup>36</sup>Në fund bëri të vdisnin të parëlindurit, goditi krenarinë e familjeve egjiptiane.

<sup>37</sup>Pastaj i bëri të tijtë të dilnin nga vendi, të ngarkuar me pasuri prej ari dhe argjendi; në fiset e tyre askush nuk mbeti prapa. <sup>38</sup>Mbarë Egjipti u gëzua për nisjen e tyre; kaq e madhe ishte frika prej Izraelit.

<sup>39</sup>Me një re Zoti mbrojti popullin e tij, dhe zjarri ia ndriti natën. <sup>40</sup>Kur iu lutën, Zoti u dërgoi shkurtë; me bukë prej qiellit ai i ngopi. <sup>41</sup>Hapi shkëmbin dhe buroi ujë; si lumë rrodhi nëpër shkretëtirë.

<sup>42</sup>Ashtu bëri për shkak të premtimit të tij të shenjtë, që i kishte dhënë Avrahamit. <sup>43</sup>Kur e çliroi popullin e tij të zgjedhur, atëherë ata këndonin dhe ngazëllonin nga gëzimi. <sup>44</sup>U dha tokën e popujve të tjerë, u dha për pronë frytet e punës së të huajve, <sup>45</sup>që të ndiqnin udhëzimet e tij dhe t'u bindeshin urdhrave të tij.

Lavdi Zotit!

### Pabesia e Izraelit dhe besa e Perëndisë

**106** Haleluja – lavdi Zotit! Falënderojeni Zotin, sepse ai është i mirë ndaj nesh, dashuria e tij nuk mbaron kurrë! <sup>2</sup>Kush mund t'i numërojë të gjitha veprat e tij dhe ta falënderojë atë siç duhet?

<sup>3</sup>Sa të lumtur janë të gjithë ata që e drejtojnë jetën sipas udhëzimeve të Perëndisë e në çdo kohë zbatojnë atë që kërkon ai!

<sup>4</sup>Kur t'i tregosh popullit tënd dashuri, o Zot, mendo edhe për mua! Kur ta çlirosh, më ndihmo edhe mua!

<sup>5</sup>Dua të provoj lumturinë e të zgjedhurve të tu, të gëzohem bashkë me popullin tënd, të ngazëllohem

bashkë me të gjithë ata që të takojnë ty.

<sup>6</sup>Ne mëkatuam kundër teje, njëlloj si të parët tanë, bëmë padrejtësi dhe u ngarkuam me faj.

<sup>7</sup>Atëherë në Egjipt, të parët tanë nuk kuptuan asgjë nga mrekullitë e Perëndisë. Harruan dëshmitë e shumta të mirësisë së tij, e kundërshtuan në bregun e Detit të Xunkthtë. <sup>8</sup>Megjithatë, ai i shpëtoi dhe u tregoi fuqinë e tij të madhe, sepse nderi i tij ishte në rrezik. <sup>9</sup>E qortoi rreptë Detin e Xunkthtë dhe deti u tha. Aty ku zakonisht kishte ujëra të thella, bëri që të zgjedhurit e tij të kalonin në terik. <sup>10</sup>I shpëtoi nga armiqtë e mbushur me urrejtje dhe i çliroi nga pushteti i tyre. <sup>11</sup>Ujërat i mbuluan ata që i ndiqnin, asnjëri prej tyre nuk mbeti i gjallë. <sup>12</sup>Atëherë u zunë besë fjalëve të tij dhe e lavdëruan atë me këngë.

<sup>13</sup>Por pas pak veprat e tij i harruan; nuk pritën të plotësohej plani i tij. <sup>14</sup>E provokuan Perëndinë në shkretëtirë, se nuk mund t'u qëndronin epsheve të tyre. <sup>15</sup>U dërgoi atë që kërkonin; por në fund ai i sëmuri aq rëndë, saqë u dobësuan gjithnjë e më shumë.

<sup>16</sup>Në fushim plasi xhelozia për Moisiun edhe për Aharonin, shërbëtorin e kushtuar të Zotit. <sup>17</sup>Atëherë toka u hap menjëherë, gllabëroi Datanin dhe Aviram bashkë me farefisin e tyre dhe u mbyll përsëri mbi ta.

<sup>18</sup>Një zjarr shpërtheu në mesin e tyre dhe e përpiu mbarë hordhinë kryengritëse.

<sup>19</sup>Në Horev bënë për vete figurën e demit, ranë përmbys para metalit të derdhur. <sup>20</sup>Madhështinë e Zotit e shkëmbyen me shtatoren e kaut që ha barin. <sup>21</sup>Perëndinë, Shpëtimtarin e tyre, e harruan; harruan edhe veprat e tij të mëdha në Egjipt, <sup>22</sup>edhe mrekullitë e tij në tokën e pasardhësve të Hamit, veprimtarinë e tij në breg të Detit të Xunkthtë, që ngjall frikë dhe respekt të plotë. <sup>23</sup>Prandaj ai mendoi t'i shfaroste të gjithë së bashku; por Moisiu, i zgjedhuri i tij, ndërhyri, u bë ndërmjetës, dhe e largoi prej tyre zemërimin e Perëndisë, që populli të mos shfarosej plotësisht.

<sup>24</sup>Pastaj nuk e përfillën tokën e mrekullueshme (të premtuar), sepse nuk i zunë besë premtimit të Perëndisë; <sup>25</sup>ngritën krye nën çadrat e tyre e nuk deshën ta dëgjonin më Zotin. <sup>26</sup>Atëherë iu përбетua me dorë të ngritur t'i linte të vdisnin në shkretëtirë <sup>27</sup>dhe t'i shpërdante gjithkund pasardhësit e tyre, që të vdisnin ndër popuj të huaj.

<sup>28</sup>Edhe i dorëzuan që të nderonin Baalin, idhullin e malit Peor. Hëngrën mishin e kafshëve të flijuara për nder të idhujve të vdekur. <sup>29</sup>Me sjelljen e tyre e ngacmuan Zotin, i cili u zemërua me ta, dhe papritur mbi ta ra fatkeqësia. <sup>30</sup>Por Pinhasi ndërhyri, bëri gjyq dhe murtaja pushoi. <sup>31</sup>Me sjelljen e tij fitoi miratimin e Perëndisë; të mos e harrojnë të gjithë brezat e ardhshëm!

<sup>32</sup>Pranë burimit të Merivës ndodhi po ashtu: e provokuan Zotin dhe bënë që zemërimi i Zotit të binte mbi Moisiun. <sup>33</sup>Aq shumë e ngacmuan, saqë ai foli pa u menduar.

<sup>34</sup>Popujt e tjerë nuk i shfarosën, pavarësisht se Zoti kishte urdhëruar kështu. <sup>35</sup>Krijuan lidhje martesore me popujt të huaj dhe morën zakonet e tyre. <sup>36</sup>Iu nënshtruan idhujve të gdhendur, e kjo u solli fatkeqësi.

<sup>37</sup>Morën bijtë dhe bijat e tyre dhe ua kushtuan djajve. <sup>38</sup>Derdhën gjakun e të pafajshmëve, gjakun e fëmijëve të tyre që i vranë për nder të idhujve të Kënaanit; kështu përdhosën tokën e premtuar. <sup>39</sup>Ata u bënë të papastër me sjelljen e tyre; ajo që bënë, ishte tradhti ndaj Perëndisë. <sup>40</sup>Zoti u zemërua me popullin e tij; prona e vet ngjalli tek ai neveri. <sup>41</sup>Ua dorëzoi ata popujve të huaj; ata i sunduan njerëz të mbushur me urrejtje. <sup>42</sup>Ata i plaçkitën armiqtë dhe i shtypën me dorë të hekurt. <sup>43</sup>Zoti i çliroi herë pas here; por ata u rebeluan përsëri dhe kështu ranë nga shiu në breshër. <sup>44</sup>Por kur dëgjoi thirrjen e tyre për ndihmë, kur pa frikën dhe dëshpërimin e tyre, <sup>45</sup>atëherë Zoti përsëri e mbajti mend besëlidhjen e tij, premtimin e tij. Meqë është shumë i mirë, i erdhi keq që i kishte dëbuar në zemërimin e tij. <sup>46</sup>Prandaj bëri që të gjenin mëshirë tek të gjithë ata që i kishin robëruar.

<sup>47</sup>O Zot, Perëndia jonë, na shpëto! Na nxirr nga popujt e huaj dhe na mblidh përsëri! Atëherë do të të lavdërojmë ty, Perëndinë tonë të shenjtë, dhe do të gëzohemi të të falënderojmë!

<sup>48</sup>Lavdi i qoftë Zotit, Perëndisë së Izraelit, në jetë të jetëve! E të gjithë duhet të thonë: «Amen! Halelujal!»

## LIBRI I PESTË

### Këngë falënderimi e të shpëtuarve

**107** Falënderojeni Zotin, sepse ai është i mirë ndaj nesh, dashuria e tij nuk mbaron kurrë! <sup>2</sup>Kështu duhet të thonë të gjithë ata që Zoti i çliroi! I shpëtoi nga duart e armiqve të tyre <sup>3</sup>dhe i ktheu në shtëpi nga vendet e huaja, nga lindja dhe nga perëndimi, nga veriu dhe nga jugu.

<sup>4</sup>Disa u endën në shkretëtirë pa e gjetur rrugën; ata ishin larg krahinës së banuar. <sup>5</sup>Të munduar nga uria dhe etja, ata kishin humbur çdo shpresë. <sup>6</sup>Atëherë në pikën e hallit, Zotin e thirrën për ndihmë dhe ai i shpëtoi nga rreziku. <sup>7</sup>I çoi në rrugën e drejtë dhe bëri që të gjenin një vend të banuar. <sup>8</sup>Pra, ata duhet ta falënderojnë Zotin për mirësinë e tij, ta lavdërojnë për shpëtimin e tij të mrekullueshëm! <sup>9</sup>U dha të pinin atyre që po vdisnin nga etja, dhe të uriturve u siguroi ushqim të bollshëm. <sup>10</sup>Të tjerët, të burgosur të mjerë të lidhur me zinxhirë, ishin zhytur në errësirë pa shpresë, që diellin ta shihnin përsëri. <sup>11</sup>Ata ishin rebeluar kundër Perëndisë, kishin hedhur në erë urdhërimet e Zotit. <sup>12</sup>Kështu, me mundime të rënda kryeneçësinë ua theu; i shtriu përtokë, dhe askush nuk i ndihmoi ata të ngriheshin. <sup>13</sup>Të dëshpëruar ata e thirrën Zotin për ndihmë, i cili i shpëtoi ata nga rreziku. <sup>14</sup>I nxori nga burgu dhe ua theu prangat. <sup>15</sup>Pra, ata duhet ta falënderojnë Zotin për mirësinë e tij, ta lavdërojnë për shpëtimin e tij të mrekullueshëm! <sup>16</sup>Se

dyert e veshura me metal i theu, dhe shulat e hekurt ai i copëtoi.

<sup>17</sup>Edhe të tjerët ishin aq të marrë, saqë e kundërshtuan Zotin; mëkati i tyre u solli fatkeqësi të madhe. <sup>18</sup>U erdhi pëshiturë nga çdo ushqim dhe jeta e tyre mbahej në një fije peri. <sup>19</sup>E thirrën Zotin për ndihmë, dhe ai i shpëtoi nga rreziku. <sup>20</sup>Dha urdhër dhe u shëruan; kështu i ruajti nga varri. <sup>21</sup>Ta falënderojnë Zotin, pra, për mirësinë e tij, ta lavdërojnë për shpëtimin e tij të mrekullueshëm. <sup>22</sup>Ta falënderojnë me flijimin e dhuratave dhe ta shpallin plot gëzim atë që bëri! <sup>23</sup>Nëpër det u nisën të tjerët dhe shkuan në vende të largëta, për të bërë tregti në ato brigje. <sup>24</sup>Të habitur ata përjetuan se ç'mund të bëjë Zoti dhe se si i zotëron elementet e natyrës. <sup>25</sup>Me urdhrin e tij u ngrit stuhia dhe dallgët u bënë shumë të mëdha. <sup>26</sup>Anija e tyre kërceu lart në qiell dhe ra përsëri në humnerat e detit. Nga frika dhe tmerri ata sa nuk po vdisnin. <sup>27</sup>Tundeshin dhe lëkundeshin porsitë të dehur; urtësia e tyre kishte marrë fund. <sup>28</sup>Zotin e thirrën për ndihmë dhe ai i shpëtoi nga rreziku. <sup>29</sup>Bëri që stuhia të shndërrohej në fllad të lehtë, dhe dallgët e tërbuara shpejt u qetësuan. <sup>30</sup>Atëherë atyre zemra iu lehtësua, dhe Zoti i çoi në limanin e dëshiruar. <sup>31</sup>Ta falënderojnë, pra, Zotin për mirësinë e tij, ta lavdërojnë për shpëtimin e tij të mrekullueshëm. <sup>32</sup>Të tregojnë për këtë në kuvendin e popullit, dhe ta lavdërojnë për këtë në këshillin e pleqve!

<sup>33</sup>Perëndia mund t'i thajë lumenjtë, të bëjë stepë luginat plot me ujë, <sup>34</sup>dhe tokën shterpë tokë pjellore, kur banorët e saj nuk e përfillin drejtësinë. <sup>35</sup>Edhe shkretëtirën ai mund ta shndërrojë në fushë, dhe në stepë të bëjë të shpërthejnë burimet. <sup>36</sup>Atje mund të jetojnë ata që po vdesin nga uria; të ndërtojnë një qytet ku mund të banojnë. <sup>37</sup>Punojnë tokën, mbjellin vreshta dhe mbledhin të korrat e tyre të shumta. <sup>38</sup>Perëndia u dhuron lumturi dhe sukses, dhe atyre u lindin shumë fëmijë; edhe kopetë atyre u shtohen. <sup>39</sup>Pastaj zvogëlohen gjithnjë e më shumë, të munduar nga fatkeqësia dhe shtypja, <sup>40</sup>atëherë Zoti të parët e tyre i turpëron dhe i bën të enden në shkretëtirën pa fund. <sup>41</sup>Por të varfrit ai i çliron nga rreziku dhe bën që familjet e tyre të rriten si kope.

<sup>42</sup>Të gjithë ata që e dëgjojnë Zotin, do ta shohin këtë e do të gëzohen; por gojët e njerëzve të këqij duhet të heshtin. <sup>43</sup>Kush është i urtë, t'i vërë re këto dhe do ta kuptojë se si i mban Zoti premtimet e tij.

### Siguria në rrezik të madh

**108** *Këngë e Davidit.*

<sup>2</sup>Zemra ime u qetësua, o Perëndi, e ndiej veten përsëri të sigurt; do të të lavdëroj me këngë. Po, ashtu do të bëj! <sup>3</sup>Harpë dhe lahutë, zgjohuni, se sot do të zgjoj diellin! <sup>4</sup>Ty, o Zot, të sjell falënderimin tim; për ty do të këndoj para të gjithë popujve; <sup>5</sup>sepse mirësia jote është më e madhe se qielli, dhe besnikëria jote arrin deri në re! <sup>6</sup>O Perëndi, ndrite qiellin me madhësitinë tënde, dhe mbushe tokën me fuqinë tënde! <sup>7</sup>Ndërrhyr me dorën tënde të fuqishme, jepi përgjigje thirrjes sime, na shpëto, sepse ti na do!

<sup>8</sup>Nga shenjtërorja e tij Perëndia jep përgjigje: «Gëzohem për fitoren time – thotë. – Popullit tim do t'i jap për trashëgim Shehemin, do t'i ndaj luginën e Sukotit. <sup>9</sup>Mua më takon Gileadi, mua më përket Mënasheu, Efraimi është përkrenarja ime dhe Juda është skeptri im. <sup>10</sup>Moavi duhet të më shërbejë për legen, mbi Edomin e hedh këpucën time. Kundër filistenjve lëshoj kushtrimin!»

<sup>11</sup>Kush do të më sjellë në qytetin e fortifikuar, kush do të më çojë deri në Edom? <sup>12</sup>Përveç teje, kush mund ta bëjë këtë, o Perëndi? Por ti na dëbove dhe nuk i shoqëron më ushtritë tona në luftë! <sup>13</sup>Na ndihmo në hallin tonë; ndihmë së njerëzve nuk mund t'i zihet besë!

<sup>14</sup>Me Perëndinë në anën tonë, do të kryejmë vepra të guximshme; sepse ai do t'i thyejë armiqtë tanë.

### Lutja e një të padituri të pafajshëm

**109** *Këngë e Davidit.*

Ti, o Perëndi, të cilit gjithnjë i këndoj këngët e falënderimit, mos hesht më! <sup>2</sup>Shpifarakë të pandërgjegjshëm më akuzojnë; nga ana e tyre vetëm gënjeshtër dëgjoj. <sup>3</sup>Me fjalë armiqësore ata më rrethojnë, pa arsye më kufizojnë. <sup>4</sup>Miqësisë sime i përgjigjen me padi; por unë për ta iu luta Perëndisë. <sup>5</sup>Të mirën ma paguajnë me të keqe; dashurisë sime i përgjigjen me urrejtje.

<sup>6</sup>«Duhet gjetur një gjyqtar, – thonë, – një gjyqtar i korruptuar për ta dënuar, një avokat që e padit! <sup>7</sup>Në fund duhet t'i japë fajësinë, edhe lutja e tij duhet llogaritur si krim! <sup>8</sup>Vetëm pak vjet zgjastë jeta e tij, dhe pastaj një tjetër ia marrtë pozitën! <sup>9</sup>Fëmijët e tij u bëfshin fëmijë jetimi, dhe gruaja e tij u bëftë veshushë e pambrojtur! <sup>10</sup>Fëmijët e tij banofshin në gërmadha dhe u endshin larg shtëpisë, që të kërkojnë lëmoshë.

<sup>11</sup>Tërë pronën e tij e marrshin fajdexhinjtë, dhe prodhimin e punës ia vjedhshin të huajt. <sup>12</sup>Të mos mbetet askush që të nderojë kujtimin e tij dhe t'i vijë keq për fëmijët që kanë mbetur jetimë! <sup>13</sup>U shfarosshin të gjithë pasardhësit e tij, në brezin e ardhshëm u harroftë emri i tij! <sup>14</sup>Zoti t'i llogaritë padrejtësinë e stërgjyshërve të tij, edhe fajësia e nënës së tij mbestë pa u shlyer! <sup>15</sup>Zoti të mos harrojë asgjë! T'i shuajë emrat e këtyre individëve, që askush të mos i mbajë mend në tokën e premtuar! <sup>16</sup>Sepse ky njeri nuk mendoi kurrë t'u bënte mirë të tjerëve. Të varfrit dhe nevojtarët i përndoqi, ata i dëboi pa shpresë drejt vdekjes. <sup>17</sup>I pëlqente mallkimi, prandaj mallkimi e zuri. Nuk donte t'ua falte të tjerëve mëkatet, prandaj bekimi u largua nga ai. <sup>18</sup>Donte të mallkohej, në qoftë se ishte me faj; u fsheh në këtë mallkim sikur të ishte mantel mbrojtës. E mallkimi e depërtoi si uji që pihet, si vaji, me të cilin lyhet. <sup>19</sup>Prandaj mallkimi të

mbetet tek ai, ta mbulojë si këmishë, si brez ta rrethojë përgjithmonë!»<sup>20</sup>O Zot, dënoji vetë në këtë mënyrë të gjithë ata që më akuzojnë e më shpifin!<sup>21</sup>Ti, o Zot, o Perëndia ime, do të më trajtosh siç i takon emrit tënd; mirësia jote është e përsosur. Më shpëto!<sup>22</sup>Jam i varfër dhe i pambrojtur – më kanë fyer rëndë;<sup>23</sup>Zhdukem si hija e natës; duan të më heqin qafe si insekt të bezdisshëm.<sup>24</sup>Nga agjërimet e shumta më priten gjunjët, nga mungesat që kam më është dobësuar trupi.<sup>25</sup>Armiqtë e mi tallen me mua, kur më shohin dhe tundin kokën me përbuzje.

<sup>26</sup>O Zot, Perëndia ime, më qëndro pranë! Më ndihmo, pres mirësinë tënde!<sup>27</sup>Bëje të njohur se ti e bën, se ti vetë, o Zot, dëshirove ashtu!<sup>28</sup>Ata më shajnë, por ti do të më bekosh. Ata më sulmojnë dhe mposhten, por unë do të këndoj nga gëzimi.<sup>29</sup>I zëntë turpi dhe faqja e zezë të gjithë ata që më akuzojnë, i mbulofshin si mantel.

<sup>30</sup>Do ta lavdëroj Zotin me zë të lartë, në mbledhjen e madhe do ta lavdëroj!<sup>31</sup>Sepse të pambrojturin ai do ta ndihmojë dhe do ta shpëtojë nga gjyqtarët që duan ta dënojnë me vdekje.

### **Premtimi i Perëndisë ndaj mbretit**

**110** *Këngë e Davidit.*

Perëndia, 110Zoti, të thotë ty, Zoti dhe Mbreti im: «Ulu në të djathtën time, gjersa t'i nënshtroj armiqtë e tu dhe t'i vë për shtrojë të këmbëve të tua.<sup>2</sup>Zoti të emëroi mbret në Cion. Prej andej mbretërinë tënde do ta zgjerosh; ti do të sundosh mbi të gjithë armiqtë e tu!<sup>3</sup>Nga populli yt, burra të zgjedhur do të të shoqërojnë, me dëshirë do të vijnë pas, kur t'i thërrasësh për luftë. Me veshje shenjtërore, me shkëlqimin e agimit, do të vijnë tek ti të rinjtë, të freskët si vesa e mëngjesit.»

<sup>4</sup>Duke u betuar Zoti të premton: «Ti je prifti im sipas rendit të Melkicedekut dhe ashtu do të mbetesh përgjithmonë.» Këtë premtim ai nuk e merr mbapsht.<sup>5</sup>Zoti do të të dalë krahe. Në ditën e zbatimit të vendimit gjyqësor do t'i rrëzojë mbretërit përtokë.<sup>6</sup>Kur të zbatojë mbi kombet vendimin gjyqësor, kufomat e të vdekurve do të shtrihen gjithkund; sundimtarët e shumë vendeve do t'i shkatërrojë.

<sup>7</sup>Mbreti do të pijë nga përroi pranë rrugës, e ashtu i forcuar, do të mbetet fitimtar.

### **Falënderim për mrekullitë e Perëndisë**

**111** Haleluja – lavdi Zotit! Do ta falënderoj Zotin me gjithë zemër, në mes të kishës së besnikëve të tij.<sup>2</sup>Sa të fuqishme janë veprat e Zotit! Të gjithë ata që kënaqen me të, mendojnë vazhdimisht për to.<sup>3</sup>Veprimi i tij është plot nder dhe madhështi; të tijëve ua mban besën përgjithmonë.

<sup>4</sup>Vetë kujdeset, që veprat e tij të mos harrohen. Zoti është plot mirësi dhe mëshirë!<sup>5</sup>Atyre që e dëgjojnë, ai u siguron jetën; kurrë nuk e harron besëlidhjen e tij me ta.<sup>6</sup>I tregoi popullit të tij sa i fuqishëm është; ia dhuroi atij vendet e popujve të tjerë.<sup>7</sup>Ajo që bën ai, është e besuar dhe e drejtë. Urdhërimet e tij meritojnë besim;<sup>8</sup>përgjithmonë qëndrojnë të patundura dhe duhen zbatuar me saktësi dhe besnikëri.<sup>9</sup>Zoti e çliroi popullin e tij dhe lidhi me të besëlidhjen që vlen përgjithmonë. Ai është i shenjtë dhe ngjall respekt të thellë.<sup>10</sup>Frika prej Zotit është parimi i urtësisë. Kush vepron kështu, është njeri i arsyeshëm.

Lavdia e Zotit nuk mbaron kurrë!

### **Lumturia e besnikëve**

**112** Haleluja – lavdi Zotit! Sa i lumtur është ai që e përfill dhe e nderon Zotin, ai që kënaqet me urdhërimet e Perëndisë!<sup>2</sup>Pasardhësit e tij bëhen të fuqishëm në tokën (e premtuar), sepse kush e dëgjon Zotin, fëmijët e tij bekohen nga Ai.<sup>3</sup>Mirëqenia dhe pasuria janë në shtëpinë e tij, besnikëria e tij ndaj Zotit mbetet e patundur përgjithmonë.<sup>4</sup>Edhe në kohët më të errëta drita ndrin për këdo që dëgjon Perëndinë dhe që vetë është plot mirësi dhe mëshirë, sepse i qëndron besnik Zotit.<sup>5</sup>I ecën mirë njeriut që u jep të varfërve lëmoshë dhe hua, dhe që në gjithçka që ndërmerr, përfill drejtësinë e caktuar nga Perëndia.<sup>6</sup>Kurrë nuk do të tundet, kurrë nuk do të harrohet besnikëria e tij.<sup>7</sup>Lajmi i keq nuk e frikëson, me zemër të qetë Zotit i beson.<sup>8</sup>Nga vendi nuk luan, pa frikë dhe plot guxim, qëndron të shikojë se si do të munden armiqtë e tij.<sup>9</sup>Me zemërgjerësi ai u jep nevojtarëve; besnikëria e tij ndaj Zotit mbetet përgjithmonë e palëkundur. Prandaj i dhurohet pushteti dhe nderi.<sup>10</sup>Njeriu i pabesë, e sheh këtë dhe tërbohët, dhëmbët kërcëllin dhe plas nga inati. Kështu, i prishen atij planet e këqija.

### **Madhështia dhe mëshira e Perëndisë**

**113** Haleluja – lavdi Zotit! Ju, shërbëtorët e tij, lavdërojeni Zotin! Lavdërojeni emrin e tij të madh!<sup>2</sup>Falënderojeni Zotin tuaj të fuqishëm tani dhe përgjithmonë!<sup>3</sup>Prej vendit ku lind dielli deri tek atje ku perëndon – Zoti lavdërohet kudo!

<sup>4</sup>Zoti është sundimtar mbi të gjitha kombet, dhe madhështia e tij qëndron më lart se qielli.<sup>5-6</sup>Në qiell ose në tokë, a i ngjan kush Zotit, Perëndisë sonë, atij që është ulur në fron në qiellin më të lartë dhe shikon poshtë në thellësitë më të madhe?<sup>7</sup>Të varfrin e nxjerr nga varfëria, të pambrojturin nga mjerimi i tij,<sup>8</sup>dhe i jep vendin e nderit pranë të nderuarve të popullit të tij.<sup>9</sup>Gruas beronjë i siguron shtëpinë dhe e bën të jetojë si nënë e lumtur.

Lavdi Zotit – Haleluja!

### Perëndia që ngjall respekt të thellë

**114** Kur Izraeli u largua nga Egjipti, kur pasardhësit e Jakovit u larguan nga populli, gjuhën e të cilit ata nuk e dinin, <sup>2</sup>atëherë Zoti e zgjodhi Judën për shenjtërore; Izraeli u bë sfera e sundimit të tij.

<sup>3</sup>Deti e pa atë dhe iku, Jordani u tërhoq para tij, <sup>4</sup>malet kërcyen përpjetë si desh dhe kodrat u hodhën lart si qengja.

<sup>5</sup>Ti, o det, përse ike prej tij? Ti, o Jordan, përse u tërhoqe? <sup>6</sup>Ju, o male, përse kërcyret si desh? Ju, o kodra, përse u hodhët si qengja?

<sup>7</sup>Ti, o tokë, tundu para Zotit, dridhu, kur të shfaqet Perëndia e Jakovit, <sup>8</sup>i cili e shndërron shkëmbin në pellg, dhe gurin e fortë në burim uji!

### Vetëm Perëndia u nderoftë

**115** Jo ne, o Zot, jo ne, por emrin tënd ndero! E dimë se ti je i mirë dhe e mban besën! <sup>2</sup>Përse i lejon kombet e tjera të thonë: «Ku është futur, pra, Perëndia juaj?»

<sup>3</sup>Perëndia jonë? Ai është në qiell! Gjithçka që dëshiron, ai e bën! <sup>4</sup>Por idhujt e tyre prej ari dhe argjendi janë punë e duarve të tyre njerëzore. <sup>5</sup>Kanë gojë, por nuk thonë asnjë fjalë; sy, por nuk shohin asgjë; <sup>6</sup>kanë veshët, por nuk dëgjojnë asgjë; kanë hundë, por nuk nuhasin asgjë; <sup>7</sup>kanë duar, por nuk ndiejnë asgjë; këmbë, por nuk lëvizin dot, dhe nga gryka e tyre nuk del asnjë tingull. <sup>8</sup>Si ta u bëfshin të gjithë ata që i prodhuan këta idhuj, e të gjithë ata që i varin shpresat tek idhujt!

<sup>9</sup>Ju izraelitë, besojini Zotit! Ai është ndihmësi dhe mbrojtësi juaj. <sup>10</sup>Ju priftërinj, besojini Zotit! Ai është ndihmësi dhe mbrojtësi juaj! <sup>11</sup>Ju të gjithë që e nderoni, besojini Zotit! Ai është ndihmësi dhe mbrojtësi juaj!

<sup>12</sup>Zoti mendon për ne dhe do të na bekojë. Do të bekojë mbarë Izraelin! Do të bekojë priftërinjtë! <sup>13</sup>Do të bekojë të gjithë ata që e nderojnë, të vegjlit bashkë me të mëdhenjtë! <sup>14</sup>Zoti ju dhuroftë familje të mëdha, juve dhe të gjithë fëmijëve tuaj! <sup>15</sup>Zoti ju dhëntë lumturi dhe sukses, ai që krijoi qiellin dhe tokën!

<sup>16</sup>Qielli i takon vetëm Zotit, por tokën ai ua besoi njerëzve. <sup>17</sup>Të vdekurit nuk mund ta lavdërojnë më; janë atje ku heshtja mbretëron përgjithmonë. <sup>18</sup>Por ne do ta falënderojmë, tani dhe përgjithmonë!

Lavdi Zotit – Haleluja!

### Falënderimi për shpëtimin nga vdekja

**116** E dua Zotin, sepse më dëgjon, kur e thërras për ndihmë. <sup>2</sup>Për mua i ka veshët të hapur; prandaj do t'i lutem atij sa të jem gjallë.

<sup>3</sup>Isha i mbërthyer nga prangat e vdekjes, pas meje kapej terrori i botës së të vdekurve, më mundonin ankthi dhe dëshpërimi. <sup>4</sup>Atëherë për ndihmë e thirra: «O Zot, ma shpëto jetën!» <sup>5</sup>Ai është plot dashuri dhe e mban fjalën, plot mëshirë është Perëndia jonë. <sup>6</sup>Zoti i mbron të gjithë të pambrojturit. Isha i dobët dhe ai më ndihmoi mua. <sup>7</sup>Tani mund të gjej përsëri qetësi, sepse Zoti ishte i mirë ndaj meje.

<sup>8</sup>O Zot, ti më shpëtove nga vdekja që më kërcënohej, bëre të shteronin lotët e mi dhe këmbët e mia i ruajte nga gremina. <sup>9</sup>Më lejove të mbetem në botën e të gjallëve, të vazhdoj të jetoj në praninë tënde.

<sup>10</sup>I besova Zotit, edhe kur vajtova: «Jam i shtrirë fare në tokë.» <sup>11</sup>I hutuar thashë: «Nuk mund t'i zihet besë asnjërit!» <sup>12</sup>Si mund t'ia shpërblej Zotit gjithçka që bëri për mua? <sup>13</sup>Do ta pranoj këtë para kishës dhe do t'i kushtoj blatimin e pijes duke ngritur gotën për ta falënderuar. <sup>14</sup>Atë që i premtova atij, do ta plotësoj në prani të popullit të tij. <sup>15</sup>Zoti nuk lejon që të tijnë të humbasin; jeta e tyre është shumë e vlefshme për të.

<sup>16</sup>O Zot, ty të përkas me mish e me shpirt; prandaj ti më çlirove nga vdekja. <sup>17</sup>Të sjell fljimin e falënderimit dhe pranoj se ti je Perëndia ime.

<sup>18</sup>Atë që i premtova Zotit, do ta plotësoj në prani të mbarë popullit të tij, <sup>19</sup>në oborret e Tempullit të tij, në mesin tënd, o Jerusalem! Lavdi Zotit – Haleluja!

### Zotin e lavdëroftë mbarë bota

**117** O popuj të gjithë, lavdërojeni Zotin! Ju kombe të gjitha, thurini lavde atij! <sup>2</sup>Sepse mirësia e tij ndaj nesh është jashtëzakonisht e madhe, dhe besnikëria e tij nuk mbaron kurrë.

Lavdi Zotit – Haleluja!

### Falënderimi i mbretit për ndihmën e Perëndisë

**118** Falënderoje Zotin, sepse ai është i mirë ndaj nesh, dashuria e tij nuk mbaron kurrë! <sup>2</sup>Izraelitët të thërrasin: «Dashuria e tij nuk mbaron kurrë!» <sup>3</sup>Priftërinjtë të thërrasin: «Dashuria e tij nuk mbaron kurrë!» <sup>4</sup>Të gjithë ata që e nderojnë Zotin, të thërrasin: «Dashuria e tij nuk mbaron kurrë!»

<sup>5</sup>Kur isha i kuzifuar nga të gjitha anët, Zotin e thirra për ndihmë. Ai m'u përgjigj dhe më çliroi. <sup>6</sup>Zoti më ndihmon; tani nuk kam më frikë nga asgjë. Çfarë mund të më bëjë njeriu? <sup>7</sup>Zoti më ndihmon, ai vetë ndërhy; prandaj do ta shoh se si munden armiqtë e mi. <sup>8</sup>Më mirë të kërkoj ndihmë te Zoti, sesa t'i var

shpresat te njerëzit. <sup>9</sup>Më mirë të kërkoj ndihmë nga Zoti, sesa të pres ndihmë nga të fuqishmit. <sup>10</sup>Popujt armiq më rrethonin – i prapësova me ndihmën e Zotit! <sup>11</sup>Nga të gjitha anët më rrethonin – i prapësova me ndihmën e Zotit! <sup>12</sup>Si luzma bletësh ata më sulmonin, por i prapësova me ndihmën e Zotit! Sulmi i tyre kaloi si zjarri i kashtës. <sup>13</sup>Më qepeshin për të më rrëzuar, por Zoti më ndihmoi. <sup>14</sup>Do ta lavdëroj Zotin me këngën time, sepse më shpëtoi. <sup>15</sup>Populli po këndon këngën e fitores; nga të gjitha çadrat buçet një zë i lartë: «Zoti më tregoi pushtetin e tij. <sup>16</sup>Dora e tij është ngritur lart në shenjë fitoreje. Ai i shpartalloi armiqtë!»

<sup>17</sup>Nuk duhet të vdes; mund të vazhdoj të jetoj dhe të tregoj atë që bëri Zoti. <sup>18</sup>Zoti më trajtoi ashpër, por më ruajti nga vdekja. <sup>19</sup>Hapmani portën për të hyrë në Tempull, nëpër të cilën hyjnë ata që ia mbajnë besën! Atje do të hyj për ta falënderuar Zotin. <sup>20</sup>«Këtu është hyrja për te Zoti. Në qoftë se u je përmbajtur udhëzimeve të tij, atëherë eja të hysh!» <sup>21</sup>Të falënderoj, o Zot, se ti më dëgjove! Ti më shpëtove!

<sup>22</sup>Guri që ndërtuesit hodhën tej, tani është bërë guri i qoshes. <sup>23</sup>Zoti e bëri këtë mrekulli, dhe ne e pamë.

<sup>24</sup>Kjo ditë e festës është dhuratë e Zotit. Sot të gëzohemi dhe të ngazëllohem! <sup>25</sup>Na ndihmo, o Zot! Jepna lumturi dhe sukses! <sup>26</sup>«Rroftë ai që vjen në emrin e Zotit! Ju themi bekimin e Zotit, këtu, nga Tempulli.»

<sup>27</sup>Vetëm Zoti është Perëndi. Ai na shikon me dashamirësi. «Merrini degët! Bashkohuni të gjithë në vallen e festës, që arrin deri te brirët e altarit.»

<sup>28</sup>Ti je Perëndia ime dhe të falënderoj; o Zot, o Perëndia ime, do të të lavdëroj! <sup>29</sup>Falënderoj Zotin, sepse ai është i mirë ndaj nesh, dashuria e tij nuk mbaron kurrë!

## **Këngë për lavdërimin e Ligjit të Zotit**

### **ALEF♦ – bekimi i dëgjesës**

**119** Lum ai që bën jetë shembullore dhe gjithnjë i përmbahet me përpikëri Ligjit të Zotit! <sup>2</sup>I lumtur ai që zbaton detyrimet ligjore të Perëndisë dhe e kërkon atë me gjithë zemër! <sup>3</sup>Te njerëz të tillë nuk zë vend asnjë padrejtësi, sepse në gjithçka ata zbatojnë vullnetin e Perëndisë. <sup>4</sup>Ti, o Zot, i dhe rregullat e tua, që secili në jetë të drejtohet sipas tyre. <sup>5</sup>Do të dëshiroja të kisha edhe më shumë vendosmëri për t'u nënshtruar rregullave të tua! <sup>6</sup>Atëherë nuk do të kisha përse të turpërohesha duke ndjekur urdhërimet e tua. <sup>7</sup>Atë që ke vendosur ti, e ngul në mendje dhe të lavdëroj për këtë me gjithë zemër. <sup>8</sup>Do t'u përmbahem ligjeve të tua; më ndihmo dhe mos më lër në baltë!

♦ shkronja e parë e alfabetit hebraik. Çdo ndarje e këtij psalmi fillon me një shkronjë të tillë sipas renditjes alfabetike. Çdo rresht përmban njërin prej sinonimeve për Ligjin.

### **BEJT – udha e pastrimit**

<sup>9</sup>Si mund ta zotërojë një i ri jetën e vet? Duke zbatuar ato që the ti, o Zot! <sup>10</sup>Me gjithë zemër e kërkoj vullnetin tënd; mos më lër t'u largohem (pa dashur) urdhërimeve të tua! <sup>11</sup>Atë që the ti, e ngul në mendje, se nuk dua të bëhem fajtor para teje. <sup>12</sup>Gjithnjë do të të falënderoj, o Zot, sepse ti ma bën të njohur vullnetin tënd. <sup>13</sup>Atë që ti vendose sipas drejtësisë sate, vazhdimisht e përsëris përmendsh. <sup>14</sup>Të jetoj saktësisht sipas kërkesave të tua, më gëzon njëlloj si pasuria e madhe. <sup>15</sup>Nëpër mend i çoj rregullat e tua, që ta zbuloj rrugën që ke caktuar për mua. <sup>16</sup>O Zot, ligjet e tua janë gëzimi im; fjalët e tua nuk do t'i harroj kurrë.

### **GIMEL – ngushëllimi në vetmi**

<sup>17</sup>Unë jam shërbëtori yt, o Zot, tregohu i mirë me mua, që të jetoj e ta ndjek fjalën tënde! <sup>18</sup>O Zot, hapmi sytë për t'i njohur mrekullitë që fshihen në Ligjin tënd! <sup>19</sup>Këtu në tokë jam vetëm mysafir, prandaj kam nevojë për mbrojtje. Mos më fshih urdhërimet e tua! <sup>20</sup>Kam dëshirë të zjarrtë për vendimet që nxore për raste të ndryshme. <sup>21</sup>Ti i kërcënon mendjemdhenjtë, të mallkuarit prej teje, të cilët i shkelin vazhdimisht urdhërimet e tua. <sup>22</sup>Më çliro nga turpi dhe përbuzja, se u përmbahem vazhdimisht kërkesave të tua. <sup>23</sup>Të mëdhenjtë këshillohen për të më bërë dëm; megjithatë, ligjet e tua do t'i ruaj. <sup>24</sup>Kënaqem me rregullat e tua, sepse ti më këshillon gjithnjë mirë.

### **DALET – forca me anë të gjykimit të mirë**

<sup>25</sup>Jam i shtrirë pa fuqi në pluhur; më gjallëro, ashtu siç premtove! <sup>26</sup>Të tregova për vuajtjen time; ti më ndihmove. Më mëso ligjet e tua! <sup>27</sup>Dëshiroj t'i kuptoj rregullat e tua, që të mendohem për mrekullitë e tua. <sup>28</sup>Trishtimi më bën të shpërthej në lot! Më ndihmo të çohem, siç më premtove! <sup>29</sup>Më ruaj nga çdo lloj mashtrimi, në mirësinë tënde ma trego Ligjin tënd! <sup>30</sup>Kam vendosur të ta mbaj besën e do t'u nënshtrhem vendimeve të tua. <sup>31</sup>Jam lidhur ngushtë me rregullat e tua, o Zot. Mos më lejo të rri si budalla! <sup>32</sup>Rrugën që më caktove, do ta ndjek, sepse ti më ndihmon ta kuptoj atë siç duhet.

### **HE – nevoja e drejtimit**



<sup>33</sup>O Zot, më lejo t'i njoh qartë ligjet e tua, që t'i ndjek deri në fund. <sup>34</sup>Më ndihmo të kuptoj Ligjin tënd; me gjithë zemër unë do t'i bindem. <sup>35</sup>Asaj që urdhërova, më ndihmo t'i përmbahem; kështu do të kënaqem me të! <sup>36</sup>Mendjen tim drejtoje drejt rregullave të tua dhe jo drejt fitimit të pasurisë së madhe. <sup>37</sup>Hiqe shikimin tim nga gjërat e kota dhe drejtomë, që të jetoj siç të pëlqen! <sup>38</sup>O Zot, realizoje për mua premtimin që u ke bërë besnikëve të tu. <sup>39</sup>Hiqma turpin që më frikëson! Ajo që vendose ti, është e mirë dhe e drejtë. <sup>40</sup>Dëshiroj të drejtohem plotësisht sipas kërkesave të tua. Më përkrah, o Zot; atëherë do të jetoj.

#### **VAV – guxim për ta pranuar Zotin para njerëzve**

<sup>41</sup>Ardhtë deri tek unë mirësia jote; o Zot, më shpëto siç premtove! <sup>42</sup>Atëherë mund t'i jap përgjigje kujtdo që tallet me mua, se unë kam besim në fjalët e tua. <sup>43</sup>Dua të të lavdëroj për besnikërinë tënde, i besoj vendimit tënd gjyqësor. <sup>44</sup>Do t'i përmbahem Ligjit tënd, o Zot, në çdo kusht e përgjithmonë. <sup>45</sup>Do të jetoj i lirë nga çdo ngushticë, sepse drejtohem gjithnjë sipas kërkesave të tua. <sup>46</sup>Para mbretërve do të flas për ligjet e tua dhe jam i bindur se nuk do të turpërohem. <sup>47</sup>Urdhërimet që ke dhënë, unë i vë në jetë; zbatimi i tyre mua më jep gëzim. <sup>48</sup>Urdhërimet e tua i dua dhe i nderoj, dhe ligjet e tua unë i mbaj ndër mend.

#### **ZAJIN – burimi i ngushëllimit**

<sup>49</sup>Mos harro atë që më premtove; ti më bëre ta pres, o Zot! <sup>50</sup>Edhe në hallin tim ngushëllohem, se me fjalën tënde ti më mban në jetë. <sup>51</sup>Mendjemëdhenjtë tallen me mua; megjithatë nuk largohem nga Ligji yt. <sup>52</sup>Kjo më jep zemër, o Zot, kur mendoj se si kujdeseshe për të drejtën në kohët e lashta. <sup>53</sup>Zemërohem kur shoh njerëzit që e lënë dhe nuk e përfillin Ligjin tënd. <sup>54</sup>Gjersa të jem mysafir në këtë botë, ligjet do të jenë thelbi i këngëve të mia. <sup>55</sup>Çdo natë mendimi im vërtitet rreth teje, që ta zbatoj gjithnjë Ligjin tënd, o Zot <sup>56</sup>Të jetoj sipas kërkesave të tua, kjo është detyra ime dhe gëzimi im më i madh.

#### **HET – vendosmëria e besnikërisë**

<sup>57</sup>E përsëris, o Zot; ky është privilegji im, që të drejtohem gjithnjë sipas fjalëve të tua. <sup>58</sup>Me gjithë zemër kërkoj mirësinë tënde; ki mëshirë për mua, siç premtove! <sup>59</sup>Mendohem për mënyrën e jetës sime dhe kthehem gjithnjë te rregullat e tua. <sup>60</sup>Shpejtoj, nuk e lë ta zbatoj më vonë atë që urdhëron ti. <sup>61</sup>Rreth meje kanë ngritur kurthe, por kurrë nuk e harroj Ligjin tënd. <sup>62</sup>Në mesnatë zgjohem e të lavdëroj, se vendimet e tua janë të drejta. <sup>63</sup>Jam mik i kujtdo që të nderon dhe rregullat e tua i ndjek me përpikëri. <sup>64</sup>Toka është mbushur me mirësinë tënde; o Zot, më mëso ligjet e tua!

#### **TET – disiplina nga vuajtja**

<sup>65</sup>Ti ke qenë aq i mirë ndaj meje, o Zot, ashtu siç premtove. <sup>66</sup>Më jep gjykim dhe dijeni, sepse u besoj urdhërimeve të tua. <sup>67</sup>Më përpara duhej të vuaja, dhe shkoja në rrugë të gabuar; por tani bëj atë që më urdhëron ti. <sup>68</sup>Ti je gjithnjë i mirë dhe më bën shumë të mira! O Zot, më ndihmo t'i njoh ligjet e tua! <sup>69</sup>Akuzohem nga gënjeshtarë të pafytyrë, unë që me gjithë zemër i ndjek rregullat e tua. <sup>70</sup>Ata janë tepër të topitur, por Ligji yt me jep gëzim të madh. <sup>71</sup>Për mua ishte mirë që m'u desh të vuaja, që të mendohem për ligjet e tua. <sup>72</sup>O Zot, për mua Ligji yt ka vlerë më të madhe sesa mijëra monedha të argjendta e të arta!

#### **JOD – drejtësia e shpagimit**

<sup>73</sup>Me duart e tua më formove. O Zot, më ndihmo t'i kuptoj urdhërimet e tua! <sup>74</sup>Besnikët e tu më shohin dhe gëzohen, sepse i besova fjalës sate. <sup>75</sup>E di, o Zot, se ti gjithnjë vendos drejt; kisha të drejtë, kur më bëre të vuaja. <sup>76</sup>Mirësia jote më ngushëlloftë përsëri, siç më premtove! <sup>77</sup>Ki mëshirë për mua, atëherë do të jetoj; sepse Ligji yt është gëzimi im më i madh. <sup>78</sup>Turpëroji të gjithë gënjeshtarët e pafytyrë, sepse më paditin pa asnjë arsye! Mendohem për rregullat e tua. <sup>79</sup>Të vijnë tek unë të gjithë ata që të nderojnë, që t'i kuptojnë rregullat e tua! <sup>80</sup>Dua të jetoj me përpikëri sipas ligjeve të tua, atëherë nuk do të turpërohem.

#### **KAF – shpresa në errësi**

<sup>81</sup>E pres me mall ndihmën tënde, sepse i besoj premtimit tënd. <sup>82</sup>Këtë e kërkoj me sy gjithkund. O Zot, kur do ta plotësosh premtimin tënd e do të më ngushëllosh? <sup>83</sup>Rrudhem si kaceku që varet në tym; por megjithatë, kurrë nuk do t'i harroj ligjet e tua. <sup>84</sup>Edhe sa kohë do të vonohesh? Kur do ta zbatosh vendimin tënd gjyqësor mbi ata që më përndjekin? <sup>85</sup>Armiqtë e mi më kanë hapur gropë, ata të pafytyrë që e përbuzin Ligjin tënd. <sup>86</sup>Asaj që urdhëron ti, o Zot, mund t'i besohet. Por ata më përndjekin pa të drejtë; më ndihmo! <sup>87</sup>Për pak më mbuluan me dhe, por nuk hoqa dorë nga rregullat e tua. <sup>88</sup>Me anë të mirësisë sate, më lejo të vazhdoj të jetoj, që t'u përmbahem rregullave të tua!

#### **LAMED – triumfi i besimit**

<sup>89</sup>Fjala jote, o Zot, qëndron përgjithmonë; ajo në qiell e ka vendin e përjetshëm. <sup>90</sup>Edhe besnikëria jote qëndron brez pas brezi; ti e ke themeluar tokën për të qëndruar. <sup>91</sup>Vullneti yt e mban gjer më sot gjithësinë. Gjithçka është në dispozicionin tënd. <sup>92</sup>Po të mos ishte Ligji yt burimi i gëzimit tim, unë do të

kisha vdekur nga mjerimi. <sup>93</sup>Kurrë nuk do t'i harroj rregullat e tua; me anë të tyre ti më mban gjallë. <sup>94</sup>O Zot, të takoj ty, eja të më ndihmosh! Në çdo kohë i kërkoj rregullat e tua. <sup>95</sup>Keqbërësit presin të më shkatërrojnë, por unë do t'u përmbahen rregullave të tua. <sup>96</sup>Pashë se çdo gjë e përkryer e ka një kufi, por urdhërimi yt ka vlerë të pakufishme.

### **MEM – urtësi nga Zoti**

<sup>97</sup>Sa shumë e dua Ligjin tënd! Gjithë ditën atë kam ndër mend. <sup>98</sup>O Zot, urdhërimet e tua do t'i kem gjithnjë pranë; ato më kanë bërë më të mençur se armiqtë e mi. <sup>99</sup>Kam mësuar më shumë se mësuesit e mi, se në çdo gjë udhëhiqem nga rregullat e tua.

<sup>100</sup>Kam gjykim të mirë më shumë sesa pleqtë, sepse gjithnjë drejtohem në jetë sipas rregullave të tua.

<sup>101</sup>Larg i qëndroj çdo padrejtësie, që të zbatoj atë që ke urdhëruar.

<sup>102</sup>Nuk largohem nga vendimet e tua gjyqësore; ti vetë ishe mësuesi im, askush tjetër. <sup>103</sup>Sa të ëmbla janë fjalët e tua. Ato janë më të ëmbla se mjalti më i mirë. <sup>104</sup>Me anë të ligjeve të tua, ti bën që të vij në vete; prandaj rrugët e shtrembëra i urrej.

### **NUN – drita e jetës**

<sup>105</sup>Fjala jote është pishtar para hapave të mi, është një dritë që ndriçon rrugën time. <sup>106</sup>Kam vendosur ta mbaj betimin; do t'u përmbahem vendimeve të tua të drejta. <sup>107</sup>Më hodhe në vuajtjen më të thellë; o Zot, më ngushëllo sipas premtimit tënd! <sup>108</sup>Pranoje falënderimin tim si flijim; më ndihmo t'i kuptoj vendimet e tua! <sup>109</sup>Jeta ime është vazhdimisht në rrezik, por Ligjin tënd kurrë nuk do ta harroj. <sup>110</sup>Njerëzit mendojnë me ligësi të më ngrenë kurth, e megjithatë nuk largohem nga rregulli yt. <sup>111</sup>O Zot, rregullat e tua janë prona ime e përhershme; ato janë përgjithmonë gëzimi i zemrës sime! <sup>112</sup>Me vendosmëri do t'i ndjek ligjet e tua; qoftë ky shpërblimi im përherë!

### **SAMEH – frymëzimi i besës**

<sup>113</sup>I urrej njerëzit me dy fytyra; por Ligjin tënd e dua me gjithë zemër. <sup>114</sup>O Zot, ti je mbrojtja ime dhe strehimi im! Prandaj i besoj premtimit tënd. <sup>115</sup>Ju keqbërës, hiqmoni qafe! Unë ndjek urdhërimet e Perëndisë tim. <sup>116</sup>O Zot, bëhu mbështetja ime, që të jetoj; i zë besë fjalës sate, mos m'i humb shpresat!

<sup>117</sup>Bëhu përkrahja ime, o Zot, eja të më ndihmosh! Gjithnjë do t'u bindem ligjeve të tua. <sup>118</sup>Kush largohet nga ligjet e tua, atë ti e dëbon; sepse ajo që bën ai, është gënjeshtër e mashtrim. <sup>119</sup>Kush të hedh tej, atë ti e flak si mbeturinat; prandaj i dua rregullat e tua. <sup>120</sup>Trupi im dridhet nga respekti që ngjall ti, dhe vendimet e tua më mbushin me frikë.

### **AIN – Koha e ndërhyrjes**

<sup>121</sup>Jam sjellë me drejtësi dhe me besnikëri; mos më dorëzo te shtypësit e mi! <sup>122</sup>Më siguro që gjithçka do të dalë mbarë, që njerëzit e pafytyrë nuk do të më mendojnë më. <sup>123</sup>Sytë m'u lodhën duke kërkuar ndihmën tënde, dhe shpëtimin që ti më premtove. <sup>124</sup>Më trajto, të lutem, sipas mirësisë sate, dhe më mëso ligjet e tua. <sup>125</sup>Unë jam shërbëtori yt, bëmë të mençur që t'i njoh mirë rregullat e tua. <sup>126</sup>O Zot, tani është koha që të veprosh, sepse janë të shumtë ata që shkulin Ligjin tënd. <sup>127</sup>I dua urdhërimet e tua, shumë më tepër se arin më të kulluar. <sup>128</sup>Për mua, të gjitha rregullat e tua janë të drejta; prandaj i urrej praktikatat mashtruese.

### **PE – Mrekullia e zbulimit të fjalës sate**

<sup>129</sup>Rregullat që jep ti, janë të mrekullueshme, prandaj i përvishem zbatimit të tyre. <sup>130</sup>Zbulimi i fjalës sate sjell dritë; u jep njerëzve të thjeshtë aftësi për të gjykuar drejt. <sup>131</sup>Fjalët e tua i thith me lakmi të madhe, sepse digjem nga dëshira për urdhërimet e tua. <sup>132</sup>Kthehu nga unë, jepmë përkrahjen tënde, siç ke vendosur për ata që të duan. <sup>133</sup>Drejtoji hapat e mi sipas fjalës sate dhe mos lejo që të më zërë ndonjë e keqe. <sup>134</sup>Më çliro nga njerëzit që më shtypin, që të mund t'i plotësoj rregullat e tua. <sup>135</sup>Më trajto me dashamirësi; të lutem, më mëso ligjet e tua. <sup>136</sup>Qaj me lot të hidhur kur shoh se njerëzit nuk e përfillin Ligjin tënd.

### **CADE – Thirrje për drejtësinë**

<sup>137</sup>Ti e mban fjalën, o Zot, dhe vendimet e tua gjyqësore janë të drejta. <sup>138</sup>Me rregullat e tua ke dëshmuar që e drejta dhe besa përcaktojnë tërë veprimtarinë tënde. <sup>139</sup>Meqë të dua, o Zot, më kap inati kur armiqtë e mi e harrojnë Ligjin tënd. <sup>140</sup>Të gjitha fjalët e tua janë të padyshimta; prandaj, o Zot, jam besnik ndaj tyre. <sup>141</sup>Jam i parëndësishëm dhe i përbuzur, por rregullat e tua nuk i harrova. <sup>142</sup>Drejtësia jote do të jetë gjithnjë shpëtimi im, dhe Ligji yt është gjithnjë i vërtetë. <sup>143</sup>Edhe atëherë kur më mbërthen ankthi dhe shqetësimi, urdhërimet e tua janë miqtë e mi. <sup>144</sup>Përgjithmonë qëndron drejtësia me anë të rregullave të tua; më ndihmo t'i kuptoj dhe atëherë do të jetoj.

### **KOF – Siguria që vjen nga lutja**

<sup>145</sup>Me gjithë zemër të thërras; jepmë përgjigje! Dëshiroj t'u përmbahem ligjeve të tua, o Zot. <sup>146</sup>Të thërras për ndihmë, më shpëto! Do t'u bindem rregullave të tua. <sup>147</sup>Para agimit të thërras për ndihmë dhe i pres me padurim fjalët e tua. <sup>148</sup>Para se të agojë i hap sytë dhe çoj ndër mend fjalët e tua. <sup>149</sup>Me mirësinë tënde, o Zot, dëgjoje lutjen time; më ruaj me anë të vendimit tënd të drejtë. <sup>150</sup>Me qëllim të keq afrohen përndjekësit; por ata janë larguar nga Ligji yt. <sup>151</sup>Por ti, o Zot, ti rri afër meje; ajo që urdhëron ti, është gjithmonë e vërtetë. <sup>152</sup>Rregullat e tua i ke dhënë, që të qëndrojnë përgjithmonë; këtë e di prej kohësh.

### REJSH – Ndjenja e nevojës

<sup>153</sup>Shikoj hallin tim dhe më çliro! Ligjin tënd nuk e kam harruar kurrë. <sup>154</sup>O Zot, më përkrah dhe fitoj të drejtën time. Më shpëto, siç premtove! <sup>155</sup>Kush të përbuz, nuk gjen asnjë ndihmë, sepse nuk kujdeset për ligjet e tua. <sup>156</sup>O Zot, mëshira jote është e pamasë; më ndihmo të jetoj sipas vendimit tënd të drejtë! <sup>157</sup>Kam shumë armiq dhe përndjekës, por unë gjithnjë i kam ndjekur rregullat e tua. <sup>158</sup>Me neveri i shikoj tradhtarët, se ata nuk drejtohen sipas fjalëve të tua. <sup>159</sup>O Zot, shiko sa i dua rregullat e tua! Me mirësinë tënde, më lejo të vazhdoj të jetoj! <sup>160</sup>Fjala jote është e vërtetë dhe e besuar, o Zot; ajo që vendose ti, vlen përgjithmonë.

### SHIN – paqja në dashuri

<sup>161</sup>Të fuqishmit më ndjekin pa arsye, prapësëprapë vetëm fjalët e tua më ngjallin respekt. <sup>162</sup>Gëzohem shumë për fjalët e tua, siç gëzohet njeriu që gjen një thesar. <sup>163</sup>Gënjeshtrat më ngjallin vetëm neveri, por Ligjin tënd e dua shumë. <sup>164</sup>Të lavdëroj shtatë herë në ditë, sepse ti, o Zot, vendos gjithnjë drejt. <sup>165</sup>Kush e do Ligjin tënd, gjen lumturi dhe paqe; për të nuk ka asgjë që ta pengojë. <sup>166</sup>O Zot, shpresa ime është që ti do të më ndihmosh; unë zbatoj atë që ke urdhëruar ti. <sup>167</sup>Do të drejtohem sipas rregullave të tua; me gjithë zemër jam besnik ndaj tyre. <sup>168</sup>Ti më ke dhënë rregulla dhe udhëzime dhe shikon me përpikëri se si u përmbahem atyre.

### TAV – vendosmëria e qëndrueshmërisë

<sup>169</sup>Lutja ime ardhë tek ti, o Zot; plotësoje premtimin tënd, më jep mirëkuptim! <sup>170</sup>Që thirrja ime për ndihmë të arrijë tek ti! Më premtove se do të më shpëtosh! <sup>171</sup>Nga goja ime do të dalë lavdërimi për ty, sepse ti më bën të njohur ligjet e tua. <sup>172</sup>Për premtimin tënd do të këndojë goja ime; ajo që urdhërove ti, është e drejtë dhe e saktë. <sup>173</sup>Shtrihe dorën tënde, o Zot, për të më ndihmuar; unë kam vendosur të respektoj rregullat e tua! <sup>174</sup>Dëshira ime më e madhe është që të më shpëtosh, dhe Ligji yt është gëzimi im më i madh. <sup>175</sup>Dëshiroj të mbetem gjallë, o Zot, që të të lavdëroj; për këtë do të më ndihmojë vendimi yt gjyqësor. <sup>176</sup>Kam mbetur si dele e humbur; o Zot, eja më kërk, më kthe tek ti! Urdhërimet e tua nuk i kam harruar.

### Thirrje për ndihmë kundër shpifësve

**120** *Këngë pelegrinazhi.* ♦

E thërras Zotin në hallin tim; ai do të më japë përgjigje. <sup>2</sup>O Zot, më shpëto nga këta gënjeshtarë, nga të gjithë mashtruesit me dy fytyra!

<sup>3</sup>Çfarë dënimi do t'ju japë Perëndia, ju mashtrues? – <sup>4</sup>Një batare shigjetash lufte të zjarra, të skuqura me prush gjeshtash!

<sup>5</sup>Mjerë unë që më duhet të banoj ndër të huaj, te një popull që nuk e njeh Perëndinë tim! <sup>6</sup>Shumë gjatë kam jetuar këtu, ndër njerëz që e urrejnë paqen. <sup>7</sup>Paqen e dëshiroj; e porsa flas për këtë, ata kërkojnë luftë.

♦ fjj. këngë e shkallëve (hebr. *maalot*). Këto kënga do t'i kenë kënduar pelegrinët udhës për në Jerusalem.

### Zoti është me ty

**121** *Këngë pelegrinazhi.*

Ngre sytë drejt (Tempullit) në male, nga do të vijë ndihma ime. <sup>2</sup>Po, ndihma ime vjen nga Zoti, që krijoi qiellin dhe tokën!

<sup>3</sup>«Dëgjo: Zoti nuk do të lejojë që të biesh. Ai kujdeset për ty gjithnjë. <sup>4</sup>Ai, mbrojtësi i Izraelit, nuk lodhet dhe nuk e zë gjumi; <sup>5</sup>ai kujdeset edhe për ty. Zoti është me ty, të ruan me dorë të fuqishme, <sup>6</sup>që ngrohtësia e diellit të mos të bëjë dëm dhe hëna të mos të sëmurë. <sup>7</sup>Zoti e largon rrezikun prej teje dhe e ruan jetën tënde. <sup>8</sup>Zoti do të të mbrojë, nga fillimi deri në fund, tani e përgjithmonë.»

### Urim për paqen e Jerusalemit

**122** *Këngë pelegrinazhi (e Davidit).*

Sa u gëzova kur më thanë: «Eja të shkojmë në shtëpinë e Zotit!» <sup>2</sup>Tani po arrijmë, kemi kaluar nëpër porta dhe tani jemi në Jerusalem.

<sup>3</sup>O Jerusalem, qytet madhështor, i mbrojtur me mure të forta. <sup>4</sup>Drejt teje vijnë turma-turma fiset që i

takojnë Zotit. Atje Izraeli duhet ta lavdërojë Zotin ashtu siç e ka caktuar vetë. <sup>5</sup>Në Jerusalem gjendet gjyqi më i lartë; atje sundon dinastia e Davidit.

<sup>6</sup>Lumturi e paqe për Jerusalemin: të gjithë atyre që të duan, o Jerusalem, u priftë e mbara! <sup>7</sup>Brenda mureve të tua mbretëroftë siguria dhe mirëqenia; shtëpitë e tua qëndroftin larg shqetësimit!» <sup>8</sup>Meqë i dua vëllezërit dhe miqtë e mi, them: «Ju uroj lumturi e paqe!» <sup>9</sup>Meqë brenda teje gjendet shtëpia e Zotit, Perëndisë sonë, do të lutem për ty, që të lulëzosh.

### Lutja për mëshirë

**123** *Këngë pelegrinazhi. (e Davidit)*

<sup>1</sup>E ngre shikimin lart, drejt teje, o Zot, që banon në qiell. <sup>2</sup>Ashtu siç shohin shërbëtorët dorën e të zotit të tyre, ashtu si shërbëtorja që nuk ia ndan sytë dorës së të zonjës, ashtu edhe ne e ngremë vështrimin tonë drejt teje, o Zot, o Perëndia jonë, dhe presim të na tregosh mëshirën tënde! <sup>3</sup>Ki mëshirë, o Zot, ki mëshirë për ne! Kemi përjetuar mjaft përbuzje, <sup>4</sup>aq shumë, sa detyroheshim të gëlltitnim talljen e armiqve tanë të ngopur dhe mendjelehtë, përqeshjen e shtypësve të paturpshëm!

### Ndihma jonë vjen nga Zoti!

**124** *Këngë pelegrinazhi.*

Po të mos na kishte ndihmuar Zoti – le ta pranojë Izraeli – <sup>2</sup>po të mos na kishte ndihmuar Zoti, kur armiqtë na sulmonin, <sup>3</sup>për ta zbrazur vrerin mbi ne, do të ishim shfarosur prej kohësh nga toka. <sup>4-5</sup>Do të na kishin mbuluar dallgët, do të na kishin kapur ujëra të shkumëzuara, do të na kishte rrëmbyer përroi.

<sup>6</sup>Lavdi Zotit! Ai nuk na dorëzoi tek armiqtë tanë si gjah për dhëmbët e tyre. <sup>7</sup>Ikëm si zogu nga rrjeta e gjuetarit; rrjeta u gris dhe ne jemi të lirë!

<sup>8</sup>Ndihma jonë vjen nga Zoti, i cili krijoi qiellin dhe tokën.

### Nën mbrojtjen e Zotit

**125** *Këngë pelegrinazhi.*

Të gjithë ata që i besojnë Zotit, janë si mali i Cionit, të patundur dhe të sigurt përgjithmonë.

<sup>2</sup>Jerusalemin e rrethon një mur mbrojtës malesh. Ashtu e rrethon Zoti popullin e vet, tani dhe përgjithmonë.

<sup>3</sup>Njerëzit që nuk i përfillin urdhërimet e Perëndisë, do të sundojnë për pak kohë në tokën (e premtuar), e cila u takon atyre që e dëgjojnë Zotin; përndryshe edhe besnikët (nuk do të duronin më) e do të jepeshin pas padrejtësisë.

<sup>4</sup>O Zot, bëju mirë njerëzve të mirë dhe atyre që kërkojnë vullnetin tënd!

<sup>5</sup>Por të gjithë ata që nuk duan të ta mbajnë besën dhe duan të ndjekin udhën e tyre të shtrembër, dënoji, njëllonj si keqbërësit!

Izraeli të gjejë lumturi e paqe!

### Lutja për ndihmën e përsëritur

**126** *Këngë pelegrinazhi.*

Kur Zoti na ktheu në atdhe, në malin e Cionit, kjo ishte si shërimi pas sëmundjes së gjatë.

<sup>2</sup>Sa qeshëm dhe brohoritëm nga gëzimi! Ndër popuj të tjerë atëherë thuhej: «Zoti ka bërë mrekulli për ta!»

<sup>3</sup>Po, Zoti kishte bërë mrekulli për ne, e ne ishim plot gëzim.

<sup>4</sup>O Zot, ktheje fatin tonë edhe tani drejt së mirës, siç sjell ujin dhe mbush papritur përrenjtë e thatë!

<sup>5</sup>Kush mbjell me lot, do të korrë me gëzim.

<sup>6</sup>Me lot dalin për të hedhur farën, por me brohoritje do të kthehen (në atdhe) duke mbajtur në duar duajt e tyre.

### Gjithçka varet nga bekimi i Perëndisë

**127** *Këngë pelegrinazhi (e Solomonit).*

Vetë Zoti duhet ta ndërtojë shtëpinë, përndryshe ndërtuesit punojnë kot. Vetë Zoti duhet ta mbrojë qytetin, përndryshe çdo rojë është e kotë. <sup>2</sup>Ç'mund të arrini pa ndihmën e Zotit? Herët në mëngjes ngriheni dhe punoni deri vonë në mesnatë; me shumë mundime mblidhni atë që ju duhet për jetesë, kurse Perëndia u jep atyre që e duan, gjithçka gjatë gjumit!

<sup>3</sup>Fëmijët janë dhuratë e Zotit; me ta ai shpërblen të tijtë. <sup>4</sup>Djemtë e fuqishëm janë për atin si shigjetat në duart e luftëtarit. <sup>5</sup>Kush ka shumë shigjeta të tilla në pallaskë, e ka fatin në anën e tij. Ata kujdesen që ai të fitojë të drejtën, kur ta akuzojnë armiqtë.

### Lumturia e besnikëve

## 128 *Këngë pelegrinazhi.*

Sa i lumtur është secili që përfill dhe nderon Zotin dhe që drejtohet sipas urdhërimeve të tij!  
<sup>2</sup>Atë që fitove me punën tënde, edhe do ta gëzosh. Sa i lumtur mund të jesh! I ke mirë punët!  
<sup>3</sup>Ja, gruaja jote në shtëpinë tënde; i ngjan hardhisë pjellore. Ja, fëmijët rreth tryezës, të shumtë si ullinj të rinj. <sup>4</sup>Kështu e bekon Zoti njeriun që e përfill dhe e nderon.  
<sup>5</sup>Të bekoftë Zoti, ai që banon në malin e Cionit! Sa kohë të jetosh, duhet ta shohësh të mirën e Jerusalemit, <sup>6</sup>edhe fëmijët e fëmijëve të tu do t'i shohësh!  
Lumturia dhe paqja qofshin për mbarë Izraelin!

### I munduar rëndë, por jo i shkatërruar.

## 129 *Këngë pelegrinazhi.*

Që në rininë time më luftuan shumë – kështu le të thotë mbarë Izraeli – <sup>2</sup>Që në rininë time më luftuan shumë, por kurrë nuk arritën të më shkatërronin. <sup>3</sup>Ma kanë hapur shpinën si hapet brazda në arë, <sup>4</sup>por Zoti ma mbajti besën. I preu litarët e armikut, me të cilët më detyronin të punoja si skllav.  
<sup>5</sup>Ata detyrohen të tërhiqen dhe të turpërohen, të gjithë ata që e urrejnë malin e Cionit! <sup>6</sup>U ndodhtë si barit në çati: kërcejtë fishken para se të hapen; <sup>7</sup>asnjë korrës nuk i merr në dorë, askush nuk i mbledh në tufa, <sup>8</sup>kalimtarët nuk do të kenë kujt t'i thonë: «Zoti ju bekoftë!»  
Në emrin e Zotit, ju japim bekimin e tij!

### Lutja në rrezik të madh

## 130 *Këngë pelegrinazhi.*

Nga dëshpërimi i madh të thërras për ndihmë: <sup>2</sup>«O Zot, më dëgjo! Mos e bëj veshin e shurdhër ndaj thirrjes sime për ndihmë!  
<sup>3</sup>Po ta llogaritje mëkatin, o Zot, kush mund të qëndronte para teje? <sup>4</sup>Por ti mund ta falësh edhe mëkatin, që njeriu të të nderojë e të të dëgjojë.  
<sup>5</sup>Të gjitha shpresat e mia i vara te Zoti dhe pres fjalën e tij ndihmuese. <sup>6</sup>Kam mall për Zotin, më tepër se roja për agimin, po, më tepër se roja për mëngjesin.  
<sup>7</sup>Ju izraelitë, shpresoni te Zoti! Sepse ai është i mirë ndaj nesh dhe di të na çlirojë. <sup>8</sup>Po, ai do ta çlirojë Izraelin nga çdo mëkat!

### I qetë si fëmija i lumtur

## 131 *Këngë pelegrinazhi e Davidit.*

O Zot, unë nuk e mbaj veten për të madh, asnjërin nuk e përçmoj. Nuk merrem me punë të mëdha, të cilat nuk mund t'i bëj. <sup>2</sup>Jo, zemra ime është e qetë dhe pa shqetësime, porsì fëmijë i lumtur në krahët e nënës – jam bërë i qetë si një fëmijë i tillë.  
<sup>3</sup>O popull i Izraelit, besoji Zotit, që tani e përgjithmonë!

### Qyteti i Zotit dhe i mbretit të tij

## 132 *Këngë pelegrinazhi.*

O Zot, kujtoje Davidin dhe të gjitha mundimet që mori mbi vetel! <sup>2</sup>Mbaje mend premtimin solemn që të dha ty, Perëndisë së fuqishëm të Jakovit: <sup>3</sup>«Nuk do të hyj në shtëpinë time, nuk do të shtrihem në shtratin tim, <sup>4</sup>nuk do t'i lë sytë e mi të mbyllin, nuk do t'i lë t'i kapë gjumi, <sup>5</sup>derisa të gjej një vend për Zotin, ku mund të banojë Perëndia e fortë e Jakovit!»  
<sup>6</sup>Në Efratë morëm lajmin për arkën e besëlidhjes së Zotit, dhe e gjetëm atë pranë Jearimit.  
<sup>7</sup>Eja të shkojmë në banesën e Zotit e të biem përmbys para këmbëve të tij! <sup>8</sup>Ngrihu, o Zot, shoqëroje arkën tënde, simbolin e pushtetit tënd të madh! Eja në vendin tënd të pushimit! <sup>9</sup>Jepu priftërinjve të tu pushtet të na gjejnë ndihmën tënde! Të gjithë shërbëtorët e tu duhet të brohorasin me gëzim! <sup>10</sup>Për hir të Davidit, të besuarit tënd, mos e moho mbretin tonë, sepse vetë e emërove!  
<sup>11</sup>Zoti iu përbetua Davidit dhe nuk e merr betimin e tij mbrapsht: «Unë zgjedh njërin prej bijve të tu për trashëgimtar të fronit tënd! <sup>12</sup>Në qoftë se ai i qëndron besnik besëlidhjes me mua dhe i dëgjon urdhërimet e mia, atëherë njëri prej bijve të tij do të jetë trashëgimtar i fronit të tij. Kështu qoftë përgjithmonë!»  
<sup>13</sup>Po, Zoti e zgjodhi malin e Cionit, se atje dëshiron të banonte: <sup>14</sup>«Këtu qoftë përgjithmonë vendi im i pushimit, këtu do të mbetem – ky është vullneti im!» <sup>15</sup>Qytetin e Cionit do ta bekoj, do t'i jap gjithçka që i nevojitet për jetë, që edhe të varfrit të ngopen. <sup>16</sup>Priftërinjve të tij u jap pushtet t'ju sigurojnë ndihmën time dhe banorët e tij do të ngazëllohen! <sup>17</sup>Këtu do të zgjedh një pasardhës të Davidit, që do ta emëroj mbret të fuqishëm. Si drita që do të ndriçojë përgjithmonë, ashtu do ta përkrah mbretin që do të caktoj. <sup>18</sup>Armiqtë e tij do t'i turpëroj, por kurora e tij do të shkëlqejë gjithnjë e më shumë!»

### Bukuria e harmonisë

### 133 *Këngë pelegrinazhi (e Davidit).*

Sa këndshëm, sa mirë është kur vëllezërit rrojnë në harmoni dhe janë të një mendjeje! <sup>2</sup>Kjo është si vaji i mirë dhe kundërmues, i derdhur mbi flokët e priftit, Aharonit, që rrjedh poshtë nëpër mjekrën e tij, deri në palat e petkut të tij. <sup>3</sup>Kjo është si vesa freskuese e Hermonit që zbret mbi malin e Cionit. Atje Zoti do të japë bekimin e tij, jetën që zgjat përgjithmonë.

#### Thirrje për falënderim

### 134 *Këngë pelegrinazhi.*

Ngrihuni, falënderojeni Zotin, të gjithë ju, shërbëtorët e tij, që rrini në shtëpinë e tij dhe natën jeni në shërbim! <sup>2</sup>Shtrijini duart drejt shenjtërores dhe falënderojeni Zotin!

<sup>3</sup>«Nga Cioni, nga Tempulli i tij, ju bekoftë Zoti, ai që krijoi qiellin dhe tokën!»

#### Lavdia e Zotit nuk do të mbarojë kurrë

135 Haleluja – lavdi Zotit! Lavdërojeni atë që ju rri pranë! Lavdërojeni, të gjithë ju, shërbëtorët e tij, <sup>2</sup>ju që rrini në Tempullin e tij, në oborret e shtëpisë së Perëndisë sonë!

<sup>3</sup>Lavdërojeni Zotin, sepse ai është i mirë ndaj nesh! Këndoni dhe bjeruni veglave për nder të tij, sepse ai është i dashur ndaj nesh. <sup>4</sup>Zoti i ka zgjedhur pasardhësit e Jakovit; Izraelin e bëri pronën e vet. <sup>5</sup>E di: Zoti është i madh; Perëndia jonë është më i fuqishëm se të gjitha ‘perënditë’. <sup>6</sup>Gjithçka që do, ai e bën, në qiell dhe në tokë, në det dhe në të gjitha thellësitë. <sup>7</sup>Ai i afron retë nga skaji i botës, bën të vetëtijtë dhe të bjerë shi, erën e nxjerr nga depot e tij të rezervave.

<sup>8</sup>Ishte ai që atëherë tek egjiptianët, bëri të vdisnin të gjithë bijtë e parëlindur dhe të gjithë të parëlindurit e bagëtisë. <sup>9</sup>Atje ai bëri mrekulli të tmerrshme që ranë mbi faraonin dhe të gjithë shërbëtorët e tij.

<sup>10</sup>Ai që mundi shumë kombe dhe bëri të vdisnin mbretër të fuqishëm; <sup>11</sup>Sihonin, mbretin e amorasve, dhe Ogun, mbretin e Bashanit, si dhe të gjithë sundimtarët e Kënaanit. <sup>12</sup>Tokat e tyre ia dha për trashëgim Izraelit; ia ndau popullit të tij.

<sup>13</sup>O Zot, lavdia jote nuk do të mbarojë kurrë; të gjithë brezat do të flasin për ty!

<sup>14</sup>Zoti do t’i kthejë popullit të tij të drejtat e veta; ai ka mëshirë për të tjtë.

<sup>15</sup>Idhujt e popujve të tjerë, qofshin prej ari ose prej argjendi, janë punë të duarve njerëzore. <sup>16</sup>Ata kanë gojë që nuk flet, sy që nuk sheh, <sup>17</sup>veshë që nuk dëgjojnë – në gojën e tyre nuk ka asnjë frymë! <sup>18</sup>Ashtu u bëfshin edhe ata që i punuan këta idhujt dhe të gjithë ata që u besojnë!

<sup>19</sup>Ju, o izraelitë; falënderojeni Zotin! Ju, o priftërinjtë e tij; falënderojeni Zotin! <sup>20</sup>Edhe ju, o levitë: falënderojeni Zotin! Të gjithë ju që e nderoni, falënderojeni Zotin! <sup>21</sup>U lavdëroftë Zoti, ai që banon në Jerusalem, në malin e Cionit!

Lavdi Zotit – Haleluja!

#### Dashuria e tij nuk mbaron kurrë!

136 Falënderojeni Zotin, se ai është i mirë ndaj nesh – dashuria e tij nuk mbaron kurrë! <sup>2</sup>Falënderojeni, Perëndinë më të lartë! – dashuria e tij nuk mbaron kurrë! <sup>3</sup>Falënderojeni, Zotin më të pushtetshëm – dashuria e tij nuk mbaron kurrë!

<sup>4</sup>Vetëm ai bën mrekulli të mëdha – dashuria e tij nuk mbaron kurrë! <sup>5</sup>Me mjeshtëri qiellin e lakoi – dashuria e tij nuk mbaron kurrë! <sup>6</sup>Përmbi dete tokën e shtriu – dashuria e tij nuk mbaron kurrë!

<sup>7</sup>Dritëdhënësit e mëdhenj i krijoi – dashuria e tij nuk mbaron kurrë! <sup>8</sup>Diellin për të rregulluar ditën, – dashuria e tij nuk mbaron kurrë – <sup>9</sup>hënën dhe yjet për natën – dashuria e tij nuk mbaron kurrë!

<sup>10</sup>Të parëlindurit e egjiptianëve i vrau – dashuria e tij nuk mbaron kurrë! <sup>11</sup>Izraelin e nxori që andej – dashuria e tij nuk mbaron kurrë! <sup>12</sup>E bëri me fuqinë e tij të madhe – dashuria e tij nuk mbaron kurrë!

<sup>13</sup>Detin e Xunkthtë e ndau më dysh – dashuria e tij nuk mbaron kurrë! <sup>14</sup>Popullin e Izraelit e udhëhoqi përmes tij – dashuria e tij nuk mbaron kurrë! <sup>15</sup>Faraonin me ushtrinë mes ujërash i fundosi – dashuria e tij nuk mbaron kurrë!

<sup>16</sup>Popullin e vet e udhëhoqi nëpër shkretëtirë – dashuria e tij nuk mbaron kurrë!

<sup>17</sup>Mundi mbretër të mëdhenj – dashuria e tij nuk mbaron kurrë! <sup>18</sup>Vrau mbretër të fuqishëm – dashuria e tij nuk mbaron kurrë! <sup>19</sup>Sihonin, mbretin e amorasve – dashuria e tij nuk mbaron kurrë! <sup>20</sup>Edhe Ogun, mbretin e Bashanit – dashuria e tij nuk mbaron kurrë!

<sup>21</sup>Tokat e tyre ia ndau Izraelit – dashuria e tij nuk mbaron kurrë! <sup>22</sup>Ua dha shërbëtorëve të tij për trashëgim – dashuria e tij nuk mbaron kurrë!

<sup>23</sup>Ka menduar për ne, sa herë që na shtypnin – dashuria e tij nuk mbaron kurrë! <sup>24</sup>Na çliroi nga armiqtë tanë – dashuria e tij nuk mbaron kurrë! <sup>25</sup>Të gjitha qenieve u jep ushqim – dashuria e tij nuk mbaron kurrë!

<sup>26</sup>Falënderojeni, Perëndinë e qiellit – dashuria e tij nuk mbaron kurrë!

#### Vajtimi i robërve në Babiloni

137 Ishim ulur pranë kanaleve të Babilonisë; mendonim për Cionin dhe qanim. <sup>2</sup>Lahutat tona i varëm në shelgie; nuk donim t’u binim më. <sup>3</sup>Por armiqtë që na shtypnin, që na kishin rrëmbyer nga atdheu, kërkonin prej nesh edhe këngët e festimit. «Na këndonin një këngë të Cionit!» – na thoshin.

<sup>4</sup>Larg Tempullit, atje në vend të huaj – si mund të këndonim këngë për nder të Zotit?

<sup>5</sup>O Jerusalem, po të të harroj, m'ua thaftë dora e djathtë! <sup>6</sup>Gjuha m'ua ngjittë pas qiellzës, po nuk vazhdoj të mendoj për ty, po të më pëlqejë ndonjë gjë, më shumë se ti, o Jerusalem!  
<sup>7</sup>O Zot, mos e harro atë që bënë edomasit, atëherë kur Jerusalemi ra në duart e armiqve, kur thërritnin: «Rrënojeni qytetin! Rrafshojeni!»  
<sup>8</sup>O Babilon, edhe ti së shpejti do të shkretohesh! Zoti e bekoftë njeriun që do të ta paguajë atë që na bëre!  
<sup>9</sup>Perëndia e bekoftë njeriun që do t'i kapë fëmijët e tu dhe do t'i dërrmojë në shkëmb!

### **Siguria mirënjohëse**

**138** *Këngë e Davidit.*

Të falënderoj me gjithë zemër, o Zot; me këngën time do të të lavdëroj, ty – e jo 'perënditë' e tjera!  
<sup>2</sup>Bie përmbys para shenjtërores sate për të të falënderuar, o Zot, për mirësinë dhe besnikërinë tënde. Premtimin tënd e plotësove, po, bëre edhe më tepër sesa pritnim prej teje! <sup>3</sup>M'ua përgjigje kur të thirra; ti më nxit të kërkoj prej teje gjëra më të guximshme. <sup>4</sup>O Zot, të lavdërofshin të gjithë sundimtarët e botës, kur ta dëgjojnë atë që ke thënë. <sup>5</sup>Ta festojnë veprimin tënd duke kënduar: «I madh është pushteti i Zotit!»  
<sup>6</sup>Rri në fron atje në lartësi, e megjithatë të poshtëruarit i sheh dhe kujdeset për ta.»  
<sup>7</sup>Kur duhet të kaloj përmes rreziqesh, ti, o Zot, më mban në jetë. Ti më mbron nga zemërimi i armiqve të mi; dora jote e fuqishme do të më ndihmojë. <sup>8</sup>O Zot, ti do të bësh gjithçka për mua, dashuria jote nuk mbaron kurrë. Përfundoje atë që fillove!

### **Krijuesi im më njeh plotësisht**

**139** *Këngë e Davidit.*

O Zot, ti i di mendimet e mia më të fshehta, ti më njeh mua plotësisht. <sup>2</sup>Kur ulem ose ngrihem, ti e di, ti i di nga larg planet e mia. <sup>3</sup>Kur veproj ose pushoj, ti më sheh; ti ke dijeni për çdo hap që bëj. <sup>4</sup>Para se të vijë ndonjë fjalë në gjuhën time, ti, o Zot, tashmë e ke dëgjuar. <sup>5</sup>Ti më rrethon nga të gjitha anët; jam plotësisht në dorën tënde. <sup>6</sup>Fakti që ti më njeh me kaq saktësi, e tejkalon kuptimin tim; për mua është tepër i ndërlikuar, nuk mund ta kuptoj.  
<sup>7</sup>Ku mund të shkoj për të ikur prej teje, ku të largohem që të mos më shohësh më? <sup>8</sup>Nëse ngrihem në qiell – atje je! Nëse fshihem në botën e të vdekurve – edhe atje je! <sup>9</sup>Nëse fluturoj atje ku lind dielli, ose në fund të detit ku perëndon: <sup>10</sup>edhe atje do të më arrijë dora jote, edhe atje nuk do të më lëshojë. <sup>11</sup>Nëse them: «Le të më mbulojë errësira, le të bëhet natë rreth mejel!», <sup>12</sup>për ty edhe errësira nuk është e errët, edhe nata është po aq e ndritur sa dita.  
<sup>13</sup>Ti më krijove me mish e me shpirt, më formove në mitrën e nënës. <sup>14</sup>Për këtë të falënderoj; kjo më mbush me respekt të thellë. Për trupin tim e pranoj: të gjitha veprat e tua janë mrekulli. <sup>15</sup>Nuk isha i fshehur për ty, kur më formove në fshehtësi, kur isha ende në mitrën e nënës. <sup>16</sup>Kur isha ende pa formë, ti më shihje; në librin tënd tashmë kishe shënuar të gjitha ditët që më kishe caktuar, ende pa filluar ndonjëra prej tyre. <sup>17</sup>Sa të vështirë e kam t'i kuptoj planet e tua, o Perëndi; sa i pallogaritshëm është numri i tyre! <sup>18</sup>Ato janë më të shumta se mizat e dheut. Po të mbaroja llogaritjen time, edhe atëherë nuk do të filloja t'i kuptoja!  
<sup>19</sup>O Perëndi, vriti të gjithë ata që të përbuzin ty dhe urdhërimet e tua! M'i hiq qafe këta vrasës! <sup>20</sup>Flasin për ty vetëm për të thurur intriga. O Zot, armiqtë e tu e përdorin emrin tënd për të gënjer! <sup>21</sup>Tek unë ngjallin neveri ata që të kundërshtojnë, o Zot; i urrej ata që të urrejnë ty. <sup>22</sup>Armiqtë e tu janë armiqtë e mi; i urrej ata pa masë.  
<sup>23</sup>Më heto, o Perëndi, shiko në zemrën time; kontrolloji dëshirat dhe mendimet e mia! <sup>24</sup>Nëse jam në rrezik të largohem prej teje, atëherë më kthe në rrugën që më çon drejt teje!

### **Lutje për ndihmë kundër shpifësve**

**140** *Këngë e Davidit.*

O Zot, më shpëto nga njerëzit e këqij, më mbro nga njerëzit e dhunshëm! <sup>3</sup>Koka e tyre është e mbushur plot me plane të liga; çdo ditë shkaktojnë grindje. <sup>4</sup>Ata janë të rrezikshëm si nepërkat që dredhin gjuhën; fjalët e tyre janë vdekjeprurëse si helm nepërkash. <sup>5</sup>O Zot, më ruaj nga njerëzit që nuk të përfillin as ty, as urdhërimet e tua; më mbro nga njerëzit e dhunshëm, nga ata që duan të më rrëzojnë. <sup>6</sup>Këta të pafytyrë më kanë ngritur kurthin, kanë hedhur në rrugë leqe e rrjeta.  
<sup>7</sup>Por unë them: o Zot, ti je Perëndia ime! Dëgjomë kur të thërras për ndihmë! <sup>8</sup>Perëndi, o Zoti im, ndihmësi im i fortë, ti më mbrove në luftë si mburojë. <sup>9</sup>Mos u jep keqbërësve atë që kërkojnë! Mos lejo të realizohen intrigat e tyre; përndryshe do t'u shtohet arroganca. <sup>10</sup>Gënjeshtarit që përhapin për mua, të kthejnë kundër këtyre shpifësve! <sup>11</sup>Prush rëntë mbi ta! Rrëzoi në zjarr, në gropa të thella, prej të cilave nuk mund të dalin më! <sup>12</sup>Për shpifës mos pastë vend në tokën (e premtuar), e kush do dhunë, atë e çoftë në varr fatkeqësia!  
<sup>13</sup>E di, o Zot, se ti ndërhysh për të shtypurit; të pambrojturve ti do t'u sigurosh të drejtat e tyre. <sup>14</sup>Të gjithë ata që ta mbajnë besën dhe kërkojnë vullnetin tënd, do të jetojnë në praninë tënde dhe do të të lavdërojnë.

## Lutje për ruajtje

**141** *Këngë e Davidit.*

O Zot, po të thërras për ndihmë, më eja shpejt në ndihmë! Më dëgjo kur të thërras. <sup>2</sup>Lutja ime qoftë flijim përkushtimi, tymi i të cilit ngrihet lart gjer tek ti! E duart e mia të shtrira drejt teje, pranoji si flijim të mbrëmjes! <sup>3</sup>O Zot, ruaje gjuhën time, vendos rojë në portën e buzëve të mia! <sup>4</sup>Mos më lejo që të jepem pas prirjeve të mia, më ruaj që të mos flas gjëra të këqija e që të mos kryej vepra të poshtra, bashkë me keqbërësit e tjerë. Hiqma dëshirën për të ngrënë një ushqim të tillë! <sup>5</sup>Vetëm ai që vepron drejt, lejohet të më dënojë. Kur ai më qorton sipas mirësisë së tij, kjo më bën një favor që nuk e kundërshtoj. E kur ai të bjerë vetë në fatkeqësi, vazhdoj t'i lutem Perëndisë për të.

<sup>6</sup>Kur të rrëzohen nga shkëmbinjtë sundimtarët e tyre, atëherë populli do ta pranojë se fjalët e mia janë të vërteta. <sup>7</sup>Si guri i mullirit përtokë, ashtu rrinë kockat e tyre të shtrira në grykën e botës së të vdekurve.

<sup>8</sup>Tek ti, o Perëndia ime dhe Zoti im, janë sytë e mi. Tek ti kërkoj strehim, mos më lër të rrëzohem! <sup>9</sup>Më ruaj nga laku që më kanë ngritur, nga kurthet e atyre që kërkojnë fatkeqësinë time. <sup>10</sup>Le të zihen njerëzit e pabesë në rrjetat e veta, ndërsa unë le të shpëtoj.

## Askush nuk kujdeset për mua!

**142** *Poemë e Davidit, lutje kur ishte në shpellë.*

<sup>2</sup>E thërras Zotin me sa zë që kam; i lutem Zotit për ndihmë. <sup>3</sup>Përpara tij vajtoj hallin tim, ia them atë që më mundon.

<sup>4</sup>Edhe kur më lëshon krejtësisht zemra, ti, o Zot, e di se ku po shkoj! Në rrugën që duhet të ndjek, më kanë ngritur leqe. <sup>5</sup>Shikoj rreth e rrotull: askush nuk më vë re. Nuk kam më asnjë strehim, asnjë njeri që të kujdeset për mua.

<sup>6</sup>Të thërras ty, o Zot! Them: ti je strehimi im, ti më jep gjithçka që më duhet për jetë! <sup>7</sup>Dëgjoje thirrjen time; nuk mund të mbahem më! Më shpëto nga përndjekësit e mi, se ata janë më të fortë se unë! <sup>8</sup>Më çliro nga burgu! Në rrethin e atyre që ta mbajnë besën, do të të falënderoj, o Zot, se ke qenë aq i mirë ndaj meje, o Zot.

## Mos më nxirr në gjyq!

**143** *Këngë e Davidit.*

O Zot, dëgjoje lutjen time, merre parasysh lutjen time! Fjala jote është e besuar, ti e mban premtimin; prandaj pres përgjigjen tënde. <sup>2</sup>O Zot, mos më nxirr në gjyq; sepse para teje nuk mund të qëndrojë askush.

<sup>3</sup>Armiku im më përndjek, më rrëzoi përtokë për të më shkelur; më futi në errësi tek ata që kanë vdekur qëkuri. <sup>4</sup>Zemra më ka lëshuar fare; forcat e mia po shterojnë. <sup>5</sup>Më kujtohet koha e mëparshme, gjithçka që kreve atëherë; mendoj për veprat e tua. <sup>6</sup>Duke u lutur, shtrij duart e mia drejt teje dhe pres me padurim ndihmën tënde, ashtu siç pret shiun toka e thatë.

<sup>7</sup>O Zot, më dëgjo shpejt, nuk mundem më! Mos u fshih prej meje, përndryshe jeta ime do të mbarojë.

<sup>8</sup>Herët në mëngjes shpallma mirësinë tënde, sepse unë besoj në ty. Më trego rrugën që duhet të ndjek, sepse ty të drejtohem. <sup>9</sup>O Zot, më shpëto nga armiqtë e mi; pranë teje jam i sigurt. <sup>10</sup>Më ndihmo të jetoj sipas vullnetit tënd, sepse ti je Perëndia ime! Shpirti yt më drejtoftë me dashamirësi dhe më çoftë në një vend të sigurt! <sup>11</sup>Meqë ti je Zot, më mbaj në jetë! Bëj që të realizohet premtimi yt e më çliro nga rreziku!

<sup>12</sup>Shpresoj në mirësinë tënde; asgjësoji armiqtë e mi, shfarosi të gjithë ata që kërkojnë të më vrasin; sepse të takoj ty!

## Lutja e mbretit

**144** *Nga Davidi.*

O Zot, mbrojtësi im, të lavdëroj! Ti u mëson duarve të mia luftën dhe i aftëson gishtat e mi për betejë. <sup>2</sup>Ti je mbrojtësi im besnik, kështjella ime, kalaja ime e sigurt dhe shpëtimtari im, mburoja ime, prapa së cilës fshihem, ti i bën popujt e huaj të më nënshtrohen mua.

<sup>3</sup>Çfarë është njeriu, o Zot, që të kujdesesh për të? Sa vlen për ty njeriu i vdekshëm, që të merresh me të?

<sup>4</sup>Njeriu është si një frymë dhe jeta e tij i ngjan hijes që kalon.

<sup>5</sup>O Zot, përkule qiellin dhe zbrit! Preki malet dhe ato do të tymojnë. <sup>6</sup>Lëshoje rrufenë tënde dhe dëboji armiqtë, qëlloni shigjetat e tua dhe tmerroji ata! <sup>7</sup>Zbriti duart e tua nga qielli, më rrëmbe nga ujërat vdekjeprurëse! Më shpëto nga pushteti i të huajve, <sup>8</sup>që kurrë nuk thonë të vërtetën edhe kur ngrënë dorën për t'u përbetuar.

<sup>9</sup>O Perëndi, do të këndoj për ty një këngë të re, duke i rënë harpës me dhjetë tela. <sup>10</sup>Ti i dhe mbretit fitoren; ti e shpëtove Davidin, shërbëtorin tënd, nga shpata e armiqve të tij. <sup>11</sup>Më çliro, më shpëto nga pushteti i të huajve, që kurrë nuk thonë të vërtetën dhe gënjejnë, edhe kur ngrënë dorën për t'u përbetuar.

<sup>12</sup>Atëherë bijtë tanë në rininë e tyre do të jenë si pemët e harlisura dhe bijat tona do të jenë të forta e të bukura si shtyllat e gdhendura në pallate. <sup>13</sup>Atëherë depot tona do të jenë të mbushura plot e do të na



sigurojnë gjithfarë mallrash. Dhentë dhe dhitë tanë do të shumëzohen mijëfish në kullota. <sup>14</sup>Edhe bagëtitë tona do të rriten mirë. Asnjë armik nuk do t'i shembë muret tona dhe askush nuk do të na çojë në robëri. <sup>15</sup>Lum ai popull që shkon kështu. Lum ai popull që e ka Zotin për Perëndi!

### Sundimi yt nuk mbaron kurrë

**145** *Këngë lavdëruese e Davidit.*  
Ti, Perëndia dhe mbreti im, ty do të të lavdëroj; gjithnjë, pa mbarim, do të të falënderoj! <sup>2</sup>Çdo ditë do të të falënderoj; gjithnjë, pa mbarim, do të të lavdëroj! <sup>3</sup>Do të pranoj: «Zoti është i fuqishëm, duhet lavdëruar! Fuqia e tij është e pamatshme»  
<sup>4</sup>Brez pas brezi do të lavdërohen ato që ti kreve, dhe do të flitet gjithnjë për veprat e tua të fuqishme! <sup>5</sup>Të gjithë lavdërofshin madhësitinë dhe madhërinë tënde, e unë do të mendoj gjithnjë për mrekullitë e tua.  
<sup>6</sup>Le të shpallet pushteti yt që ngjall respekt, e unë do të tregoj për veprat e tua të mëdha! <sup>7</sup>Le të lavdërohet mirësia jote e madhe, e të këndohet kështu për dashamirësinë tënde: <sup>8</sup>«Zoti është plot mirësi dhe mëshirë, plot dashuri dhe durim të pamasë. <sup>9</sup>Zoti është i mirë ndaj gjithsecilit; ka mëshirë për të gjitha qeniet.»  
<sup>10</sup>Të lavdërofshin të gjitha qeniet, o Zot; të gjithë ata që të takojnë le të të falënderofshin! <sup>11</sup>Të flasin për madhësitinë e mbretërisë sate dhe për pushtetin tënd të madh, <sup>12</sup>që t'ua shpallin të gjithëve veprat e tua, shkëlqimin dhe madhësitinë e mbretërisë sate. <sup>13</sup>Ti je mbret për të gjitha kohët dhe sundimi yt nuk do mbarojë kurrë!  
Zoti është i besuar në gjithçka që thotë, dhe i mirë në gjithçka që bën. <sup>14</sup>Të gjithë ata që nuk mund të mbahen në këmbë, i mban, dhe të përkulurit i ngre.  
<sup>15</sup>Të gjithë shohin plot shpresë drejt teje dhe ti i jep ushqim secilit në kohën e duhur. <sup>16</sup>Ti hap dorën tënde, dhe gjithçka e gjallë ngopet.  
<sup>17</sup>Zoti është i drejtë në veprimet e tij dhe zemërgjerë në gjithçka që bën. <sup>18</sup>Zoti është afër atyre që i luten – të gjithë atyre që i luten me çiltëri. <sup>19</sup>Lutjet e atyre që e dëgjojnë, i plotëson; thirrjen e tyre e dëgjon dhe i shpëton. <sup>20</sup>Zoti i mbron të gjithë ata që e duan, por ata që e përbuzin do t'i shkatërrojë. <sup>21</sup>Do të shpall lavdinë e Zotit, e gjithçka e gjallë, e falënderoftë atë, Perëndinë e shenjtë, në jetë të jetëve!

### Perëndia, mbrojtja e të dobtëve

**146** Haleluja – lavdi Zotit! Unë dua ta lavdëroj Zotin! <sup>2</sup>Gjithë jetën time do ta lavdëroj, Perëndisë tim do t'i këndoj, derisa të marr frymë!  
<sup>3</sup>Mos u beso atyre që kanë pushtet dhe influencë! Edhe ata janë veçse njerëz e nuk mund t'ju ndihmojnë. <sup>4</sup>Ata do të vdesin e do të bëhen pluhur dhe bashkë me ta do të mbarojnë edhe planet e tyre.  
<sup>5</sup>Por sa i lumtur është secili që e ka Perëndinë e Jakovit për ndihmës dhe i var tek ai të gjitha shpresat, te Zoti, Perëndia e tij.  
<sup>6</sup>Zoti ka krijuar mbarë botën: qiellin, tokën dhe detin, bashkë me të gjitha krijesat që banojnë atje. Besnikëria e tij është e qëndrueshme. <sup>7</sup>Ai u siguron të drejtat e tyre të shtypurve, u jep të hanë të uriturve, çliron të burgosurit, <sup>8-9</sup>shëron të verbërit, ngre të dëshpëruarit, mbron mysafirët dhe të huajt në tokën (e premtuar), dhe kujdeset për vejushat dhe jetimët. Zoti i do të gjithë ata që ia mbajnë besën, ndër-sa planet e të pabesëve i shkatërrojnë.  
<sup>10</sup>Zoti është mbret përgjithmonë! O Cion, Perëndia jote do të sundojë brez pas brezi! Lavdi Zotit – Haleluja!

### Pushteti i Perëndisë në natyrë dhe në histori

**147** Haleluja – lavdi Zotit! Sa mirë është t'i këndojmë Perëndisë sonë; zemra gëzohet ta lavdërojë me këngë! <sup>2</sup>Zoti do të rindërtojë Jerusalemin; do të kthejë në atdhe të mërguarit e Izraelit. <sup>3</sup>Të gjithë ata që kanë zemrën e thyer do t'i shërojë dhe do t'ua lidhë plagët.  
<sup>4</sup>Vetëm Ai e di numrin e yjeve, i ka vënë emrin secilit.  
<sup>5</sup>Zoti ynë është i fuqishëm, i madh është pushteti i tij; dituria e tij nuk ka kufi.  
<sup>6</sup>Të përkulurit i ngre, kurse kryengritësit i rrëzon përdhe.  
<sup>7</sup>Këndojini Zotit këngë lavdëruese, këndojini Perëndisë sonë duke i rënë lahutës! <sup>8</sup>Qiellin e mbulon me re dhe furnizon tokën me shi; bën të rritet bari në male. <sup>9</sup>Të gjitha kafshët i ushqen, edhe korbata e rinj kur thërrasin për ushqim.  
<sup>10</sup>Shumë njerëz u besojnë forcave të kuajve dhe këmbëve të shpejta të luftëtarëve të vet; ata të gjithë ngjallin te Zoti neveri.  
<sup>11</sup>Por Zoti është i kënaqur me njerëzit që e nderojnë, e dëgjojnë dhe kanë besim te mirësia e tij.  
<sup>12</sup>Lavdëroje Zotin, o Jerusalemi; lavdëroje Perëndinë tënd, o qytet i Cionit! <sup>13</sup>Ai sjell siguri në muret e tua, e bekon popullin tënd që banon brenda teje.  
<sup>14</sup>Paqe dhe lumturi i jep tokës sate, me grurin më të mirë të ngop.  
<sup>15</sup>Urdhurat e tij ia dërgon tokës, fjala e tij ia arrin qëllimit me shpejtësi. <sup>16</sup>Bën të bjerë bora si shtëllunga leshi; brymën e shpërndan ngado si hi.  
<sup>17</sup>Breshrin e hedh copacopa dhe ngricës së tij nuk mund t'i qëndrojnë askush.  
<sup>18</sup>E kur u jep urdhër, fillojnë të shkrihen; fryma e tij i bën përrenjtë të rrjedhin përsëri.

<sup>19</sup>Fjalën e tij ia shpall edhe Izraelit, ligjet për jetën e pasardhësve të Jakovit.

<sup>20</sup>Për asnjë popull tjetër nuk bëri gjëra të tilla; asnjë popull tjetër nuk i njeh urdhërimet e tij.

Lavdi Zotit – Haleluja!

### Lavdërojeni Perëndinë në qiell e në tokë!

**148** Haleluja – lavdi Zotit! Lav dërojeni Zotin, të gjitha krijesat e tij, lavdërojeni atje në lartësi! <sup>2</sup>Lavdërojeni, të gjithë engjëjt e tij! Lavdërojeni, ju o fuqi qiellore! <sup>3</sup>Lavdërojeni atë, ju o diell e o hënë! Lavdërojeni, ju o yjet e shndritshme! <sup>4</sup>Lavdërojeni, ju o hapësira të pamata të qiellit e ju o ujëra përmbi kupën e qiellit!

<sup>5</sup>Të gjithë ta lavdërojnë Zotin, sepse me urdhrin e tij u krijuan. <sup>6</sup>I vendosi përgjithmonë në vendet e tyre dhe u caktoi kufijtë që nuk mund t'i kapërcejnë.

<sup>7</sup>Lavdërojeni Zotin, të gjitha krijesat e tij, lavdërojeni poshtë në tokë! Lavdërojeni, ju o oqeanë, ju o kuçedra që jetoni në det! <sup>8</sup>Lavdërojeni, o rrufe, o breshër, borë dhe re, ju stuhi që veproni me urdhrin e tij!

<sup>9</sup>Lavdërojeni, ju o male e kodra, ju o pemë e pyje! <sup>10</sup>Lavdërojeni, ju o kafshë të egra e të buta, ju o zogj e zvarranikë! <sup>11</sup>Lavdërojeni, ju o mbretër dhe të gjithë popujt, ju o kryetarët dhe të pushtetshmit e tokës!

<sup>12</sup>Lavdërojeni, ju, o burra e gra, të rinj e pleq së bashku!

<sup>13</sup>Të gjithë ta lavdërojnë Zotin! Ai, i vetmi, është i madh pa krahasim; madhështia e tij shtrihet mbi mbarë botën.

<sup>14</sup>Populli i Izraelit i rri pranë; me ndihmën e tij Izraeli është bërë i madh dhe i fuqishëm. Prandaj i qëndron besnik dhe e lavdëron!

Lavdi Zotit – Haleluja!

### Perëndia do t'ia vërë nderin në vend Izraelit

**149** Haleluja – lavdi Zotit! Këndojini Zotit një këngë të re, lavdërojeni, kur të mblidheni, të gjithë ju që ia mbani besën! <sup>2</sup>Gëzohu, o popull i Izraelit; ai është Krijuesi yt! Ti, o bashkësi në malin e Cionit, brohoriti; ai është mbret!

<sup>3</sup>Lavdërojeni me valle festimi! Këndojini me ritmin e dajres; nderojeni duke u rënë telave! <sup>4</sup>Sepse Zoti është i mirë ndaj popullit të vet, të përvuajturit i ngre me ndihmën e tij.

<sup>5</sup>Të brohorasin të gjithë ata që i takojnë Zotit, sepse ia vuri nderin në vend Izraelit! Të këndojnë nga gëzimi edhe natën.

<sup>6</sup>Ta lavdërojnë me zë të lartë, me shpata të mprehura në duar!

<sup>7</sup>Ata do të zbatojnë gjyqin e Perëndisë, do të hakmerren kundër të gjitha kombeve, <sup>8</sup>do t'i vënë në pranga mbretërit, do t'i lidhin me zinxhirë të pushtetshmit. <sup>9</sup>Do ta zbatojnë vendimin gjyqësor të Perëndisë, ashtu siç është shkruar në Ligjin e tij. Ky është nder për të tijtë.

Lavdi Zotit – Haleluja!

### Lavdi Zotit

**150** Haleluja – lavdi Zotit! Lavdërojeni Zotin në shenjtëroren e tij! Lavdërojeni, të Pushtetshmin që qëndron në qiell!

<sup>2</sup>Lavdërojeni, sepse bën mrekulli; fuqia e tij nuk ka kufi!

<sup>3</sup>Lavdërojeni me rënien e trumbetave, me tingëllimin e harpave dhe të lahutave! <sup>4</sup>Lavdërojeni me daulle e me valle të gëzuara, me flaute e me vegla me tela!

<sup>5</sup>Lavdërojeni me cimbale tingëlluese,

lavdërojeni me cimbale kumbuese!

<sup>6</sup>Gjithçka që merr frymë, ta lavdërojë Zotin! Lavdi Zotit – Haleluja!